1. I.1.2 Identifikon pikat kryesore të bisedave të thjeshta dhe tregimeve që janë lexuar me zë duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta. Dëshmon prirjet e veta në lojëra skenike.
2. I.1.3 Interpreton tekste letrare duke u nisur nga komentimi I ngjarjes,ideve, personazheve, rrëfimit, figurave.
3. I.2.5 Përdor strategjinë e lexim-kuptimit duke interpretuar idenë kryesore të një teksti dhe duke e dalluar atë nga detajet.
4. I.3.3 Shkruan një tekst të thjeshtë(ese, tekst të ndryshëm)
5. I.3.7 Përdor rregulla të drejtshkrimit
6. I.3.8 Përdor drejt shenjat e pikësimit.

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për temat mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja e lëndës me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.Tekstet letrare dhe jo letrare**<br>Tregime, romane, poezi, prozë të shkurtër, tekste popullarizuese, tekste dramatike, përrallëza, përralla, fjalë të urta, gjëegjëzat, tekste të thjeshta, revista për fëmijë, gazeta;<br><br>Në klasë, në shkollë, në familje, në rreth, në media;<br>Gjuhë figurative dhe jofigurative<br>Mjedisi, vendbanimi; | • Lexon tekste të ndryshme me intonacionin dhe ritmin e duhur;<br>• Avancon kulturën e lexim-kuptimit;<br>• Lexon dhe kupton fjalët në kontekste të ndryshme;<br>• Ritregon tekstin në mënyrë të pavarur;<br>• Identifikon detajet dhe çështjet kryesore të tekstit;<br>• Dallon idenë kryesore nga detaji; | 54. Flasim-Dëgjojmë:Keci me veshë tëmëdhenj<br>55. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Keci me veshë tëmëdhenj<br>56.Lexojmë-Dëgjojmë: Ç'ëndërrojnë vogëlushët?<br>57. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Ç'ëndërrojnë vogëlushët?<br>58. Shkruajmë-Kuptojmë-Lexojmë-Flasim: Letra? Si të shkruajmë një | 49 orë | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim,sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);<br>Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim);<br>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);<br>Diskutim dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha | Informata kthyese,;<br>Vlerësim i ndërsjellë (njëri-tjetri); Dyshe një dëshirë;<br>Listë kontrolli<br>Dosja personale<br>Test | Matematika<br>Shkenca natyrore<br>Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Edukimi qytetar<br><br>Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm | Librat: Gjuha shqipe 4, Leximi 3, Burime nga interneti<br>Fletore pune |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shfaqje teatrale,filmi;<br>Loja, sporti, profesione;<br>Tekste zyrtare dhe jozyrtare(lajmërimi, falenderimi,urimi, kërkesa, reklama, formularët e ndryshëm etj.)<br><br>**2.Gjuha figurative dhe jofigurative**<br>Shprehjet frazeologjike | • Dallon elementet përbërëse të një përralle dhe tregimi të shkurtër.<br>• Gjykon mbi bazën e argumenteve idetë dhe informacionin e tekstit;<br>• Krahason personazhe, ngjarje, ide, informacione, mjedise nga një tregim, nga një përrallë, nga një fabul, etj., duke konkretizuar me shembuj nga teksti;<br>• Identifikon përbërësit e tekstit letrar (krypersonazhet/heroin, temën, | letër?<br>59. Fitojmë njohuri për gjuhën:<br>Përemrat pronor<br>60. Fitojmë njohuri për gjuhën:<br>Përemrat pronor<br>61.Lexojmë dëgjojmë: Ëndrrat me ngjyra<br>62. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim:Ëndrrat me ngjyra<br>63. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim:Ëndrrat me ngjyra/Dramatizim<br>64.Lexojmë-Dëgjojmë: Shfaqja më e mirë<br>65.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Shfaqja më e mirë<br>66. .Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: | | dhe me të gjithë nxënësit);<br>Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit;<br>Mësimdhënie e bazuar në përvojë (lojë me role, dramatizim) | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **3.Kulturë, kritikë, histori**<br>Elemente të përgjithshme kulturore, letrare e historike<br>Monumentet e kulturës | ngjarjen/subjektin, hapësirën, kohën dhe autorin/ rrëfimtarin;<br>• Klasifikon personazhet në bazë të veprimeve të tyre;<br>• Dallon poezinë nga proza, tonalitetin, ritmin, vargun, strofën, tregimin fantastik e përrallor, tregimin realist;<br>• Rrëfen rrjedhshëm për ngjarje të ndryshme;<br>• Diskuton për tema të përshtatshme për moshën e tij;<br>• Shpjegon dhe argumenton disa rregulla të sjelljes në klasë dhe jashtë | Shfaqja më e mirë<br>67.Fitojmë njohuri për gjuhën:Lidhëzat<br>68. Fitojmë njohuri për gjuhën: Drejtshkrim/Presja dhe lidhëzat<br><br>69.Lexojmë-Dëgjojmë:Katër profesionistët<br>70..Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë- Katër profesionistët<br>70.Lexojmë-Kuptojmë-Flasim-Shkruajmë: Katër profesionistët<br>71.Lexojmë-Kuptojmë: Lexojmë-Dëgjojmë: Kur shkonim te dajat<br>72.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim:Kur shkonim te dajat<br>73.Njohuri për gjuhën: Drejtshkrim<br>74. Njohuri për gjuhën: Ushtrime | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **4. Sistemi gjuhësor**<br>Përemrat pronorë,<br>Drejtshkrim<br>Ndajfoljet<br>Rrethanorët<br>Lidhëzat | saj si dhe rregulla të kujdesit e mirësjelljes;<br>• Dëshmon shprehi për shoqërim me të tjerët dhe për ruajtjen e mjedisit;<br>• Përshkruan vendbanimin (fshat, qytete) dhe objektet që e karakterizojnë;<br>• Dallon karakteristikat e gjuhës standarde nga ato lokale;<br>• Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja në fusha të ndryshme dhe praktikon aftësitë shprehëse;<br>• Kupton frazeologjizmat | drejtshkrimi<br>75. Lexojmë-Dëgjojmë: Nëntori i parë<br>76.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Nëntori i parë<br>77. Lexojmë-Kuptojmë- Flasim-Shkruajmë: Nga Prizreni në Vlorë<br>78. Lexojmë-Kuptojmë- Flasim-Shkruajmë: Nga Prizreni në Vlorë<br>79. Lexojmë-Kuptojmë- Flasim-Shkruajmë: Aktivitet/ Nga Prizreni në Vlorë<br>80. Lexojmë-Kuptojmë-Analizojmë: Analizë e lekturës së lexuar<br>81. Lexojmë-Kuptojmë-Analizojmë: Analizë e lekturës së lexuar | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe mënyrën e përdorimit të tyre;<br>• Parashtron pyetje dhe argumenton për periudha historike;<br>• Parashtron pyetje dhe përgjigjet për çështje kulturore;<br>• Dallon dhe i flet për koncepte bazike historike, kulturore e kritike.<br>• Identifikon dhe përshkruan disa monumente/ngjarje të kulturës;<br>• Dallon zhanret letrare nga ato joletrare: tregim, përrallë, poezi, fjalë e urtë përballë informatës, lutjes, urimit etj.<br>• Identifikon tipare | 82. Fitojmë njohuri për gjuhën: Ndajfoljet e vendit, kohës dhe sasisë<br>83. Fitojmë njohuri për gjuhën: Ushtrime për ndajfolje<br>84. Lexojmë-Dëgjojmë: Saja me timon<br>85. Lexojmë-Kuptojmë-Flasim-Shkruajmë: Saja me timon<br>86. Lexojmë-shkruajmë-Flasim:Sportet dimërore<br>87. Lexojmë-dëgjojmë:Qeni besnik<br>88. Lexojmë-Kuptojmë- Flasim-Shkruajmë: Qeni besnik<br>89. Lexojmë-Dëgjojmë: Biçikleta e prishur<br>90. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | historike e kulturore të një teksti letrar a joletrar;<br>• Bën lidhjen e ngjarjeve nga jeta me ato të rrëfyera në një tekst;<br>• Shpreh emocionet dhe mendime lidhur me një tekst a ngjarje<br>• Përdor tonin dhe mimikën e duhur;<br>Kupton rëndësinë e tolerancës dhe dialogut;<br>• Dallon dhe përdor përemrat pronorë;<br>• Praktikon ndajfoljen e vendit, kohës, sasisë, duke e dalluar atë nga mbiemri;<br>• Dallon dhe përdor disa nga lidhëzat bashkërenditëse dhe | Biçikleta e prishur<br>91.Lexojmë-Kuptojmë- Për ditëlindjen e dhjetë<br>92.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim:Për ditëlindjen e dhjetë<br>93.Fitojmë njohuri për gjuhën:Rrethanori i vendit, i kohës94.Fitojmë njohuri për gjuhën:Rrethanori i mënyrës dhe sasisë<br>95. Fitojmë njohuri për gjuhën: Ushtrime/Rrethanorët<br>96. Lexojmë-Dëgjojmë: Bora<br>97. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Bora<br>98. Fitojmë njohuri për gjuhën:Zhvendosja dhe heqja e | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | nënrenditëse;<br>• Identifikon dhe dallon rrethanorët dhe pyetjet me të cilat gjenden ata; | rrethanorit në fjali<br>99.Fitojmë njohuri për gjuhën: Drejtshkrim<br>100.Lexojmë-Dëgjojmë:Muajt<br>101. Lexojmë-Kuptojmë-Flasim-Shkruajmë:Muajt<br>102. Fitojmë njohuri për gjuhën: Drejtshkrim<br>103:Lexojmë_Dëgjojmë: Babadimri<br>104.Lexojmë-Kuptojmë-Flasim-Shkruajmë: Babadimri<br>Dëshirat e mia për Vitin e Ri<br>105. Lexojmë-Kuptojmë-Flasim-Shkruajmë: Pushimet e mia dimërore | | | | | |

## PLANI TREMUJOR:  Janar –Shkurt-Mars

**Fusha:** Gjuhë dhe komunikim **Lënda:** Gjuhë shqipe **Klasa IV**

**Tema mësimore:**

1. **Tekstet letrare dhe jo letrare**

Tregime, romane, poezi, prozë të shkurtër, tekste popullarizuese, tekste dramatike, përrallëza, përralla, fjalë të urta, gjëegjëzat, tekste të thjeshta, revista për fëmijë, gazeta;

Në klasë, në shkollë, në familje, në rreth, në media;
Gjuhë figurative dhe jofigurative

Mjedisi, vendbanimi;
Shfaqje teatrale,filmi;
Loja, sporti, profesione;
Tekste zyrtare dhe jozyrtare(lajmërimi, falenderimi,urimi, kërkesa, reklama, formularët e ndryshëm etj.)

2. **Gjuha figurative dhe jofigurative**

Shprehjet frazeologjike
Figurat stilistike: personifikimi, hiperbola, litota; krahasimi, homonimet

Figurat e përsëritjes

3. **Kulturë, kritikë, histori**

Elemente të përgjithshme kulturore, letrare e historike
Monumentet e kulturës

4. **Sistemi gjuhësor**

Përemrat pronorë,
Drejtshkrim
Ndajfoljet
Rrethanorët

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

1.**Komunikues efektiv**

1. Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2. Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3. dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4. Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një flmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.

6. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.

8. Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera

**2. Mendimtar kreativ**

1. Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.
2. Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).

5. Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

**5.** Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash

**6.**

**3. Nxënës i suksesshëm**

1. Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

2. Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

4. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

6 Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta.

**4.Kontribues produktiv**

IV.2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.3 Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti

**6.Qytetar i përgjegjshëm**

2. Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrën e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

3. Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**1.Të dëgjuarit dhe të folurit**

1. Përdor format më komplekse të gjuhës për të komunikuar me të tjerët për përmbajtjen dhe qëllimin e teksteve.

2. Identifkon pikat kryesore të bisedave të thjeshta dhe tregimeve që janë lexuar me zë, duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta. dëshmon prirjet e veta në lojërat skenike.

3. Interpreton tekste letrare, duke u nisur nga komentimi i ngjarjes, ideve, personazheve, rrëfimit, figurave.

6. Ndjek rregullat e paraqitjes në organizimin e shfaqjeve të caktuara dhe përzgjedh punimet për to

**2. Të lexuarit**

1. Përdor strategji për të kuptuar materialet e lexuara letrare apo joletrare: poezi, prozë, letër, biograf, lutje, raport, reklamë etj.) duke identifikuar nivele të lexim-kuptimit dhe duke bërë dallimin e gjuhës figurative nga ajo jofigurative;

2\. Identifikon pjesën themelore të ngjarjeve të tregimeve të lexuara me zë, duke përdorur fjalë të rëndësishme ose objekte vizuale (fotograf, vizatime etj.) si dhe Identifikon kategoritë gramatikore;
3\. dallon tekstet letrare nga ato joletrare;
6\. zhvillon aftësitë imagjinare dhe kreative;
7\. Identifikon kategoritë gramatikore në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare.

**3. Të shkruarit**

2\. Zhvillon aftësinë e korrigjimit të gjuhës së teksteve;
3\. Shkruan një tekst të thjeshtë (ese, tekst të ndryshëm);
4\. Shkruan lloje të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare, për tema të caktuara;
5\. Shkruan për një situatë imagjinare;
6\. Shkruan, sipas dëshirës apo me detyrë, tekste që promovojnë vlera të individit e të shoqërisë, lojës, ambientit, familjes, shkollës etj.
7\. Përdor rregulla të drejtshkrimit;
8\. Përdor drejt shenjat e pikësimit;

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për temat mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologji a e vlerësimit | Ndërlidhja e lëndës me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikular e dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Tekstet letrare dhe jo letrare**<br>1. Tregime, romane, poezi, prozë të shkurtër, tekste popullarizuese, tekste dramatike, përrallëza, përralla, fjalë të urta, gjëegjëzat, tekste të thjeshta, revista për fëmijë, gazeta;<br>Në klasë, në shkollë, në familje, në rreth, në media;<br>Gjuhë figurative dhe jofigurative<br>Mjedisi, vendbanimi;<br>Shfaqje teatrale,filmi;<br>Loja, sporti, | • Lexon tekste të ndryshme me intonacionin dhe ritmin e duhur;<br>• Avancon kulturën e lexim-kuptimit;<br>• Lexon dhe kupton fjalët në kontekste të ndryshme;<br>• Ritregon tekstin në mënyrë të pavarur;<br>• Identifikon detajet dhe çështjet kryesore të tekstit;<br>• Dallon idenë | 100. Shkruajmë-Flasim: Pushimet dimërore mbaruan<br>101. Lexojmë-Dëgjojmë: Pushimet dimërore<br>102.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim:Pushimet dimërore<br>103.Lexojmë-Dëgjojmë:Ka gjithmonë një rrugëdalje<br>104.Lexojmë-Kuptojmë-Flasim-Shkruajmë: Ka gjithmonë një rrugëdalje<br>105.Lexojme-Dëgjojmë: Breshka dhe shkaba<br>106.Lexojmë-Kuptojmë- | 60 orë | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim,sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);<br>Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim);<br>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);<br>Diskutim dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); | Informata kthyese,;<br>Vlerësim i ndërsjellë (njëri-tjetri);<br>Dy yje një dëshirë;<br>Listë kontrolli<br>Dosja personale<br>Test | Matematika<br>Shkenca natyrore<br>Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Edukimi qytetar<br><br>Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm | Librat: Gjuha shqipe 4, Leximi 3, Burime nga internet i Fletore pune |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| profesione;<br>Tekste zyrtare dhe jozyrtare(lajmërimi, falenderimi,urimi, kërkesa, reklama, formularët e ndryshëm etj.)<br><br>**Kulturë, kritikë, histori**<br>Elemente të përgjithshme | kryesore nga detaji;<br>• Dallon elementet përbërëse të një përralle dhe tregimi të shkurtër.<br>• Gjykon mbi bazën e argumenteve idetë dhe informacionin e tekstit;<br>• Krahason personazhe, ngjarje, ide, informacione, mjedise nga një tregim, nga një përrallë, nga një fabul, etj., duke konkretizuar me shembuj nga teksti;<br>• Identifikon përbërësit e | Shkruajmë-Flasim: Breshka dhe shkaba<br>107. Fitojmë njohuri për gjuhën: Kundrinorët<br>108. Fitojmë njohuri për gjuhën: Kundrinorët<br>109.Lexojmë-Dëgjojmë: Dreri në pasqyrë<br>110.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Dreri në pasqyrë<br>111. Fitojmë njohuri për gjuhën: Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë<br>112. Ushtrime për kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë<br>113. Lexojmë-Dëgjojmë: Veza e Kristofor Kolombit<br>114.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Veza e Kristofor | | Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit;<br>Mësimdhënie e bazuar në përvojë (lojë me role, dramatizim) | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| kulturore, letrare e historike<br><br>**Gjuha figurative dhe jofigurative**<br>Figurat stilistike: personifikimi, hiperbola, litota; krahasimi,homonimet<br><br>Shprehjet frazeologjike.<br><br>Figurat e përsëritjes<br><br>**Sistemi gjuhësor** | tekstit letrar (krypersonazhet/ heroin, temën, ngjarjen/subjektin, hapësirën, kohën dhe autorin/ rrëfimtarin;<br>• Klasifikon personazhet në bazë të veprimeve të tyre;<br>• Dallon poezinë nga proza, tonalitetin, ritmin, vargun, strofën, tregimin fantastik e përrallor, tregimin realist;<br>• Rrëfen rrjedhshëm për ngjarje të ndryshme; | Kolombit<br>115. Fitojmë njohuri për gjuhën: Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë<br>116. Fitojmë njohuri për gjuhën:Ushtrime për kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë<br>117. Lexojmë-Dëgjojmë: Shprehia<br>118. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Shprehia<br>119. Fitojmë njohuri për gjuhën: Ligjërata e drejtë<br>120. Fitojmë njohuri për gjuhën: Ligjërata e zhdrejtë<br>121. Lexojmë-Dëgjojmë: Gjyshja dhe nipi<br>122.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Gjyshja dhe nipi | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Drejtshkrim<br>Kundrinorët dhe llojet e tij<br>Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë<br>Folja dhe kohët<br>Fjalia, paragrafi, teksti<br>Llojet e fjalive | • Diskuton për tema të përshtatshme për moshën e tij;<br>• Shpjegon dhe argumenton disa rregulla të sjelljes në klasë dhe jashtë saj si dhe rregulla të kujdesit e mirësjelljes;<br>• Dëshmon shprehi për shoqërim me të tjerët dhe për ruajtjen e mjedisit;<br>• Përshkruan vendbanimin (fshat, qytete) dhe objektet që e karakterizojnë;<br>• Dallon karakteristikat e | 123.Lexojmë-Dëgjojmë: Keqkuptimi<br>124.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Keqkuptimi<br>125.Zhvillojmë kreativitetin-Argëtohemi: Lexoj, gjej zgjidhjen, argëtohem<br>126. Fitojmë njohuri për gjuhën:Fjalia, paragrafi dhe teksti<br>127. Lexojmë-Dëgjojmë: Dita e Pavarësisë<br>128.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Dita e Pavarësisë<br>129. Lexojmë-Dëgjojmë: Drini e Mirushja<br>130.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Drini e Mirushja<br>131.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Libri i Rekordeve<br>132.Lexojmë-Kuptojmë- | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjuhës standarde nga ato lokale;<br>• Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja në fusha të ndryshme dhe praktikon aftësitë shprehëse;<br>• Kupton frazeologjizmat dhe mënyrën e përdorimit të tyre;<br>• Parashtron pyetje dhe argumenton për periudha historike;<br>• Parashtron pyetje dhe përgjigjet për çështje kulturore;<br>• Dallon dhe i flet | Shkruajmë-Flasim: Pasuritë natyrore të Kosovës<br>133.Lexojmë-Dëgjojmë:Gjuha shqipe<br>134.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Gjuha shqipe<br>135.Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Dita e gjuhës amtare<br>136.Dëgjojmë-Kuptojmë-Analizojmë: Libri im<br>137. Fitojmë njohuri për gjuhën: Njohuri për foljen<br><br>138. Fitojmë njohuri për gjuhën: Koha e kryer e thjeshtë e foljes<br><br>139. Fitojmë njohuri për gjuhën: Drejtshkrim i foljeve në kohën e kryer të thjeshtë<br><br>140. Lexojmë-Dëgjojmë: Ushtari i | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | për koncepte bazike historike, kulturore e kritike.<br>• Identifikon dhe përshkruan disa monumente/ngjarje të kulturës;<br>• Dallon zhanret letrare nga ato joletrare: tregim, përrallë, poezi, fjalë e urtë përballë informatës, lutjes, urimit etj.<br>• Identifikon tipare historike e kulturore të një teksti letrar a joletrar;<br>• Bën lidhjen e ngjarjeve nga jeta me ato të rrëfyera në një tekst; | Lirisë<br><br>141. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Ushtari i Lirisë<br><br>142. Shkruajmë-Lexojmë-Analizojmë: Arti i shkrimit<br><br>143. Lexojmë-Dëgjojmë: Ese për mësuesen time<br><br>144. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Ese për mësuesen time<br><br>145. Shkruajmë-Lexojmë-Analizojmë: Shkruajmë ese<br>146. Lexojmë-Dëgjojmë: Dhurata për nënë<br>147. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Dhurata për nënë<br>148. Shkruajmë-Lexojmë-Analizojmë: | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | • Shpreh emocionet dhe mendime lidhur me një tekst a ngjarje<br>• Përdor tonin dhe mimikën e duhur;<br>• Kupton rëndësinë e tolerancës dhe dialogut;<br>• Identifikon dhe përdor figurat stilistike të personifikimit, krahasimit, hiperbolës dhe litotës dhe i krahason ato me metaforën;<br>• Kultivon përdorimin e gjuhës figurative.<br>• Dallon gjuhën e figurshme nga | Shkruajmë ese<br>149. Lexojmë- Dëgjojmë: Orteku<br>150. Lexojmë- Kuptojmë- Shkruajmë-Flasim: Orteku<br>151. Lexojmë- Kuptojmë- Shkruajmë- Flasim: Reshjet atmosferike<br>152. Lexojmë- Dëgjojmë: Dallëndyshja dhe harabeli<br>153. Lexojmë- Kuptojmë- Shkruajmë- Flasim: Dallëndyshja dhe harabeli<br>154. Lexojmë- Dëgjojmë: Urani<br>155. Lexojmë- Kuptojmë- Shkruajmë- Flasim: Urani<br>156. Lexojmë- Dëgjojmë: Më jep një gotë ujë<br>157. Lexojmë- Kuptojmë- Shkruajmë- Flasim: | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjuha jo e figurshme;<br>• Dallon gjuhën e prozës nga ajo e poezisë;<br>• Dallon figurat e përsëritjes: anafora, epifora etj.<br>Shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij me një fjalor të pasur duke përdorur shprehje frazeologjike, fjalë të urta, fjalë me kuptim të figurshëm etj.;<br>• Praktikon përdorimin e formave pohore dhe mohore të fjalive;<br>• Përdor drejt shenjat e pikësimit në dialog, përdor saktë shkronjën e madhe etj.<br>• Shkruan drejt | Më jep një gotë ujë<br>158. Fitojmë njohuri për gjuhën: Llojet e fjalive sipas kumtimit<br>159. Fitojmë njohuri për gjuhën: Llojet e fjalive sipas kumtimit<br>160. Lexojmë– Dëgjojmë: Asnjë punë nuk vete dëm<br>161. Lexojmë- Kuptojmë- Shkruajmë- Flasim: Asnjë punë nuk vete dëm<br>162. Dëgjojmë- Kuptojmë- Analizojmë: Libri im | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | fjalët në ligjëratën e drejtë;<br>• Zgjedhon në kohën e kryer të thjeshtë foljet e zgjedhimit të parë;<br>• Ndërton fjali të llojeve të ndryshme: nxitëse thirrmore dhe dëshirore.<br>• Dallon kundrinorin si një grup plotësues që nuk zhvendoset dhe nuk hiqet nga fjalia të cilin e gjen duke iu përgjigjur pyetjeve: çfarë? kë? | | | | | | |

# PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR

**Fusha:** Gjuhë dhe komunikim **Lënda:** Gjuhë shqipe **Klasa IV**

**Tema mësimore:**

1. **Tekstet letrare dhe jo letrare**

Tregime, romane, poezi, prozë të shkurtër, tekste popullarizuese, tekste dramatike, përrallëza, përralla, fjalë të urta, gjëegjëzat, tekste të thjeshta, revista për fëmijë, gazeta;

Në klasë, në shkollë, në familje, në rreth, në media;

Mjedisi, vendbanimi;
Shfaqje teatrale,filmi;
Loja, sporti, profesione;
Tekste zyrtare dhe jozyrtare(lajmërimi, falenderimi,urimi, kërkesa, reklama, formularët e ndryshëm etj.)

2. **Gjuha figurative dhe jofigurative**

Shprehjet frazeologjike

Figurat stilistike: personifikimi, hiperbola, litota; krahasimi, homonimetFigurat e përsëritjes

3. **Sistemi gjuhësor**

Drejtshkrim
Fjalia pohore dhe mohore
Teksti dhe fjalia

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve :**

1.**Komunikues efektiv**

1. lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2. Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3. dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

4. Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.

6. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.

8. Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera

**2. Mendimtar kreativ**

1. Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

2. Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).

5. Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

7. Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash

**.3. Nxënës i suksesshëm**

1. Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

2. Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

4. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

6 Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta.

**4.Kontribues produktiv**

IV**.**2. Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

IV.3 Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti

**6.Qytetar i përgjegjshëm**

2. Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrën e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

3. Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**1.Të dëgjuarit dhe të folurit**

1. Përdor format më komplekse të gjuhës për të komunikuar me të tjerët për përmbajtjen dhe qëllimin e teksteve.
2. Identifikon pikat kryesore të bisedave të thjeshta dhe tregimeve që janë lexuar me zë, duke përdorur fraza apo fjali të thjeshta. dëshmon prirjet e veta në lojërat skenike.
3. Interpreton tekste letrare, duke u nisur nga komentimi i ngjarjes, ideve, personazheve, rrëfimit, figurave.
6. Ndjek rregullat e paraqitjes në organizimin e shfaqjeve të caktuara dhe përzgjedh punimet për to

**2. Të lexuarit**

1. Përdor strategji për të kuptuar materialet e lexuara letrare apo joletrare: poezi, prozë, letër, biograf, lutje, raport, reklamë etj.) duke identifikuar nivele të lexim-kuptimit dhe duke bërë dallimin e gjuhës figurative nga ajo jofigurative;
2. Identifikon pjesën themelore të ngjarjeve të tregimeve të lexuara me zë, duke përdorur fjalë të rëndësishme ose objekte vizuale (fotograf, vizatime etj.) si dhe Identifikon kategoritë gramatikore;
3. dallon tekstet letrare nga ato joletrare;
6. zhvillon aftësitë imagjinare dhe kreative;
7. Identifikon kategoritë gramatikore në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare.

**3. Të shkruarit**

2. Zhvillon aftësinë e korrigjimit të gjuhës së teksteve;
3. Shkruan një tekst të thjeshtë (ese, tekst të ndryshëm);
4. Shkruan lloje të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare, për tema të caktuara;

5. Shkruan për një situatë imagjinare;
6. Shkruan, sipas dëshirës apo me detyrë, tekste që promovojnë vlera të individit e të shoqërisë, lojës, ambientit, familjes, shkollës etj.
7. Përdor rregulla të drejtshkrimit;
8. Përdor drejt shenjat e pikësimit;

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për temat mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja e lëndës me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Tekstet letrare dhe jo letrare**<br>Tregime, romane, poezi, prozë të shkurtër, tekste popullarizuese, tekste dramatike, përrallëza, përralla, fjalë të urta, gjëegjëzat, tekste të thjeshta, revista për fëmijë, gazeta;<br>Në klasë, në shkollë, në familje, në rreth, në | • Lexon tekste të ndryshme me intonacionin dhe ritmin e duhur;<br>• Avancon kulturën e lexim-kuptimit;<br>• Lexon dhe kupton fjalët në kontekste të ndryshme;<br>• Ritregon tekstin në mënyrë të pavarur; | 163. Lexojmë–Dëgjojmë: Prilli<br>164. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Prilli<br>165. Lexojmë–Dëgjojmë: Obonato!<br>166. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Obonato!<br>167. Lexojmë-Dëgjojmë-Flasim: Zbulo gjëegjëzën<br>168. Lexojmë-Dëgjojmë: Greta | 60 orë | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim,sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);<br>Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtim);<br>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); | Informata kthyese,;<br>Vlerësim i ndërsjellë (njëri-tjetri);<br>Dy yje një dëshirë;<br>Listë kontrolli<br>Dosja personale<br>Test | Matematika<br>Shkenca natyrore<br>Shoqëria dhe mjedisi<br>Edukimi qytetar<br>Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm | Librat: Gjuha shqipe 4, Leximi 3, Burime nga internet i Fletore pune |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| media;Mjedisi, vendbanimi;<br>Shfaqje teatrale,filmi;<br>Loja, sporti, profesione;<br>Tekste zyrtare dhe jozyrtare(lajmërimi, falenderimi,urimi, kërkesa, reklama, formularët e ndryshëm etj.)<br>**Gjuha figurative dhe jofigurative**<br>Shprehjet frazeologjike<br>Figurat stilistike: personifikimi, hiperbola, litota; krahasimi, homonimetFigurat e përsëritjes<br><br>**Sistemi gjuhësor**<br>Drejtshkrim<br>Fjalia pohore dhe mohore<br>Teksti dhe fjalia | • Identifikon detajet dhe çështjet kryesore të tekstit;<br>• Dallon idenë kryesore nga detaji;<br>• Dallon elementet përbërëse të një përralle dhe tregimi të shkurtër.<br>• Gjykon mbi bazën e argumenteve idetë dhe informacionin e tekstit;<br>• Krahason personazhe, ngjarje, ide, informacione, mjedise nga një tregim, nga një përrallë, nga një fabul, etj., duke | 169. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Greta<br>170. Fitojmë njohuri për gjuhën: Fjalitë pohore dhe mohore<br><br>171. Fitojmë njohuri për gjuhën: Fjalitë pohore dhe mohore<br><br>172. Lexojmë-Dëgjojmë: Na lusin malet<br><br>173. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim:Na lusin malet<br>174. Lexojmë-dëgjojmë: Mos më lini vetem<br>175. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Mos më lini vetëm<br>176. Lexojmë-Dëgjojmë: Nëna | | Diskutim dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);<br>Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit;<br>Mësimdhënie e bazuar në përvojë (lojë me role, dramatizim) | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | konkretizuar me shembuj nga teksti;<br>• Identifikon përbërësit e tekstit letrar (krypersonazhet/ heroin, temën, ngjarjen/subjektin, hapësirën, kohën dhe autorin/ rrëfimtarin;<br>• Klasifikon personazhet në bazë të veprimeve të tyre;<br>• Dallon poezinë nga proza, tonalitetin, ritmin, vargun, strofën, tregimin fantastik e përrallor, tregimin realist; | dhe vogëlushja<br>177. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim:Nëna dhe vogëlushja<br>178. Fitojmë njohuri për gjuhën: Drejtshkrim/Shenjat e pikësimit<br>179. Fitojmë njohuri për gjuhën: Drejtshkrim/Shenjat e pikësimit<br>180. Lexojmë-Kuptojmë-Analizojmë: Libri im<br>181. Lexojmë-Kuptojmë-Analizojmë: Libri im<br>182. Lexojmë-Dëgjojmë: Dy kopshtarë<br>183. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Dy kopshtarë<br>184. Lexojmë-Dëgjojmë:**Gjërat më të forta në botë**<br>185. Lexojmë- | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | • Familjarizohet me shfaqjen teatrale, teatrin e kukullave, filmin vizatimor, serialin televiziv etj.<br>• Rrëfen rrjedhshëm për ngjarje të ndryshme;<br>• Diskuton për tema të përshtatshme për moshën e tij;<br>• Shpjegon dhe argumenton disa rregulla të sjelljes në klasë dhe jashtë saj si dhe rregulla të kujdesit e mirësjelljes;<br>• Dëshmon shprehi për shoqërim me të tjerët dhe | Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: **Gjërat më të forta në botë**<br>186. Lexojmë – Dëgjojmë: Enardi<br>187. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Enardi<br>188. Lexojmë-Kuptojmë: Orhidea<br>189. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Orhidea<br>190. Lexojmë-Dëgjojmë: Fluturimi i parë<br>191. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Fluturimi i parë<br>192. Lexojmë-Dëgjojmë-Kuptojmë-Flasim: Intervista<br>193. Lexojmë-Dëgjojmë-Kuptojmë-Flasim: Filmi<br>194. Lexojmë-Dëgjojmë-Kuptojmë-Flasim: | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | për ruajtjen e mjedisit;<br>• Përshkruan vendbanimin (fshat, qytete) dhe objektet që e karakterizojnë;<br>• Dëgjon/shikon e komenton biseda të xhiruara;<br>• Vlerëson fjalët dhe sjelljet e veta dhe të bashkëbiseduesit;<br>• Dëshmon prirjet e veta në lojërat skenike;<br>• Dëgjon tekste të shkurtra joartistike (të lexuara, të xhiruara e të ekranizuara) kryesisht tekste popullarizuese që | Filmi<br>195. Lexojmë-Dëgjojmë-Kuptojmë-Flasim: Intervista me një shkrimtar për fëmijë<br>196. Lexojmë-Dëgjojmë: Dielli, Yjet dhe Hëna<br>197. Lexojmë-Dëgjojmë: Dielli, Yjet dhe Hëna<br>198. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Një ditë në gjithësi<br>199. Lexojmë-Dëgjojmë: Krahët e këngës<br>200. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Krahët e këngës<br>201. Zhvillojmë mendimin kritik:Aktivitete logjike<br>202. Zhvillojmë mendimin kritik: Gjej fjalët e fshehura<br>203. Dëgjojmë-Kuptojmë-Analizojmë: Libri | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | lidhen me lojëra sportive, me muzikën dhe me profesione të ndryshme, dhe jep mendim për to;<br>• Dallon karakteristikat e gjuhës standarde nga ato lokale;<br>• Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja në fusha të ndryshme dhe praktikon aftësitë shprehëse;<br>• Kupton frazeologjizmat dhe mënyrën e përdorimit të tyre;<br>• Dallon tekstet zyrtare nga ato jozyrtare | im<br>204. Dëgjojmë-Kuptojmë-Analizojmë: Libri im<br>205. Lexojmë-Dëgjojmë: Një qershori<br><br>206. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Një qershori<br><br>207. Lexojmë-Kuptojmë-Dramatizojmë: Kush jemi ne?!<br><br>208. Lexojmë-Kuptojmë-Dramatizojmë: Kush jemi ne?!<br>209. Lexojmë-Dëgjojmë: lojëra dhe aktivitete argëtuese<br>210. Lexojmë-Dëgjojmë: Ty të dua si shok<br>211. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Ty të dua si shok | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | (lajmërimin, arsyetimin, falënderimin, kërkesën, reklamën, formularët e ndryshëm, shpalljet publike etj.);<br>Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja në fusha të ndryshme.<br>• Identifikon dhe përdor figurat stilistike të personifikimit, krahasimit, hiperbolës dhe litotës dhe i krahason ato me metaforën;<br>• Kultivon përdorimin e gjuhës figurative.<br>• Dallon gjuhën e figurshme nga gjuha jo e | 212. Lexojmë-Dëgjojmë: Kokrra e grurit ecte…<br>213. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Kokrra e grurit ecte…<br>214. Lexojmë-Dëgjojmë: Dita e Paqes<br>215. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Dita e Paqe<br>216. Lexojmë-Dëgjojmë: Pikëpyetja<br>217. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Pikëpyetja<br>218. Lexojmë-Dëgjojmë: Qentë mendojnë se ne jemi lule<br>219. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Qentë mendojnë se ne jemi lule<br>220. Lexojmë-Dëgjojmë: Shoqet e ngushta | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | figurshme;<br>• Dallon gjuhën e prozës nga ajo e poezisë;<br>• Dallon figurat e përsëritjes: anafora, epifora etj.<br>Shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij me një fjalor të pasur duke përdorur shprehje frazeologjike, fjalë të urta, fjalë me kuptim të figurshëm etj.;<br>• Praktikon përdorimin e formave pohore dhe mohore të fjalive;<br>• Përdor drejt shenjat e pikësimit në dialog, përdor saktë shkronjën e madhe etj. | 221. Lexojmë-Kuptojmë-Shkruajmë-Flasim: Shoqet e ngushta<br>222. Lexojmë-Shkruajmë-Flasim: Gjeni 5 dallime<br>223. Shkruajmë-Lexojmë-Dëgjojmë-Flasim: Fundi i vitit shkollor<br>224. Shkruajmë-Lexojmë-Dëgjojmë-Flasim: Fundi i vitit shkollor<br>225. Shkruajmë-Lexojmë-Dëgjojmë-Flasim: Çfarë mësova në klasën e katërt? | | | | | |

# PLANIFIKIMI JAVOR

Lënda e *Gjuhës shqipe* zhvillohet në *gjashtë orë* në javë. Gjatë javës është parashikuar të zhvillohen rreth *dy pjesë leximi*, në *tri–katër orë mësimore*. Orët e tjera lidhen me temat e të folurit, të të shkruarit dhe të trajtimit të njohurive gjuhësore.

Megjithëkëtë ndarje, jo çdo javë i ka të përfaqësuara të gjitha shkathtësitë brenda saj. Në temat e dhëna ka ndërthurje të ndryshme:

- Temat e leximit, tema për të folurit, për të shkruarit dhe për njohuritë rreth gjuhës;
- Temat e leximit, tema për të folurit, gramatikë dhe njohuritë rreth gjuhës;
- Temat e leximit, tema për të folurit, për të shkruarit, gramatikë etj.

Në përgjithësi, çdo javë nis me **një pjesë leximi**, e cila mund të jetë një histori nga jeta e përditshme, një histori e trilluar, një tregim, përrallë, vjershë etj.

Pas saj vjen rubrika "**Fjalor xhepi**", në të cilën jepet fjalorthi me fjalë të reja për nxënësit. Me fjalë dhe shprehje lidhen edhe ushtrime të caktuara gjuhësore. Më tej, jepen pyetje dhe ushtrime rreth analizës së përmbajtjes së pjesës, të veprimeve dhe sjelljes së personazheve, të ideve dhe të mësimeve që dalin prej tyre. Pas pjesës së leximit, vijnë temat për të folurit, tema për të shkruarit dhe për njohuritë rreth gjuhës shqipe, ku përfshihen njohuri dhe ushtrime morfologjike, sintaksore, leksikore dhe drejtshkrimore.

Temat për të folurit dhe për të shkruarit **nuk** janë përcaktuar me tituj të veçantë. Kjo me synim që mësuesi t'i trajtojë ashtu si mendon se është më mirë për fëmijët. Ushtrimet e dhëna si në pjesët e leximit ashtu edhe në rubrikat e tjera janë të natyrave të ndryshme dhe kanë synime të caktuara didaktike. Ato janë:

- ***Ushtrime të të lexuarit dhe të shprehurit***, që synojnë ta ushtrojnë nxënësin në lexim, ritregim, përshkrim, interpretim, dramatizim, diskutim, reflektim vetjak etj.;
- ***Ushtrime analizuese, vlerësuese dhe gjykuese***, që e vënë nxënësin të analizojë situata e sjellje të caktuara, të reflektojë ndaj tyre, të bëjë krahasime ngjarjesh, historish, përrallash, personazhesh, situatash etj., të nxjerrin mesazhe, zgjidhje të situatave të ndryshme, të flasin për përvojat vetjake përmes shembujve, të mbajnë qëndrime etj.;
- ***Ushtrime të kuptimit të fjalëve të reja***, të pasurimit e fjalorit me fjalë e shprehje nga fusha të ndryshme, të nuancave kuptimore e të fjalëve etj.;
- ***Modele të ndryshme shkrimi***, të tipit: këshillë, kartolinë, listë, udhëzim, letër, njoftim, porosi, pyetje–përgjigje etj., nëpërmjet të cilave nxënësi do të fitojë shprehitë kryesore të komunikimit me gojë dhe me shkrim, të ndërveprojë me informacionet e marra nga jeta e përditshme, nga bota e natyra përreth, nga ngjarjet dhe shpikjet e ndryshme, si dhe të shprehë mendimin, vlerësimin dhe botën emocionale;
- ***Ushtrimet gjuhësore***. Nëpërmjet ushtrimeve, nxënësi mëson për kategoritë gramatikore, si: *emri* (gjininë dhe numrin e tij); *mbiemri* (gjininë dhe numrin e tij); mbiemri dhe llojet e tij, ndajfolja dhe llojet e saj,*folja* dhe kohët e saj kryesore; *fjalinë* dhe llojet e saj (dëftore dhe pyetëse); format e shfaqjes: *pohore* dhe *mohore*; *rendin* e fjalëve në fjali; përdorimin e shkronjës së madhe; ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit; shenjat e pikësimit në fund të fjalisë etj.;

# GJUHA SHQIPE 4

# A

| |
|---|
| **Njësia mësimore: PRAPË NË SHKOLLË** |
| **Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II**<br>**Lënda:** Gjuha amtare Klasa: IV |

| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës:<br>- |
|---|---|

| |
|---|
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.1. I.3. I.6.<br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1.III.3.III.4.III.8.<br>V.8.VI.2. VI.3VI.3.VI.4. |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 |

| | |
|---|---|
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: PRAPË NË SHKOLLË** | |
| **Fjalët kyçe**: shkolla, rikthimi, porosia | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br>- Tregon pozitën e tij në shkollë.<br>- Numëron përgjegjësitë e tij në klasë.<br>- Interpreton porositë e dhëna nga mësuesja në libër. | **Kriteret e suksesit:**<br>-Numëro së paku dy përgjegjësi që ke në klasë.<br>-Interpreto disa porosi të mësueses. |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br>Libri bazë, fletë e bardhë A4, fletore | |

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Edukata fizike

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Secilit nxënës i ofrohet një fletë e bardhë.

Në mes të fletës secili nxënës vizaton veten se si po duket në këtë ditë, si i ka flokët dhe çfarë ka të mbathur.

Rreth vetës nxënësi mund të shkruaj se si po ndjehet, çfarë pret nga ky vit, çfarë objektivash ka dhe cilat rezultate ka dëshirë dhe synim t'i arrijë. Vëmendje e veçantë në këtë fletë le t'i jepet dhe gjërave të veçanta në klasë, ndryshimet që i vërejnë te mësimdhënësi dhe shokët e klasës.



Fletët ekspozohen në mur të klasës.

**Ndërtimi i njohurive:**

Nxënësit komentojnë se si i kuptojnë ata porositë e mësuese Ninës.

Mësuesi i klasës jep një porosi, dikton atë dhe nxënësit e shkruajnë në hapësirën e librit bazë.

Nxënësit në fletoret e tyre krijojnë tabelën e ditarit dypjesësh dhe në njërën anë shkruajnë porosinë e preferuar dhe në tjetrën e arsyetojnë se përse e pëlqyen këtë porosi më shumë.

| Porosia e pëlqyer | Komenti |
| --- | --- |
| | |

**Përforcimi:**

**Shkrim i lirë**

Nxënësit i shkruajnë letër mësimdhënësit me titullin: ***Në klasë të katërt dua që mësuesi im të..***

Nxënësve u sqarohet që letra është anonime dhe në të mund të shkruhen këshilla, sugjerime, kërkesa mësuesit për mësimdhënien apo mënyrën e organizmit të klasës.

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Vizatohet ambienti i klasës në ditën e parë të klasës së katërt.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Njësia mësimore: PUSHIMET E MIA VERORE | |
|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II**<br>**Lënda:** Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.1. I.3. I.6.<br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1.III.3.III.4.III.8.<br>V.8.VI.2. VI.3VI.3.VI.4. | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**<br>1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: PUSHIMET E MIA VERORE** | |
| **Fjalët kyçe:** pushime, verë, | |
| **Rezultati/et e tënxënittëorësmësimore:**<br>- Përshkruan pushimet verore.<br>-Veçon momente të lumtura krahas momenteve më pak të lumtura. | **Kriteret e suksesit:**<br>- Ndaj një moment të bukur të pushimeve verore, me shokët e shoqet e klasës. |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br>Libri bazë, | |
| **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Loja M&M**

Mësimdhënësi ul në rreth të gjithë nxënësit.

Në tabelë shkruhen gjashtë pyetje për secilën ngjyrë.
Nëse mësimdhënësi mund të sigurojë çokollatat M&M atëherë i ofron secilit nxënës nga dy çokollata të zgjedhura rastësisht. Ngjyra e çokollatave e orienton nxënësin në pyetjen që duhet të përgjigjet. Në rast se mësimdhënësi nuk arrin të sigurojë çokollatat atëherë loja luhet me ngjyra të drurit. Ngjyrat vendosen në mes të rrethit dhe secili nxënës kur e ka radhën zgjedh dy ngjyra me sy të mbyllur.

Pyetjet mund të jenë këto:

**Përshkruaj me 5 fjalë librin e lexuar gjatë pushimeve verore.**

**Si quhen njerëzit e rinj që ke njohur gjatë këtij pushimi?**

**Pesë aktivitetet që i ke bërë me shumë qejf në pushim?**

**Fjalët e reja që i ke mësuar janë?**

**Vendi i preferuar për të kaluar mesditën ka qenë?**

**Këngët që i ke dëgjuar më me qejf në pushim janë?**

Kjo bëhet me qëllim që shokët të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit dhe të bashkëbisedimit me njëri-tjetrin.

*(Tabela e pyetjeve mund të prezantohet dhe në PoëerPoint)*

**Ndërtimi i njohurive:**

Plotësohet rubrika në librin bazë.

| |
|---|
| Secili nxënës ndan me shokët përjetimet e mira dhe jo të mira nga vera e kaluar.<br>**Përforcimi:**<br>Secili nxënës shkruan në fletë të bardhë ese përshkruese me titullin: Kjo verë për mua ka qenë... Asnjëri nxënës nuk bën të shkruaj emrin e tij në fletë, pra shkrimet janë anonime. Pasi të kenë kaluar 15 minuta, mësimdhënësi kërkon që të gjithë nxënësit të vendosin fletët e bardha në mes. Secili nxënës merr nga një fletë të shokut dhe provon ta gjej se cili nga ta e ka shkruar atë (bazuar në përgjigjet e lojës M&M dhe në përjetimet e ndara në pjesën e dytë). Nxënësit vlerësojnë me informatë kthyese dhe figura punën e shokëve të grupit.<br>Punimet vendosen në murin e klasës. |
| **Vlerësimi:** |
| Informatë kthyese<br>Vlerësim me figura<br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Nxënësit ilustrojnë ditën e tyre më të bukur të kaluar gjatë pushimeve verore. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Njësia mësimore: PREMTIMET E MIA PË KËTË VIT SHKOLLOR | |
|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II**<br><br>**Lënda:** Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br><br>*I.1. I.3. I.6.*<br>*II.2. II.3. II.5.*<br>*III.1.III.3.III.4.III.8.*<br>*V.8.VI.2. VI.3VI.3.VI.4.* | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**<br><br>*1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.*<br>*2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7*<br>*3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8* | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: PREMTIMET E MIA PË KËTË VIT SHKOLLOR** | |
| Fjalët kyçe: premtim, nënshkrim, realizim | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Përshkruan se si do tëmbajëpremtimet e dhëna.<br>- Numëron tri premtimeqë do tëprovojë t'i mbajënëkëtë vit shkollor.<br>- Dallonpremtimetngaobjektivat.<br>. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Numëro së paku tri premtime që do të zotohesh t'i mbashë. |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br><br>Libri bazë, fletorja, hameri | |
| **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet | |

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Parashikimi:**
**Rrjeti i diskutimit**

Mësimdhënësi parashtron temën për diskutim:
Çfarë premtime i jap unë vetës dhe mësimdhënësit për këtë vit shkollor?

Sqarohet se çfarë janë premtimet dhe sa është e rëndësishme që të mbahen ato.

Secili nxënës e thotë nga një premtim.

**Ndërtimi i njohurive:**

Kërkohet nga nxënësit që të plotësojnë petalet e luleve në librin bazë.

Të gjitha premtimet e dhëna lexohen brenda grupit. Shkëmbehen firmat mes nxënësve me premtimin që do të mundohen t'i realizojnë të gjitha premtimet e dhëna.

Në një fletë A4 nxënësit e grupit diskutojnë se cilat janë premtimet që si grup duhet t'i mbajnë në klasë dhe në shkollë.

Mësimdhënësi përgatit për secilin grup nga 4 pjesë të ***Puzzles*** dhe të gjitha pjesët bëhen bashkë dhe vendosën në murin e klasës, në një vend të përhershëm që nxënësve të ju kujtohen sa herë t'i shohin.



**Përforcimi:**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në dyshe. Secili nxënës duhet të ketë një shok të cilit i drejton letrën. Në rast se klasa ka numër tek të nxënësve atëherë përfshihet dhe mësimdhënësi.

Letra do të shkruhet me titullin: **Ty, shoku/qja im/e**

| |
|---|
| Letra ka për qëllim që fëmijët të reflektojnë për sjelljen, kulturën e punës, qasjen e shokut dhe t'i drejtojë letrën me këshilla e sugjerime për këtë vit shkollor.<br><br>*Kujtojmë që gjithmonë duhet të nisemi nga anët pozitive për të vazhduar tek aspektet ku shoku mund të përmirësohet.* |
| |
| Informatë kthyese, Vetëvlerësim, Vlerësim i ndërsjellë |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| Të shkruhen dhe ilustrohen premtimet në një flete dhe ajo fletë të vendoset në dollapin personal të nxënësit në shtëpi. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Njësia mësimore: MJAULLIMA | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: **Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II**<br>Lënda: **Gjuha amtare** **Klasa:** IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br><br>I.1. I.3. I.6.<br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1.III.3.III.4.III.8.<br>V.8.VI.2. VI.3VI.3.VI.4. | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**<br><br>1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: MJAULLIMA** | |
| **Fjalët kyçe:** mjaullimë, klasë, nxënës, shoqëri | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Ilustron pjesën e pëlqyer.<br>- Krahason ditën e tijtë dytë në shkollë me atë të shokëve të tregimit.<br>- Identifikon elementet kyçe të tregimit. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>**-**Analizo ngjarjet në tekst.<br><br>-Krahaso ditën e dytë në shkollën tënde me atë të tregimit. |
| Burimet, mjetet e konkretizimitdhematerialetmësimore:<br>Libribazë, fletorja, ngjyrat e drurit | |
| **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br><br>Artet, Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Mësuesja hap diskutimin, me pyetjen:

- Çfarë ndryshime vëreni te shokët dhe te ambienti i klasës që nga viti i kaluar?

Diskutimi në klasë mund të orientohet me pyetjet:

- Çfarë ju bën të doni këtë klasë?
- Çfarë mund të ndryshojmë që klasa jonë të duket një vend edhe më i këndshëm?
- Çfarë do të donit të ndryshonit në ambientin e klasës?
- Çfarë do të donit që shkolla të ju lejojë që ju ta bëni?

**Ndërtimi i njohurive:**

Secili nxënës në fletoren e tij shkruan titullin dhe vizatojnë Diagramin e Venit.

Nxënësit ftohen që ta lexojnë individualisht tregimin "Mjaullima" dhe pasi të kenë kuptuar mirë tregimin e krahasojnë klasën e tregimit me klasën e tyre, duke i identifikuar të përbashkëtat dhe dallimet në mes të këtyre klasave.




Nxënësit lexojnë vullnetarisht pikat e identifikuara në Diagram.

**Përforcimi:**

Nxënësit pasi të lexojnë elementet e Diagramit, në fletë të veçantë ndajnë fletën në dy pjesë të barabarta.

Në njërën anë të fletores e shkruajnë pjesën e pëlqyer të tregimit,ndërsa në pjesën tjetër e ilustrojnë atë pjesë.

Nxënësit shkëmbejnë fletoret e tyre në çift dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit me komente kthyese.

| Pjesa e pëlqyer | Ilustrimi |
|---|---|
| | |

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

Vlerësim i ndërsjellë

Dy yje një dëshirë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Njësia mësimore: SOT KLASA JONË | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.1, I.2, I.3; I.6<br>II.2; II.3<br>III.1., III.3., III.4.III.8.<br>V.8.<br>VI.2., VI.3.,VI.4. | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: SOT KLASA JONË** | |
| Fjalët kyçe: klasa, nxënës, poezi, rritje | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br>- Rendit vargjet sipas kuptimit.<br>- Nxjerr mesazhin e poezisë.<br>- Krahason klasën e vet me klasën e poezisë. | **Kriteret e suksesit:**<br>-Shkruaj me disa fjali mesazhin e poezisë.<br>-Krahaso klasën e poezisë me klasën tënde. |
| Burimet, mjetet e konkretizimitdhematerialetmësimore:<br>Libri bazë, fletorja, copëzat e përziera, fletë A4 me ngjyra | |

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Copëzat e përziera**

Mësimdhënësi parapërgatit për secilin nxënës nga një fletë punuese. Poezinë "Sot klasa jonë" ai e ndan në vargje dhe krijon me to copëza të përziera. Secilit nxënës u jepen copëzat e përziera dhe nga një fletë A4 me ngjyra.

Nxënësve inkurajohen të dëgjojnë me vëmendje ngase u lexohet vetëm një herë poezia nga mësimdhënësi.

Pastaj secili nxënës duhet të rendis vargjet sipas kuptimit dhe t'i ngjitë vargjet në fletën A4.

Hapet libri dhe secili nxënës vetëvlerëson punën e bërë.

Inkurajohen nxënësit që në vlerësime të shënojnë elementet  e forta të punës dhe të shkruajnë këshilla për herë të tjera.

*Si mund të duket fleta A4, pas përfundimit të punës, shembull:*




**Ndërtimi i njohurive:**

**DLTA**

Secili nxënës veç e veç lexon me zë të lartë poezinë, poashtu inkurajohen për interpretim artistik duke i kushtuar vëmendje të veçantë intonacionit.

* Është e rëndësisë së veçantë që secili nxënës të vlerësohet me informatë kthyese për leximin e bërë.

| |
|---|
| Bashkërisht identifikohet porosia që na jep poezia.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>**Pyetja nxjerr pyetjen**<br><br>Mësimdhënësi hap temën për diskutim:<br><br>Çfarë ndryshimesh vëreni te vetja tash që keni ndryshuar klasën dhe çfarë prisni nga ky vit shkollor?<br><br>Diskutimi bëhet brenda shokëve të klasës dhe mësimdhënësi inkurajon vazhdimisht nxënësit që t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit. |
| |
| Informatë kthyese<br>Vetëvlerësim |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Nxënësi shkruan për temën:<br><br>"Unë po rritem" |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Njësia mësimore: MËSIMI I LISËS | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.1. I.3. I.6.<br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1. III.3. III.4. III.8.<br>V.8. VI.2. VI.3 VI.3. VI.4. | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: MËSIMI I LISËS** | |
| Fjalët kyçe: shtypshkronjë, libra, lexim, bibliotekë | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Nxjerr mësime nga tregimi **Mësimi i Lisës**.<br>- Krahason bibliotekën me shtypshkronjën.<br>- Identifikon informatat e njohura nga të panjohurat të paraqitura në tekst. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Analizo ngjarjet në tekst.<br>-Shkruaj së paku dy fjali për të krahasuar bibliotekën me shtypshkronjën. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, internet | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhë amtare, shoqëria dhe mjedisi | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Shkruhet në tabelë fjalia
**"Mos gjyko një libër nga kopertina"**
Ftohen nxënësit që brenda grupit të diskutojnë për këtë fjali dhe të shkruajnë tri mendime pro apo kundër kësaj fjalie. Pra, nxënësit diskutojnë dhe vendosin se a pajtohen apo jo me këtë thënie duke shkëmbyer dhe përvojat e tyre me njëri-tjetrin.

Nxënësve ju lëshohet një video se si duket bibliotekat brenda dhe kërkohen nga ta mendime mbi:

- Rregullat në bibliotekë
- Krahasimi i bibliotekës me librarinë
- Gjurmimi i librave në biblotekë

**Ndërtimi i njohurive:**

Meqenëse ky tregim ofron shumë informacione të reja, ftohen nxënësit që të lexojnë me vëmendje tregimin dhe afër çdo informacioni që ata njohin, të shkruajnë shenjën , kur mësojnë diçka të re e veçojnë me shenjën + dhe kur nuk kuptojnë diçka e veçojnë me pikëpyetje ?.

**Përforcimi:**
Këto informata të veçuara nxënësit i organizojnë në fletoren e tyre pasi të bëjnë tabelën me tri ndarje.




Disa nxënës vullnetarë i lexojnë informatat e veçuara dhe i diskutojnë më shokët zgjedhjet e tyre.

Vlerësim me figura

| |
|---|
| Vetëvlerësim |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Nxënësit për shtëpi mund të zgjedhin të shkruajnë për një temë, si:<br>“Lexoj, sepse leximi më jep krahë”,<br>“Libri që dua të shkruaj flet për..” |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **Njësia mësimore: NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR EMRIN** | |
|---|---|
| **Fusha kurrikulare**: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>**Lënda:** Gjuha amtare | **Klasa:** IV |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.1. I.3. I.6.<br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1. III.3. III.4. III.8.<br>V.8. VI.2. VI.3 VI.3. VI.4. | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**<br>1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR EMRIN** | |
| Fjalët kyçe: emri, morfologji, gjini, numër | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Veçon emrat në një përmbajtje teksti.<br>- Dallon emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm.<br>- Analizon emrat sipas kategorive. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Nënvizoemrat e dhënënëtekst.<br>-Dalloemrat e përveçëmngaatatëpërgjithshëm. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**
**(Stuhi mendimesh)**
Shkruhet në mes të tabelës titulli EMRI.

Meqenëse është fjalë shumë e dëgjuar dhe temë e trajtuar dhe më parë, inkurajohen nxënësit që të thonë të gjitha informatat që ju bien në mend kur dëgjojnë fjalën ***Emër***.

Inkurajohen që të kujtojnë dallimet në gjini të emrit, në numër, në trajtë dhe të bëhet dallimi në mes emrave të përveçëm dhe të përgjithshëm.

**Ndërtimi i njohurive:**

**(Vëzhgo, analizo, plotëso)**

Mësimdhënësi paraprakisht krijon një tabelë në tabelë. Në këtë tabelë i shkruan të gjitha kategoritë dhe bashkërisht me nxënësit e plotësojnë.

Mësimdhënësi analizon tekstin e dhënë në fund të librit bazë. Gjyshi i saj, një vit më parë, e kishte marrë me vete dhe i kishte shpjeguar se si kishte punuar në atë pallat trembëdhjetë katesh për dyzet vjet me radhë. Gjyshi ia kishte sqaruar se pse quhej ***Pallat i Shtypit*** dhe se aty ishte një shtypshkronjë e madhe me emrin “Rilindja” dhe aty brenda një viti botoheshin së paku 300 libra artistikë, gazeta e revista të ndryshme. Fillohet me fjalinë e parë:

| Emri | Gjinia | Numri | Rasa | Trajta |
|---|---|---|---|---|
| *Gjyshi* | *Mashkullore* | *Njëjës* | *Emërore* | *E shquar* |
| | | | | |
| | | | | |

**Përforcimi:**

Nxënësve u jepet detyra në çift:

Në tekstin e dhënë në fillim të librit bazë, gjej 3 emra njerëzish, 3 emra vendesh, 3 emra sendesh dhe identifikoni: numrin, rasën, gjininë dhe trajtën e numrave.

Nxënësit vlerësojnë me dy yje dhe një dëshirë bashkëpunimin dhe punën e shokëve.

(Detyra lidhet me këtë tekst: *Ishte një ditë e bukur gushti. Lisa tashmë kishte ditëlindjen e saj të dhjetë. Prindërit e saj kishin vendosur që atë ditë të bënin një shëtitje në qytetin e gjyshit. Babai i saj, ishte bir i një redaktori librash, ndaj leximin e kishte pasion që nga fëmijëria. Ndërsa, e ëma ishte mësuese. Pasi drekuan bashkë, babai mori rrugën andej nga Pallatii Shtypit, ku shkruhej më të madhe "Rilindja". Lisa tashmë ishte hera e dytë që shkonte andej pari.*)

Informatë kthyese

Vlerësim i ndërsjellë

Dy yje një dëshirë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Plotësohet aparati pedagogjik në librin bazë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| |
|---|
| **Njësia mësimore: Njësia mësimore: DITARI I PANDEMISË** |
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV |

| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës:<br><br>- |
|---|---|

| |
|---|
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.1, I.2, I.3; I.6<br><br>II.2; II.3<br><br>III.1., III.3., III.4.III.8.<br><br>V.8.<br><br>VI.2., VI.3.,VI.4. |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10<br><br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br><br>3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 |

| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: DITARI I PANDEMISË** | |
| Fjalët kyçe: pandemi, ditar, gjyshe, gjysh | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Numëron rregullat e kujdesit në kohë pandemie.<br>- Shpjegon se çfarë është pandemia.<br>- Identifikon elementet e ditarit. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Numëro disa rregulla të mbrojtjes nga Covid 19.<br>-Trego disa emocione që përjetove gjatë izolimit në pandemi. |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, hameri |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |

**Parashikimi:**
**DLTA**

Ashtu si udhëzon libri bazë, tregimi “Ditari i pandemisë” lexohet me ndalesa.

Një nxënës lexon një pjesë dhe parashtrohen pyetjet e dhëna në libër, vazhdohet me lexim nga nxënësit e tjerë dhe parashtrohen të gjitha pyetjet.

Nxirret mesazhi i tregimit.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Diagrami i Venit**

Pasi është kuptuar mirë përmbajtja e tregimit, nxënësit udhëzohen që të vizatojnë dy rrathë në fletore për të krijuar Diagramin e Venit. Në njërën anë do të shkruhen elementet që e karakterizojnë pandeminë e Diellit dhe Hanës, kurse në tjetrën do të shkruhen elementet që e karakterizuan pandeminë e secilit nxënës. Në hapësirën e përbashkët shkruhen të përbashkëtat.



**Përforcimi:**

**Kalendari i aktiviteteve**

Secilit grup i ofrohet nga ½ e hamerit. Çdo grup duhet të krijoj këtë model kalendari prej 30 hapësirash. Në secilën ditë duhet të shkruajnë një aktivitet të veçantë që fëmijët mund të bëjnë ndërkohë që janë të izoluar për një apo arsye tjetër.

**Modeli i kalendarit:**




**Kalendari mund të emërohet dhe dizajnohet sipas dëshirës.*
Aktivitetet duhet të jenë të këndshme dhe të realizueshme në kushte shtëpie.
Nxënësit prezantojnë kalendarin dhe vlerësohen nga shokët e grupeve tjera dhe mësimdhënësi.
Të gjitha punimet vendosen në murin e klasës.

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Plotësohet aparati pedagogjik.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Njësia mësimore: EMRAT KONKRETË DHE ABSTRAKË | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema:** | **Rezultatiitënxënittëtemës:**<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.1. I.3. I.6.<br><br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1. III.3. III.4. III.8.<br>V.8. VI.2. VI.3 VI.3. VI.4. | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>1.1; 1. 2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: EMRAT KONKRETË DHE ABSTRAKË** | |
| Fjalët kyçe: emri, ndarja, konkret, abstrakt | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Plotëson emrat konkretë dhe abstraktë në tekste të zgjedhura.<br>- Dallon emrat konkretë nga emrat abstraktë.<br>- Identifikon emrat konkretë dhe abstraktë në një përmbajtje teksti. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Listo emrat konkretë dhe abstraktë në tekstin e dhënë.<br>-Plotëso tekstin me emra konkretë dhe abstarktë. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**(Stuhi mendimesh)**
Jepen shembuj të fjalëve dhe fjalive në tabelë nga mësimdhënësi për të dalluar emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm, emrat konkretë dhe abstraktë. Shembujt diskutohen me nxënësit.

Më pas nxënësit në një tekst të shkurtër identifikojnë emrat dhe me ndihmën e mësimdhënësit i klasifikojnë ata nëse janë emra të përgjithshëm, të përveçëm, konkretë apo abstraktë duke u bazuar edhe në definicionet dhe lidhjen me realitetin përmes shembujve nga jeta e përditshme.

**Ndërtimi i njohurive:**
**(Leksion i avancuar- punë në grupe)**

Mësimdhënësi sqaron konceptet kryesore të mësimit, diskuton dhe i bën më të pranueshme dhe të kuptueshme definicionet për emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm, por fokusin kryesor e ka te emrat konkretë dhe abstraktë, të cilët i sqaron me shembuj edhe nga libri. Pastaj i ndan nxënësit në katër grupe dhe për secilin grup e ndan nga një detyrë. Brenda detyrës ka nëndetyra dhe secilit nxënës i bie që të jetë i angazhuar individualisht dhe në grup. Po japim njërën detyrë si shembull. Detyrat tjera janë në libër.

1. Gjej 10 emra në tekstin e mëposhtëm, sikur emri *Hana*, nënvizoji dhe vendosi në tabelë sipas kërkesave të tabelës.

*Unë dhe Hana u zgjuam më herët se më parë. Prej se kemi ardhur te gjyshërit në fshat, kemi hapësirë më shumë për të lëvizur. I ndihmojmë gjyshit për t'i mbjellë pemët. Më duket se jemi më larg nga bota e pandemisë. Bashkë me Hanën i ndihmuam edhe gjyshes për të mbjellë qepët dhe hudhrat. Gjyshja thoshte se qepët dhe hudhrat janë kundër çdo sëmundje ngjitëse. Në mbrëmje, secili nga ne u mbyll në shtëpinë e gjyshit, prej nga nuk dëgjohej as zhurmë makine, as ajo e autoambulancës. Dëgjohej vetëm zëri i televizorit, që gjyshi e ngre më lart se zakonisht, pastaj struket në një qoshe sikur të ketë parë ujkun në dimër.*

| Emrat | e përgjithshëm | e përveçëm | konkretë | abstraktë |
|---|---|---|---|---|
| Hana | - | + | + | - |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

Mësimdhënësi, derisa nxënësit plotësojnë detyrat sipas ndarjes grupore, i mbikëqyr duke lëvizur nëpër grupe dhe duke i udhëzuar se si të punojnë dhe nëse kanë nevojë jep sqarime shtesë për kryerjen e detyrës me sukses.

**Përforcimi:**

**(Shqyrtim i përbashkët- prezantim i detyrave grupore)**

Pasi secili grup përfundon detyrën grupore, mësimdhënësi kërkon nga ata që t'i prezantojnë ato me radhë. Përderisa prezanton grupi i parë tabelën më lart të plotësuar secili nxënës i grupit në mënyrë të barabartë lexon shembujt e plotësuar sipas klasifikimit të bërë, ndërsa grupet tjera plotësojnë detyrën nr. 1 dhe kështu vazhdohet me radhë me detyrat e grupeve tjera. Në rast të ndonjë gabimi ose nevoje për plotësim e marrin fjalën edhe nxënësit e grupeve tjera ose mësimdhënësi. Në fund, të gjithë nxënësit janë të përfshirë individualisht dhe në grup dhe secili plotëson të gjitha detyrat për një kohë të shkurtër. Njëherësh kjo ecuri shpërfaq edhe arritjen e rezultateve të orës dhe gjithëpërfshirjen.

Nxënësit vlerësojnë shembujt e plotësuar dhe të prezantuar të njëri-tjetrit.

| |
|---|
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë<br><br>Lista e kontrollit |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| **Kërkesë**: Pasi plotësohen emrat në vendin e duhur në tekstin e mësipërm të detyrës nr. 4, nga grupi 4, nxënësit në shtëpi formojnë një tabelë me dy shtylla. Në njërën shtyllë shënojnë emrat konkretë, ndërsa në shtyllën tjetër emrat abstraktë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Njësia mësimore: NË GOJËN E BALENËS | |
|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>**Lënda:** Gjuha amtare **Klasa:** IV | |
| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës:<br>- |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.1, I.2, I.3; I.6<br>II.2; II.3<br>III.1., III.3., III.4.III.8.<br>V.8.<br>VI.2., VI.3.,VI.4. | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**<br>1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: NË GOJËN E BALENËS** | |
| | |
| **Fjalët kyçe:** balena, ujë, thellësi, udhëtim | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br>- Identifikon elementet fantastike të poezisë.<br>-Veçon elementet e poezisë.<br>- Bën analizë morfologjike të emrave të poezisë. | **Kriteret e suksesit:**<br>-Analizo strofat e poezisë.<br>-Shkruaj elementet fantasike të poezisë. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja dhe fleta të bardha A4 | |

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Njeriu dhe natyra

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Luajmë lojën e modifikuar, Balena dhe peshqit**

Nxënësit ftohen në qendër të klasës dhe njoftohen me rregullat e lojës.

Nxënësit ndërkohë lëvizin dhe luajnë në klasë deri në momentin kur mësimdhënësi e tregon një detyrë matematikore, si: 32 : 8 dhe nxënësit varësisht nga rezultati grumbullohen në përqafim grupor, p.sh. në këtë rast grupi guxon të ketë vetëm 4 anëtarë. Në rast se një grup ka grumbulluar 3 apo 5 anëtarë atëherë ai grup duhet të dal nga loja dhe kështu vazhdon deri sa të mbesin vetëm dy nxënës në lojë.

*Kjo lojë i nxit nxënësit; përforcon njohuritë në matematikë; ndikon në socializim dhe zhvillim të shkathtësive.*

**Ndërtimi i njohurive:**

**Shqyrtimi kategorizues**

Nxënësit njoftohen me njësinë e re mësimore dhe kërkohet nga ta që të përmendin disa veçori të poezisë, si:

- Poezia shkruhet në vargje
-
- Mund të ketë rimë
-
- Mund të jetë e strukturuar në strofë, etj.
-

Këto veçori i shkruan mësimdhënësi në tabelë




Lexohet poezia nga mësimdhënësi, analizohet bashkërisht me nxënësit përmbajta duke u bazuar në pyetjet e dhëna në librin bazë.

Veçohen elementet reale dhe fantastike të poezisë.

**Përforcimi:**

Ftohen nxënësit që në fletoret e tyre të krijojnë një tabelë dhe nga poezia të marrin 5 emra dhe atyre emrave të ju bëjnë analizë morfologjike, si:

| Emrat | Gjinia | Numri | Rasa | Trajta |
|---|---|---|---|---|
| Shtëpi | M | Nj | Emërore | E pashquar |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Ndaj në tri pjesë poezinë dhe paraqit me ilustrim secilën pjesë të poezisë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Njësia mësimore: GËNJESHTRA E KA HUNDËN E GJATË | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare | Klasa: IV |
| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës: |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.1, I.2, I.3; I.6<br>II.2; II.3<br>III.1., III.3., III.4.III.8.<br>V.8.<br>VI.2., VI.3.,VI.4. | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: GËNJESHTRA E KA HUNDËN E GJATË** | |
| Fjalët kyçe: gënjeshtër, zanë, buratin, fëmijë | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Përshkruan ngjarjen e tregimit.<br>- Nxjerr mesazhin e tregimit.<br>- Numëron elementet fantastike në tregim. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Përshkruajngjarjen e tregimit.<br>-shkruajmesazhin e tregimit. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: | |

Libri bazë, fletët me ngjyra, karrigia e autorit.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Artet, Gjuhët dhe komunikimi.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Parashikim me terma paraprak**
Nxënësve ju shkruhet në tabelë fjalia: Fëmijë nga druri, kërkohet nga anëtarët e grupit të japin ide se në çfarë po ju shkon mendja kur dëgjojnë këtë fjalë.

Pastaj shkruhet dhe fjala: gënjeshtër. Kërkohet që të krijohet një lidhje logjike mes dy termave.

*(Fëmijëve në asnjë çast nuk ju përmendet se a e kanë dhënë përgjigjen e saktë apo të gabuar)*

dhe kërkon nga ta që të mendojnë se me çfarë ju asociojnë këto fjalë.

Shkruhet në tabelë dhe fjalia: Hundë e gjatë.

**Ndërtimi i njohurive:**

**DRTA dhe fletëpalosje**

Tani, pasi nxënësit të kenë krijuar një tablo të qartë se për çfarë po bëhet fjalë, kërkohet nga ta që të hapin librat dhe në mënyrë të pavarur të lexojnë dy herë tregimin.

Për secilin nxënës parapërgatitet një fletë palosje me tri fletë, që thyhen në mes dhe bëhen bashkë për të krijuar një libër të vogël.

Nxënësit ndërkohë që lexojnë tregimin duhet të evidentojnë 6 fjali kyçe dhe t'i shkruajnë në pjesën e sipërme të fletës. Poshtë fletës duhet ta ilustrojnë fjalinë dhe në këtë mënyrë të sigurohen që kanë përshkruar komplet tregimin “**Gënjeshtra e ka hundën e gjatë**”.

**Përforcimi:**

**Bashkëpunim në çift**

Nxënësit ndahen në çifte dhe anëtarët e çifteve i shkëmbejnë librat e tyre. Secili nxënës vlerëson librin e shokut me një informatë kthyese në fund të librit.

Nxënësit këshillohen që të fillojnë me komente afirmative, lidhur me pjesët e pëlqyera dhe pastaj të dalin te pjesët ku mund të punohet më mirë.

| |
|---|
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Plotësohet aparatura e librit, me pyetjet nga 1 deri në 11. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Njësia mësimore: LAKIMI I EMRAVE NË NUMRIN NJËJËS | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare | Klasa: IV |
| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës: |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.1, I.2, I.3; I.6<br><br>II.2; II.3<br><br>III.1., III.3., III.4.III.8.<br><br>V.8.<br><br>VI.2., VI.3.,VI.4. | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10<br><br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br><br>3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: LAKIMI I EMRAVE NË NUMRIN NJËJËS** | |
| Fjalët kyçe: emra, lakim, rasa | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Numëron rasat e gjuhës shqipe.<br>- Lakon emra të ndryshëm.<br>- Dallon rasën e emrave.<br>- Veçon emrat që futen në lakimin e parë, dytë, tretë. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Lako emra në numrin njëjës.<br>-Shkruaj fjali me emra në rasa të caktuara. |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë amtare,

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Kllaster**

Bashkarisht me nxënësit kujtohen njohuritë për emrin dhe kujtohet se çfarë është lakimi i emrave, cilat janë rasat e gjuhës shqipe dhe pyetjet për secilën rasë. Të gjitha këto informata shënohen në tabelë.

Poashtu në tabelë veçohen me ngjyra mbaresat e emrave që futen në lakimin e parë, të dytë dhe të tretë.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Punë në grup**

Secilit grup i ndahet nga një hamer. Në hamer ndahen hapësirat, si:




Nxënësit e ndarë në grupe ndajnë përgjegjësitë.

Secili nxënës duhet të krijojë fjali për emrin në njërën rasë të caktuar, p.sh. njëri nxënës krijon fjali me emrin në rasën dhanore kurse tjetri krijon fjali me emrin në rasën rrjedhore, e kështu me radhë. *Nxënësit ndërrojnë rasat pas secilës fjali të shkruar.* Të gjitha fjalitë vendosen në vendin përkatës.

**Fjalitë me emrin në rasën emërore vendosen te hapësira në EMËRORE në hamer.*

**Përforcimi:**

**Shqyrtim kategorizues**

Mësimdhënësi shkruan në tabelë pesë fjali.

Nxënësit përshkruajnë fjalitë në fletore. Poshtë fjalive krijohet një tabelë ku për secilin emër nxënësit tregojnë:

Gjininë, numrin, rasën, lakimin e emrave.

| Emrat | Gjinia e emrit | Numri i emrit | Rasa | Lakimi |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Bëhet detyra e dhënë në librin bazë.

**Detyrë shtëpie:** Puno një tabelë me lakimin e një emri në trajtën e shquar dhe të pashquar, njëjës dhe vendoseni në muret e klasës. (Punimet në ***hamer ose flipçart*** i bëni sipas radhës që jua cakton mësuesja/i).

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Njësia mësimore: CIRKU | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare | Klasa: IV |
| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës: |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.1, I.2, I.3; I.6<br><br>II.2; II.3<br><br>III.1., III.3., III.4.III.8.<br><br>V.8.<br><br>VI.2., VI.3.,VI.4. | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>1.1; 1.2; 1.3; 1,7; 1.8; 1.9;1.10<br><br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br><br>3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: CIRKU** | |
| Fjalët kyçe: cirk, akrobaci, dëshirë | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Veçon elementet e cirkut.<br>- Shpjegon kuptimin e fjalës akrobaci dhe fjalëve tjera të panjohura.<br>- Krahason cirkun me kinemanë. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Analizo ngjarjen e tekstit.<br><br>-Shkruajmesazhin e tregimit. |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Burime në internet, libri bazë, fletorja, fletë A4

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Lëshohet në ***Youtube*** një video sqaruese për cirkun.

Mësimdhënësi sqaron elementet e cirkut dhe rolin e protagonistëve.
Bashkëbisedohet me nxënësit se a ka qenë dikush në cirk apo a ka pare ndonjë shfaqje të tillë në televizor apo internet.

**Ndërtimi i njohurive:**

Për të kuptuar më qartë pjesën cirku, bëhet dora e pyetjeve.

Mësimdhënësi vizaton në tabelë një dorë dhe njëjtë veprojnë nxënësit në fletoret e tyre.




Nxënësit nëpër secilin gisht përgjigjen në pyetjen përkatëse.

**Përforcimi:**

Secili nxënës veç e veç lexon pjesën Cirku dhe veçon se cilën nga fjalitë dëshiron ta komentoj në ditarin dypjesësh në fletore.

Në njërën anë të ditarit shkruhet se cila pjesë i ka bërë më shumë përshtypje nxënësit dhe në tjetrën shkruhet komenti se pse pikërisht kjo pjesë i pëlqeu.

| Pjesa e pëlqyer | Komenti |
|---|---|
| | |

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra e shtatë e librit bazë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Njësia mësimore: VJESHTA | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.1. I.3. I.6.<br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1. III.3. III.4. III.8.<br>V.8. VI.2. VI.3 VI.3. VI.4. | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: VJESHTA** | |
| Fjalët kyçe: vjeshta, ndryshime, dallëndyshe | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br>- Rendit me kuptim pjesëzat e poezisë.<br>- Numëron ndryshimet që ndodhin në pranverë.<br>- Krahasonvjeshtën me stinëttjera. | **Kriteret e suksesit:**<br>-Përshkruaj stinën e vjeshtës.<br>-Krahaso stinën e vjeshtës me stinët tjera. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja, fletët A4 | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë amtare, Njeriu dhe natyra | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Copëzat e përziera**

Nxënësve ju ofrohet poezia e ndarë në vargje në fleta të vogla.

Secili nxënës mundohet që të kombinoj këto vargje në atë mënyrë që të krijojë një vjershë me kuptim. Lexojnë pesë nxënës poezinë e krijuar. Verzioni i poezisë Vjeshta lexohet nga mësuesi dhe të gjithë nxënësit vetvlerësojnë punën e tyre me figura. Pyeten nxënësit se kush i renditi copëzat pa gabim.

**Ndërtimi i njohurive:**

Kujtohen elementet e poezisë dhe nxënësit udhëzohen që ta lexojnë me zë të lartë poezinë.

Secili nxënës në fletoret e tyre ilustron pamjen e vjeshtës në vendlindjen e tij dhe poshtë saj shkruan tri karaktesitika të vjeshtës që i jep autorja në poezi, si:
Në vjeshtë ***fryen erë e lehtë***

Në vjeshtë ***zogjtë shtegtarë marrin rrugë të gjata***

**Përforcimi:**

Secilit grup i ofrohet një fletë e bardhë dhe udhëzohen të krijojnë një pesëvargësh për vjeshtën. Në hapësirën përreth pesëvargëshit nxënësit ilustrojnë vjeshtën.

Punimet vendosen në murin e klasës në hapësirën e emëruar Vjeshta.
**Shembull:**




| |
|---|
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Përshkruhet vjeshta mbi temën "**Vjeshta në vendlindjen time**" |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Njësia mësimore: LIBRI IM |
|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare<br><br>Klasa: IV |

| Tema: | Rezultati i të nxënit të temës:<br><br>- |
|---|---|

| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>I.1. I.3. I.6.<br>II.2. II.3. II.5.<br>III.1. III.3. III.4. III.8.<br>V.8. VI.2. VI.3 VI.3. VI.4. |
|---|
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>1.1; 1.2; 1.3; 1.7; 1.8; 1.9; 1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7<br>3.1; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: LIBRI IM** | |
| Fjalët kyçe: libër, njohuri, arsyetim | |
| ***Rezultati/et e tënxënittëorësmësimore:***<br>- Përshkruan me pak fjalë librin e lexuar;<br>- Shpjegon mesazhin e librit të lexuar.<br>- Identifikon tri arsye përse duhet ose nuk duhet lexuar ai libër.<br>- Vlerëson anën më të fortë të librit të lexuar. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>**-**Analizo ngjarjet e librit të lexuar.<br><br>-Shkruaj mesazhin e librit të lexuar. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, tri fleta me ngjyrë për secilin nxënës, materialet ricikluese të zgjedhura nga fëmijët | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Pyetja nxjerr pyetjen**

Mësimdhënësi pyet nxënësit për titullin e librit të lexuar. Nxënësit ftohen që të bëjnë pyetje për njëri-tjetrin lidhur me librat e lexuar.

Mësimdhënësi orienton diskutimin dhe mbi pyetjet e dhëna në librin bazë.

**Ndërtimi i njohurive:**

Secilit nxënës plotëson në mënyrë të pavarur faqen e librit bazë, duke u përgjigjur në pyetjet e dhëna.

Nxënësit pasi të përfundojnë plotësimin e librit, në fletoret e tyre vlerësojnë librin mbi këto pyetje:




**Përforcimi:**

**Punë e pavarur**

Nxënësit me materiale të ricikluara, ashtu si rekomandon libri bazë, mundohen të rikrijojnë personazhin e pëlqyer të librit.

Materialet zgjidhen sipas dëshirës dhe mundësive të nxënësit, dhe mund të jenë: plastelinë, çorape, etj.

| |
|---|
| |
| Vlerësim me figura<br>Vetëvlerësim |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Nxënësit përgatisin certifikatën për pjesën e pëlqyer në libër. |

| | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: NJERIU I BJESHKËS** | |
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1, I.2, I.3, I.6, I.8**<br>**II.5.**.<br>**III.1.**, **III.3., III.4.III.8.**<br>**V.5., V.8.**<br>**VI.2.**, **VI.3.,VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>1.1; 1.2; 1.3; 1,4; 1.7; 1.10<br>2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6<br>3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7 | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: NJERIU I BJESHKËS** | |
| Fjalët kyçe: bjeshkë, kafshë, male, të egra | |

| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Ritregon ngjarjen me fjalë të zgjedhura .<br><br>- Identifikon cilësitë e personazhit.<br><br>- Krahason kafshët e egra me kafshët shtëpiake. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Përshkruaj personazhin kryesorë.<br><br>-Vlerëso rëndësinë e veprimeve të personazhit. |
|---|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, material i përgatitur | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |
| **Parashikimi:**<br><br>**Diagram i Venit**<br><br>Mësimdhënësi krijon një Diagram të Venit në tabelë, ku kërkohet krahasimi i kafshëve të egra kafshët shtëpiake.<br><br>Kërkon nga nxënësit që të kujtojnë njohuritë për temëndhe diagrami plotësohet bashkarisht me nxënësit.<br><br>Në diagram numërohen veçoritë e secilit lloj dhe të përbashkëtat në hapësirën në mes. Në diagram mund të numërohen dhe kafshët që hyjnë te njëri lloj dhe te tjetri. | |




**Ndërtimi i njohurive:**

Disa nxënës lexojnë me zë të lartë tregimin njëri pas tjetrit.

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë dhe në mënyrë të pavarur tregimin.

Për të kuptuar më mirë tregimin, analizohen bashkarisht me mësimdhënësin pyetjet 1 – 10 të aparatit pedagogjik, përveç detyrës së 6 e cila duhet të bëhet në shtëpi, pasi të hulumtohet për kafshët e egra.

**Përforcimi:**
Përmbledhje e ngjarjes së tregimit

Nxënësve ju jepet e përgatitur një fletë punuese ku ata duhet të përshkruajnë rrjedhen e ngjarjes me fjali të shkurtra dhe përmbledhëse.




Nxënësit vlerësohen për qartësinë e fjalive dhe përzgjedhjen e tyre me informatë kthyese.

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësi zgjedh mes dy detyrave:

- Hulumton për kafshët e egra dhe ilustron ato në hapësirën e dhënë në detyrën e gjashtë të librit bazë.
- Krijon dy gjëegjëza. Një për një kafshë shtëpiake dhe tjetrën për një kafshë të egër.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Njësia mësimore: NJË KUSHT PË DITËLINDJE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1, I.2, I.3, I.6, I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1**., **III.3., III.4.III.8.**<br>**V.5., V.8.**<br>**VI.2**., **VI.3.,VI.3.** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: NJË KUSHT PË DITËLINDJE** | |
| Fjalët kyçe: ditëlindje, matematikë, zgjidhje, problema | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Veçonë elementet kyçe të tregimit.<br>-Vlerësonë në veprimet e personazheve. | **Kriteret e suksesit:**<br>-Analizo ngjarjen në tekst.<br>-Trego tri argumente në përkrahje të babait rë Renesë. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja, fleta të vogla | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Imagjinatë e drejtuar**

Kërkohet nga nxënësit që të mbyllin sytë.

Mësimdhënësi krijon një situatë të ngjajshme me të librit bazë dhe ua lexon nxënësve me tonin adekuat.

**Një situatë mund të jetë kështu:**

*"Edhe pak ditë ke ditëlindjen. Prindërit e tu detyrohen të udhëtojnë jashtë vendit dhe kthehen në ditën kur ti feston ditëlindjen. Pra, ata nuk kanë mundësi që të organizojnë ditëlindjen tënde, por, ata ta besojnë ty këtë gjë. Ti e di që nuk ke rrugë tjetër, pasi tashmë i ke ftuar miqtë dhe nuk ke arsye për të anuluar festën e ditëlindjes, dhe i përvjelë mangët e bluzës për t'u bërë gati.*

*Cilat veprime i ndërmerr ti fillimisht...?"*
Ftohen nxënësit që të hapin sytë dhe kërkohet që të shkruajnë në letra të vogla veprimet që ata do të kishin bërë në një situatë të tillë.

Secili nxënës lexon shpejt veprimet e shkruara.

**Ndërtimi i njohurive:**

Mësimdhënësi vizaton në tabelë lulen me të cilën do të analizohet tregimi.

Të njëjten lule nxënësit e vizatojnë në fletoret e tyre dhe e plotësojnë ndërkohë që lexojnë

në mënyrë të pavarur tregimin.




Nxënësit vlerësohen me figura për përgjigjet e zgjedhura.

**Përforcimi:**

Nxënësit në dyshe diskutojnë dhe plotësojnë pyetjet e librit bazë, nga numri një te numri 11. Pastaj, në mënyrë të pavarur vazhdojnë tregimin "Një kusht për ditëlindje" duke përshkruar se si do të zhvillohet festa e ditëlindjes së Renës, ashtu si rekomandon detyra e 12-të e librit bazë.

Disa nxënës vullnetarë lexojnë shkrimin.

Nxënësit vlerësohen me informatë kthyese për rrjedhën e ngjarjes dhe strukturën e shkrimit.

| |
|---|
| |
| Vlerësim me figura<br><br>Informatë kthyese |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Ilustro tregimin e shkruar nga ti, të bërë në detyrën e 12-të. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

**Njësia mësimore: LAKIMI I EMRAVE NË SHUMËS**

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1., I.2., I.3., I.8.**
**II.5.**
**III.1, III.3., III.4.III.8.,**
**V.5., V.8.**
**VI.2., VI.3., VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

1.1; 1.2; 1.3; 1,4; 1.7; 1.10
2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6
3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| **Njësia mësimore: LAKIMI I EMRAVE NË SHUMËS** | |
| Fjalët kyçe: lakim, rasa, emra, numër, shumës | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br><br>- Numëron rasat e gjuhës shqipe foljet behen:<br>- Dallon tri lakimet e emrit<br>- Përcakton se cilit lakim i përket emri.<br>- Lakon emrat sipas udhëzimeve. | **Kriteret e suksesit:**<br><br>-Lako emra në numrin shumës.<br>-Klasifiko emra sipas lakimit. |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, fletë e përgatitur | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |
| **Parashikimi:**<br><br>Stuhi mendimesh<br><br>Nxënësit kanë njohuri paraprake për emrin, prandaj ftohen që të kujtojnë informacionet për emrin dhe me theks të veçantë për lakimin e emrit.<br><br>Informatat e grumbulluara paraqiten në tabelë me anë të një diagrami, që mund të duket kështu. | |




**Ndërtimi i njohurive:**
Hapet libri bazë dhe fillojnë sqarimet nga ana e mësimdhënësit.
Ndërtohet një tabelë në tabelën e klasës ku veçohen me shkumësa me ngjyrë emrat e lakimit të parë, të dytë dhe të tretë.
Për secilin lakim, lakohen nga dy emra:
*2 të lakimit të parë, dy të lakimit të dytë dhe 2 të lakimit të tretë.*
Bashkarisht plotësohen detyrat e librit bazë.

**Përforcimi:**
Nxënësi në mënyrë të pavarur analizon informatat e dhëna në libër dhe organizon ato në fletën punuese të përgatitur nga mësimdhënësi.
Zgjedh një emër për secilin lakim dhe lakon ata në rasa, poshtë informacionit.

Nxënësit vlerësohet për lakimin e emrave dhe për zgjedhjen e informacionit.

Informatë kthyese

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

| Njësia mësimore: EMA | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1, I.2, I.3, I.6, I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1**., **III.3., III.4.III.8.**<br>**V.5., V.8.**<br>**VI.2**., **VI.3.,VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>**1.1; 1.2; 1.3; 1,4; 1.7; 1.10**<br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br>**3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| **Njësia mësimore: EMA** | |
| Fjalët kyçe: Ema, motër, e veçantë | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:**<br>- Krijon shkrim me fjalët kyçe foljet te behen:<br>- Numëron veçantitë e personazhit kryesor.<br>- Shkruan një recetë kuzhine; | **Kriteret e suksesit:**<br>-Krijo një ngjarje të shkurtë me fjalët kyçe.<br>-Shkruaj një recetë kuzhine. |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, fleta e përgatitur, hamer, fleta me ngjyra |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br>Nxënësit ftohen të shkruajnë në mënyrë të pavarur një shkrim me fjalët kyçe:<br><br>*Vajzë e vogël, kuzhinë, dëshira, gatim, nikoqire, punëtore*<br><br>**Kriteret e shkrimit:**<br><br>*-Shkrimi duhet të përmbajë jo më pak se 5 fjali*<br><br>*-Të përdoren të gjitha fjalët kyçe*<br><br>*-Të jetë tregim real*<br><br>Lexohen tre apo katër shkrime të nxënësve vullnetarë.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>**Analizë e personazhit kryesor**<br><br>Mësimdhënësi i orienton nxënësit që të:<br><br>Lexojnë në mënyrë të pavarur tregimin dhe pas leximit të analizojnë në detaje personazhin Ema.<br><br>Veçoritë e personazhit mund të shkruhen në një grafik rrethor apo në një fletë punuese që mund të duket kështu: |




*Fleta mund të paloset te vijat e ndërprera.*

Nxënësit shkëmbejnë fletët punuese dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit me dy yje dhe një dëshirë.

Kujtojmë: dy yje jepen për aspektin më të fortë të punës dhe një dëshirë jepet në formë këshille, sugjerimi, etj., për punën e shokut.

**Përforcimi:**

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, copëzat e përziera, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Copëzat e përziera**

Mësimdhënësi ua shpërndan nxënësve nga një zarf me copëza të shkruara te strofave të poezisë Pushimet dimërore.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që copëzat e strofave t'i rendisin e pastaj t'i ngjesin në fletore sipas mënyrës së tyre që të krijohet një poezi.

Disa nga punimet lexohen në klasë.

Kërkohet nga nxënësit që të hapin librin te poezia " Pushimet dimërore".

Krahasohet renditja e poezisë në fletore dhe në libër.

Nxënësit vetvlerësojnë punën e tyre.

**Ndërtimi i njohurive:**
**Lexim i pavarur**

Secili nxënës lexon së paku dy strofa me zë të lartë.

Mësimdhënësi vlerëson me notë secilin nxënës për:
- *Rrjedhshmërinë,*

- *Respektimin e shenjave të pikësimit*

- *Intonacionin*

Nxënësit ilustrojnë secilën strofë në hapësirën e librit bazë.Për 3 minuta ata shkëmbejnëlibrat me njëri-tjetrin dhe vlerësohen në mënyrë të ndërsjellë për:

*Kreativitetin dhe saktësinë në ilustrime.*

Pasi të lexojnë dhe vlerësohen të gjithë nxënësit, bashkarisht analizohet poezia duke e punuar detyrën 1, 2, 3, 4.

**Përforcimi:**
**Shkrim i lirë**

Nxënësit në fletoret e tyre shkruajnë së paku dy strofa për pushimet dimërore, për Vitin e ri apo për dimrin.

**Temën mund ta zgjedhin sipas dëshirës.**

Kriteret e shkrimit:

- Të jetë e titulluar
- Të ketë rimë
- Të ketë së paku dy strofa
- T'i përmbahet temës së caktuar

Disa nxënës të zgjedhur lexojnë poezinë me zë të lartë.

Informatë kthyese
Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Rilexojnë strofën e fundit të poezisë. Vargjet e saj i përmbledhin me një fjali.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Ka gjithmonë një rrugëdalje

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezulltati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Ka gjithmonë një rrugëdalje**

Fjalët kyçe: ujqit, fuçi, rrugëdalje, zgjidhje

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Ndan përvoja sipas nevojës së diskutimit | - Trego se a je gjetur ndonjëherë në vështirësi |
| - Parashikon se çfarë do të ndodh me ngjarjen e tregimit | - Shkruaj se çfarë mendon se do të ndodh në tregim |
| | - Analizo përmbajtjen e tregimit |

| | |
|---|---|
| - Jep këndvështrime për diskutimet e hapura<br><br>- Analizon përmbajtjen e tregimit | |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**
**Diskutim**

Mësimdhënësi shkruan në qendër të tabelës: Ka gjithmonë një rrugëdalje dhe kërkon nga nxënësit që të reflektojnë për këtë fjali.

***Çfarë u shkon në mendje?***

***A e besoni që kjo fjali qëndron?***

***A ju ka ndodhur ndonjëherë që të jeni në vështirësi?***

***A keni gjetur ndonjëherë zgjidhje në moment të fundit?***

***Përshkruaj atë ndjenjë.***

Janë disa prej pyetjeve që mësimdhënësi mund të parashtroj që të marrë nga nxëënsit mendimet për çështjen.

Prezentohet njësia e re mësimore.

**Ndërtimi i njohurive:**
**Tabela e parashikimit**

Mësuesi/ja kërkon nga nënësit që në fletoret e tyre të vizatojnë një tabelë me tri shtylla ku do të shkruajnë tri pyetjet: *Ç'mendoni se do të ndodhë?, Ç'prova keni?, Ç'ndodhi?.*

Mësuesi/ja fillon lexon tregimin në pjesë të ndara. Pasi lexon pjesën e parë nxënësit plotësojnë dy pyetjet e para në tabelë. Disa nga përgjigjet diskutohen në klasë. Pasi lexon pjesën e dytë, nxënësit plotësojnë pyetjen e tretë  dhe krahasojnë përgjigjet e para dhe prapë plotësojnë pyetjet e para për pjesën e dytë të tregimit, kështu vazhdon deri në fund të tregimit.

| *Ç'mendoni se do të ndodhë?* | *Ç'prova keni? Ç'ndodhi?* | |
|---|---|---|
| | | |

Analiza e tregimit bëhet duke gjetur përgjigje për pyetjet 1 – 6 të librit bazë.

**Përforcimi:**

**Planvendosja**

Para nxënësve parashtrohen dy çështje për diskutim:

Cila ishte rrugëdalja që e gjeti burri dhe a kishte mënyrë tjetër?

Çfarë mund të ndodhë pas shkuarjes së Malinës në fshat?

Të dyja këto çështje diskutohen nga nxënësit.

Informatë kthyese

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Analizo dhe shkruaj porosinë e tregimit: Ka gjithmonë një rrugëdalje.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Breshka dhe shkaba

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Breshka dhe shkaba**

Fjalët kyçe: breshkë, kafshë, shkabë

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Numëron disa lloje të kafshëve | - Numëro disa lloje të kafshëve |
| - Rendit copëzat e poezisë në atë mënyrë që të krijojë poezi me kuptim | - Rendit copëzat e poezisë |
| - Krijon një maskë përkitazi me detyrën e | - Krijo një maskë ose për breshkën ose për shkabën |
| | - Interpreto si duhet poezinë |

| | |
|---|---|
| dhënë<br><br>- Interpeton poezinë | |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fleta me ngjyra, fletë e përgatitur, gërshërë, fletë A3 | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Artet | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**
**Konkurs**
Mësimdhënësi i ndan në grupe nxënësit.
Secilit grup i jepet një fletëA3 dhe në të e parapërgatitur një tabelë.
Kërkohet nga nxënësit që:
*Të shkruajnë sa më shumë emra kafshësh që jetojnë në tokë, ujëdhe ajër.*
*Të shkruajnë së paku dy informata për secilin grup të kafshëve.*
*Të ilustrojnë sa më shumë kafshë që munden.*
Mbledhen pikët e punës dhe shpallet grupi fitues.
Tabela mund të duket kështu:

| Kafshët që jetojnë në ujë | Kafshët që jetojnë në tokë | Kafshët që jetojnë në ajër |
|---|---|---|
| | | |

**Ndërtimi i njohurive:**

**Copëzat e përziera**

Mësuesi/ja ua shpërndan nxënësve nga një zarf me copëza të shkruara te strofave të poezisë.
Kërkon nga nxënësit që copëzat e strofave t'i ngjesin në fletore duke u kujdesur që të rendisin sa më

mirë poezinë.

Disa nga punimet lexohen në klasë.

Hapet libri dhe secili nxënës i grupit që fituan në konkurs e lexon me zë të lartë poezinë.

Nxënësit përgjigjen në të gjitha pyetjet e parashtruara në aparatin pedagogjik dhe mësimdhënësi i pyet cik-cak nxënësit për përgjigjet.

Kështu është bërë analiza e përmbajtes së poezisë.

**Përforcimi:**
**Punë në çift**

Nxënësit ndahen në çifte.

Nxënësit marrin fletët me ngjyra dhe gërshërët.

Ata udhëzohen të krijojnë një maskë për personazhin që dakordohen me shokun e çiftit.

Nëse njëri bëhet breshka, tjetri bëhet shkaba.

Nxënësit interpretojnë poezinë në dyshe, varësisht nga roli që kanë.

Nxënësit vlerësohen për:

Kreativitetin në bërjen e maskës,

Interpretimin e poezisë

Bashkëpunimin me anëtarët e grupit

Informatë kthyese

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Krijo një fabul të shkurtër me kafshët tua të preferuara.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## Kundrinorët

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Kundrinorët**

Fjalët kyçe: kundrinorë, gjymtyrë, fjali

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Gjen kundrinorët në fjali<br>- Plotëson detyrat sipas udhëzimeve<br>- Shpjegon funksionin e kundrinorëve në fjali | - Trego se çfarë funksioni ka kundrinori në fjali<br>- Numëro pyetjet që na shërbejnë për të gjetur kundrinorin |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja, kubi

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Stuhi mendimesh**

Mësimdhënësi parashtron pyetje për njohuritë e deritanishme të nxënësve në gramatikë si për pjesët kryesore të fjalisë etj.
Mendimet e nxënësve paraqiten në tabelë dhe organizohen në formë të diagramit. .

**Ndërtimi i njohurive:**
**Leksion i avancuar**
Mësimdhënësi shpalos informatat e reja për kundrinorin.
Bashkarisht me nxënësit analizojnë detyrën e parë, dytë dhe të tretë duke e plotësuar në bazë të kërkesës, ndërsa detyrën e katër dhe pesë nxënësit e analizojnë dhe plotësojnë në mënyrë individuale.

**Përforcimi:**
**Kubimi**
Për çdo grup përgatitet nga një kub.

*Kubi përgatitet duke palosur fletët dhe duke ngjitur me ngjitës pjesët me ngjyrë hiri të mbyllur.*

Në çdo faqe të kubit është shkruar nga një fjali.
Secili nxënës do ta rrotulloj kubin dhe fjalia që do t'i bie do ta analizoj duke gjetur kryefjalën, foljen, kundrinorin me pyetjet bazë: Kush?, Ç'bëri?, Kë?, Çfarë? Cilin? etj.
Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.




Informatë kthyese

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Formo tri fjali ku të ketë **kundrinor të drejtë.** Lexo një shembull para klasës. Secili nxënës lexon nga një shembull. Diskuto me klasën dhe mësuesen nëse janë të saktë shembujt.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Dreri në pasqyrë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Dreri në pasqyrë**

Fjalët kyçe: dre, këmbë, brinjë

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Zgjedh një pjesë të pëlqyer të tregimit<br>- Krijon një ngjarje të shpejtë mbi fotografitë e shfaqura<br>- Komenton zgjedhjen e vet<br>- Analizon ngjarjen e tregimit | - Krijo një tekst të shpejtë mbi këto dy fotografi<br>- Veço një pjesë të pëlqyer dhe komento atë<br>- Analizo ngjarjen e tregimit |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, projektori, fletorja, fleta punuese |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |

**Parashikimi:**
**Parashikimi përmes fotografive**

Mësuesi/ja paraqet dy fotografi para nxënësve dhe kërkon nga nxënësit që për pak minuta të mendojnë dhe të përshkruajnë me fjalë një tregim të shkurtër përmes fotografive.




**Ndërtimi i njohurive:**
**Citati/Komenti**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të lexojnë tregimin me vëmendje dhe pasi ta lexojnë në fletoret e tyre të shkruajnë në njërën anë të fletës Citati dhe në anën tjetër Komenti. Te pjesa e citatit të shkruajnë një pjesë të përzgjedhur nga tregimi dhe te pjesa e komentit të shkruajnë komentin e pjesës së përzgjedhur. Disa nga shkrimet lexohen në klasë dhe në këtë mënyrë bëhet një lloj komentimi i tregimit.

| *Citati* | *Komenti* |
|---|---|
| | |

Sa herë të përmendet një pjesë nga tregimi, në aparatin pedagogjik gjendet pyetja që lidhet me të dhe plotësohet.

Kështu është bërë dhe komentimi i tregimit dhe analiza e elementeve të tij.

**Përforcimi:**
**Organizuesi grafik**

Mësuesi/ja shpërndan nga një fletë A4 nxënësve.

Nxënësit do ta plotësojnë duke e përshkruar në pika të shkurta tregimin, personazhet, vendin, porosinë.




| |
|---|
| |
| Informatë kthyese<br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Plotësohet detyra 8 dhe 10 e aparatit pedagogjik. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |

## Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë**

Fjalët kyçe: kundrinor, gjymtyrë, parafjalë

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Kujton njohuritë gramatikore | - Kujto çfarë di për gjymtyrët e fjalisë |
| - Plotëson sipas udhëzimeve | - Plotëso librin sipas udhëzimeve të mësimdhënësit |
| - Organizon informatat në fletën e përbashkët | |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja, fletët A4 |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br><br>**Bashkëbisedim**<br><br>Bashkëbisedohet me nxënësit për gjymtyrët e fjalisë.<br><br>Cilat janë pjesët kryesore të fjalisë?<br><br>Po pjesët dytësore?<br><br>Kush është funksioni i njërës e kush i tjetrës gjymtyrë?<br><br>Çfarë shprehin gjymtyrët dytësore?<br><br>Çfarë i ndihmojnë fjalisë?, etj.<br><br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>**Leksion i avancuar**<br><br>Prezantohet tema nga mësimdhënësi“ Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë”.<br><br>Mësimdhënësi kruan në tabelë  dy fjali:<br><br>*Babai dhe vajza e tij u hodhën ushqim pëllumbave.*<br><br>*Gjyshës po i ndihmonte nëna.*<br><br>Kërkon nga nxënësit që këto dy fjali t’i analizojnë dhe me anë të pyetjeve Kujt?, Çfarë?, Cilit?, Cilës?, Cilëve?, Cilave?, të gjejnë kundrinorin e zhdrejt pa parafjalë.<br>Pastaj bashkarisht në libër analizojnë fjalinë e parë kur kundrinori shpreht me emër apo përemër.<br><br>Kështu vazhdohet, me sqarime e plotësim të aparatit pedagogjik.<br><br>**Përforcimi:** |

**Rishikim me rigrupim**

Mësimdhënësi ndan nxënësit në katër grupe.
Në katër fleta A4 shkruan gjymtyrët e fjalisë: Kryefjala, kallëzuesi, kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë.
Letrat i vendos rreth klasës. U shpjegon nxënësve që brenda pak kohe do të shkruajnë nga dy fjali dhe të identifikojnë gjymtyrën që kërkohet. Pas një shenje që jep mësuesi/ja nxënëit lëvizin rreth klasës që të plotësojnë të gjitha deri sa të kthehen te fleta fillestare. Pasi të mbarojnë lexohen fjalitë me radhë dhe diskutohen cilat janë të sakta dhe të paskata.

| Kryefjala | Kallëzuesi | Kundrinori i drejtë | Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë |
|---|---|---|---|
| | | | |

Informatë kthyese

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Formo tri fjali ku të ketë **kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë.**Lexo një shembull para klasës. Secili nxënës lexon nga një shembull. Diskuto me klasën dhe mësuesen nëse janë të saktë shembujt.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## Ushtrime për kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Ushtrime për kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë**

Fjalët kyçe: kundrinorë, ushtrime, parafjalë

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Plotëson sipas kërkesave | - Plotëso ushtrimet |
| - Veçon gjymtyrët e fjalive | - Veço me ngjyra gjymtyrët e fjalive |
| - Analizon fjalitë e krijuara vet | - Krijo fjali e pastaj analizo ato |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Ditari dy pjesësh**

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që në fletoret e tyre të vizatojnë një tabelë me dy shtylla.
Në shtyllën e parë të shkruajnë fjali, ndërsa në shtyllën e dytë analizë, pyetje.
Secila fjali duhet të ketë gjymtyrë kryesore dhe gjymtyrë dytësore.

Në tabelë të shkruhen nga katër fjali

Disa nga shkrimet lexohen në klasë

| ***Fjali*** | ***Analizë/ Pyetjet*** |
|---|---|
| | |

**Ndërtimi i njohurive:**

Në librin bazë mësuesi/ja bashkarisht me nxënësit analizojnë tekstin e detyrës së parë dhe më pas plotësojnë detyrën e dytë që i referohet tekstit. Detyrën e tretë dhe të katër nxënësit e plotësojnë duke diskutuar në dyshe, më pas lexohen nga një nxënës dhe diskutohen detyrat bashkarisht me të tjerët

**Përforcimi:**
**Punë individuale**

Nxënësit në mënyrë individuale paraqesin detyrën e pestë në fletoret e tyre duke dalluar me ngjyrë pjesët që kërkohen në detyrë.
Pesë – gjashtë nxënës lexojnë fjalit para të tjerëve.

| |
|---|
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Veza e Kristorit Kolombit

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
|---|---|

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Veza e Kristorit Kolombit**

Fjalët kyçe: vezë, mendje, zgjuarsi, zbulues

| Rezultati/et e  të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
| --- | --- |
| - Përgjigjet me qartësi në pyetjet e parashtruara<br>- Përmbledh përmbajtjen që lexon<br>- Argumenton mendimet personale | - Përgjigju në pyetjet e parashtruara<br>- Përmbledh atë që lexon me pak fjali<br>- Argumento mendimin tënd |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Rrjeta e diskutimi**

Mësuesi/ja paraqet tri pyetje para nxënësve dhe me anë të atyre pyetjeve krijohet një diskutim në klasë.

*A na e tregon dikush dallimin mes shpikësit dhe zbuluesit?*
*Nëse një detar, gjen një vend të ri a e ka zbuluar apo shpikur atë?*

*A keni dëgjuar ndonjëherë për Kristofor Kolombo?*

*A mendoni se Kristofor Kolombo ka lënë gjurmë dhe përse?*

*Si e paramendoni fizikun e Kristofor Kolombon?*

Mësimdhënësi zgjeron njohuritë e nxënësve duke ju folur më shumë për zbulimin e Kristofor Kolombos dhe rëndësinë e tij në histori.

**Ndërtimi i njohurive:**
**Të lexuarit në dyshe**

Fillimisht ndahen nxënësit përmes numrave përkatës 1 dhe 2. Nxënësit me numrin 1 do të lexojnë pjesën e parë të tekstit ndërsa nxënësit me numrin 2 lexojnë pjesën e dytë të teksit. Pasi lexojnë tekstin nxënësit me numrin 1 bëjnë rolin e raportuesit, ku i raportojnë shokut me numrin 2 pjesën që ka lexuar në ndërkohë nxënësi me numrin 2 i bën pyetje në mënyrë qe të marrë sa më shumë informata për pjesën e parë dhe anasjelltas.
Çdo çiftë duhet të bëj përmbledhjen e ngjarjes së tregimit në fletore dhe të jenë të gatshëm për

paraqitjen e tyre.

**Përforcimi:**
**Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja paraqet temën e diskutimit:
*A ishin të drejta mendimet e të tjerëve për Kolombon?*

Po, pse?

Jo, pse?

Nxënësit përgjigjen dhe argumentojnë përgjigjet e tyre.
Diskutohen dhe të gjitha pyetjet e aparatit pedagogjik dhe kështu bëhet analizë e detajuar e përmbajtjes.

Informatë kthyese

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Hulumto në internet për Kristofor Kolombin dhe zbulimin e Amerikës.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë**

Fjalët kyçe: kundrinor, i zhdrejtë, gjymtyrë, fjali

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Kujton dijet në fushën e gramatikës<br><br>- Identifikon gjymtyrët e fjalive<br><br>- Krijon fjali sipas udhëzimit<br><br>- Analizon morfologjinë e fjalive të krijuara | Kriteret e suksesit:<br><br>- Kujto çfarë di për mësimet e fundit në gramatikë<br><br>- Identifiko në fjali gjymtyrët kryesore dhe dytësore<br><br>- Krijo dhe analizo fjalitë sipas udhëzimeve |
|---|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**
**Tryeza e rrumbullakët**

Mësuesi/ja i jep nxënësit në bankën e parë një fletë të bardhë A4. Kërkohet nga ta që në fletë të shkruajnë secili njohuritë e tyrë për njësitë e fundit në gramatikë.
Nxënësi i parë e shkruan mendimin tij dhe pastaj e bart letrën te shoku/shoqja që ka afër.
Secili prej tyre plotëson mendimet e njëri – tjetrit, kështu veprohet deri te nxënësi i fundit.
Fleta paraqitet në tabelë dhe secili nxënës lexon se çfarë ka shkruar.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Leksion i avancuar**

Mësuesi/ja prezanton njësinë mësimore: Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë.

Kërkon nga dy tre nxënës të shkruajnë nga një fjali në tabelë. Fjalitë e shkruara nga nxënësit analizohen duke nënvizuar fjalinë që paraqitet kundrinori i zhdrejtë me parafjalë.
Mësuesi/ja nënvizon kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë duke e gjetur me anë të pyetjeve: Nga kush?, me kë?, me çfarë?, me se?, prej kujt? të cilat i shënon në tabelë.
Më pas, në libër bashkarisht analizojnë detyrën dhe fjalitë se me çfarë shprehet kundrinori i zhdrejtë me parafjalëdhe në cilat rasa mund të jetë.

| |
|---|
| **Përforcimi:**<br><br>**Punë individuale**<br><br>Në bazë të shembujve të fjalive në libër, nxënësit shkruajnë pesë fjali duke nënvizuar kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë të shprehur me *emër, përemër, grup emëror.*<br><br>Nxënësit shkëmbejnë fletoret brenda grupit dhe vlerësojnë njëri-tjetrin për saktësinë në identifikim të gjymtyrëve dhe për drejtshkrim.<br><br>Vlerësimi bëhet me figura. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Krijo një tekst të shkurtër dhe me ngjyrë të kuqe identifiko kundrinën e zhdrejtë me parafjalë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

# Ushtrime për kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| | |
|---|---|
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Ushtrime për kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë**

Fjalët kyçe: ushtrojmë, kundrinorët, gjymtyrë, fjali

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Sqaron funksionin e kundrinorit në fjali<br><br>- Identifikon kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë në fjali | - Gjej se ku është kundrinori i zhdrejtë me parafjalë në fjali<br><br>- Trego se për çfarë shërben kundrinori i zhdrejtë me parafjalë në fjali |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**

**Gushëkuqi rrethor**

Mësuesi/ ja parashtron pyetjen për të cilin nxënësit do të shprehin mendimet.

*Si gjindet kundrinori i zhdrejtë me parafjalë dhe ku qëndron në fjali?*

Nxënësit me radhë njëri pas tjetrit japin mendimet e tyre.

Secili nxënës jep nga një fjali e cila përmban një kundrinor të zhdrejtë me parafjalë.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Punë e pavarur**

Në librin bazë nxënësit plotësojnë detyrën e parë dhe të dytë duke u bazuar te teksti dhe kërkesa e detyrës. Në detyrën e tretë dhe të katër lexohen fjalitë nga një nxënës ndërsa bashkarisht me të tjerët analizohen me radhë duke i plotësuar vendet e zbazëta.

**Përforcimi:**

**Punë në çifte**

Nxënësit punojnë në çfit detyrën e pestë duke dalluar me ngjyrë gjymtyrët e fjalsië dhe po ashtu pranë çdo fjalie shkruajnë pyetjen përkatëse për kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë.

| |
|---|
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| | |
|---|---|
| **SHPREHIA** | |
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Shprehia** | |
| Fjalët kyçe: shprehitë, ndihma, miqtë, veprime | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Identifikon shprehitë personale | Kriteret e suksesit:<br><br>- Shkruaj shprehitë personale |

| | |
|---|---|
| - Nxjerr mesazhin e tregimit<br>- Ritregon ngjarjen e tregimit | - Përgjigju në pyetjet për tregimin<br>- Nxjerr mesazhin e tregimit |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Shkrim i lirë**

Mësimdhënësi zbaton një shprehi personale (qoftëduartrokitja për të marrë vëmendjen e nxënësve, qoftë numërimi 3, 2, 1 apo hapja e dritares në momentin që hyn në klasë, etj.) dhe pyet nxënësit:

*Më tregoni, cilat veprime i bëj unë gjithmonë në momentin që hy në klasë?*

Pasi të përgjigjen nxënësit, mësimdhënësi sqaron se këto veprime që i kryejmë vetvetiu dhe që na bëhen zakon pas përsëritjeve të gjata quhen shprehi.

Pasi nxënësit të kuptojnë se çfarë janë shprehitë ata ftohen të shkruajnë shpejt pesë shprehi të mira që ata kanë dhe tri shprehi personale që do të donin t'i ndryshonin.

Shprehitë i shkruajnë në një tabelë T dhe tabela vendoset në dollapin personal të nxënësit në klasë.

| Pesë shprehi të mira | Pesë shprehi që do t'i ndërroja |
|---|---|
| | |

**Ndërtimi i njohurive:**

**Tabela e parashikimeve**

Ashtu si rekomandon libri, leximi i tregimit bëhet me ndalesa.

Pas çdo ndalese mësimdhënësi iu jep kohë nxënësve që të plotësojnë pjesën e tabelës për 3 minuta.

| Ndalesat: | Çfarë mendoni se do të ndodhë? | Çfarë provash keni? | Çfarë ndodhi? |
|---|---|---|---|
| Pjesa 1 | | | |
| Pjesa 2 | | | |
| Pjesa 3 | | | |
| Pjesa 4 | | | |
| Pjesa 5 | | | |

**Përforcimi:**

**Rishikim në çift**

Nxënësit e ndarë në çift analizojnë pyetjet dhe gjejnë përgjigjet për tregimin Shprehia.

Pyetjet nga 1 deri në 7 plotësohen brenda kësaj periudhe të orës mësimore.

Përgjigja e pyetjes së shtatë: Cili është mesazhi i këtij tregimi? Lexohet nga një përfaqësues i secilit çift.

Informatë kthyese

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Shkruaj listën e shprehive tua me bukurshkrim dhe krahaso ato me shprehitë e Ditës.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| LIGJËRATA E DREJTË DHE LIGJËRATA E ZHDREJTË | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br>**II.5.**<br>**III.1, III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**<br>**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**<br>**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **LIGJËRATA E DREJTË DHE LIGJËRATA E ZHDREJTË** | |
| Fjalët kyçe: ligjëratë, citat, thonjëza, e drejtë, e zhdrejtë, komentim | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Sqaron se çfarë është ligjërata e drejtë<br>- Shpjegon se çfarë është ligjerata e zhdrejtë<br>- Dallon ligjëratën e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë | Kriteret e suksesit:<br>- Kthe ligjëratën e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë<br>- Krahaso ligjëratën e drejtë me ligjëratën e |

| | |
|---|---|
| - Krahason ligjëratën e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë | zhdrejtë |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Pyetja e ditës**

Mësimdhënësi shkruan dy fjali për të njëjtën situatë në tabelën e klasës, si:

**Butrinti tha:- Më duket se çdo gjë po më shkon mirë.**

*dhe,*

**Butrinti më tha se po i duket sikur çdo që po i shkon mirë.**

Dhe kërkon nga nxënësit që të analizojnë këto dy fjali dhe të arrijnë në përfundim se a janë të njëjta këto fjali apo jo?

Nxënësit arsyetojnë përgjigjet e tyre.

Mësimdhënësi tregon se këto dy fjali janë të ndryshme sepse e para është ligjëratë e drejtë kurse e dyta ligjëratë e zhdrejtë.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Leksion i avancuar**

Mësimdhënësi thellohet në shpjegim të dy koncepteve kryesore të ditës: Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë.

Sqarimi realizohet duke u munduar që t'i shndërroj bashkërisht me nxënësit ligjëratat e drejta në ligjërata të zhdrejta.

| Fjali në ligjëratën e drejtë | Fjalitë në ligjëratën e zhdrejtë |
|---|---|

| | |
|---|---|
| Learti tha:<br>- Më duket se jam bërë pak përtac.<br>- Mezi më del gjumi për të shkuar në shkollë.<br>- Kohët e fundit edhe më mësime pak kam rënë.<br>- Nuk jam i rregullt me detyra.<br>- Më duket se gjithçka po më shkon lëmsh.<br>- Po kush e zgjidh lëmshin nëse nuk kërkon ndihmë?! | |

Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup e ka nga një detyrë të librit.

Mësimdhënësi përcjell punën e pavarur të nxënësve duke i vëzhguar ata dhe kohë pas kohe duke iu dhënë komente konstruktive.

Nga një përfaqësues për secilin grup prezenton punën e grupit ndërsa nxënësit e grupeve tjera gjykojnë përgjigjet e grupit me saktë apo gabim.

**Përforcimi:**

**Tabela e krahasimit**

Secili nxënës në fletoren e tij krijon tabelën e krahasimit.

Në njërën anë nxënësi shkruan tri informacione për ligjëratën e drejtë dhe tre shembuj të ligjëratës së drejtë dhe në anën tjetër shkruhen tri informata për ligjëratën e zhdrejtë dhe jepen tre shembuj të kësaj ligjërate.




Informatë kthyese
Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Formo tri fjali në ligjëratën e drejtë dhe pastaj ktheji në ligjëratën e zhdrejtë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## GJYSHJA DHE NIPI

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **GJYSHJA DHE NIPI**

Fjalët kyçe: gjyshe, nip, dikur, kohëra

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Gjen fjalë që rimojnë | - Gjej fjalë që rimojnë me fjalët e dhëna |
| - Plotëson pyetjet për poezinë | - Plotëso pyetjet për poezinë |

| | |
|---|---|
| - Krijon pyetje për gjyshërit | - Krijo pyetje për gjyshërit |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletë punuese, fletore

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Konkurs**

Mësimdhënësi ndan nxënësit në katër grupe.

Mësimdhënësi shkruan në tabelë këto fjalë:

***Akullore*** ***zemër*** ***violina***

***dera*** ***goma*** ***orë***

Puna e nxënësve në këtë pjesë të orës është që të gjejnë fjalë që rimojnë me këto fjalë.

Nga një përfaqësues tregon se sa fjalë kanë gjetur dhe cilat janë ato.

Për çdo fjalë të gjetur grupi merr dy pikë.

Pikët e grumbulluara shkruhen në tabelë.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Lexim me zë**

Secili nxënës lexon. Poezia mund të ndahet në 2 pjesë që secili nxënës të ketë kohë të lexojë dhe të vlerësohet për leximin e tij.

Nxënësit vlerësohen për:

*Rrjedhshmërinë në lexim;*

*Respektimin e shenjave të pikësimit;*
*Intonacionin.*

Vlerësimi i leximit mund të bëhet me koment kthyes apo notë.

Nxënësit përgjigjen dhe plotësojnë përgjigjet e pyetjeve 1 – 5 të aparatit pedagogjik.

**Përforcimi:**

**Pyetje për intervistë**

Meqenëse poezia krahason kohërat e dikurshme dhe të sotmet, nxënësit krijojnë pyetje për të intervistuar gjyshërit.

Pyetjet mund të bëhen për aspektet që i vë në pah poezia apo për gjëra që ju interesojnë fëmijëve.

Pyetjet mund të shkruhen në hapësirën e detyrës së gjashtë të librit bazë, apo në një fletë punuese të përgatitur nga mësimdhënësi.



| |
|---|
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Kthe poezinë Gjyshja dhe nipi në prozë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## KEQKUPTIMI

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **KEQKUPTIMI**

Fjalët kyçe: keqkuptim, nxitim, teknologji, rrezik

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Përgjigjet në pyetjet për tregimin<br><br>- Argumenton mendimin e tij/saj | - Argumento mendimin<br><br>- Harto në hartë të ngjarjes tregimin |

| | |
|---|---|
| - Harton ngjarjen | |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletë e përgatitur

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, teknologjia

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Pro apo kundër**

Mësimdhënësi ofron një tabelë secilit fëmijë.

Në tabelë janë të renditura5 deklara që lidhen me teknologjinë dhe përdorimin e saj nga fëmijët.

Fëmijët duhet të deklarohen se a janë pro apo kundër dhe të argumentojnë mendimin e tyre.

*Te jam pro apo kundër nxënësi deklarohet me një tick.*

| **Deklarata** | Jam pro | Jam kundër | **Sepse...** |
|---|---|---|---|
| 1. Fëmijët mund të qëndrojnë sa të duan në telefon sepse ata dinë të organizojnë kohën e tyre. | | | |
| 2. Fëmijët nuk bën të kenë rrjete sociale. | | | |
| 3.Fëmijët duhet ta përdorin teknologjinë sepse ajo i zhvillon në shumë segmente. | | | |
| 4. Puna e fëmijëve në teknologji duhet të mbikqyret nga prindërit. | | | |
| 5. Fëmijët e moshës nën 12 vjeçare nuk bën të kenë qasje në teknologji. | | | |

Nxënësit brenda grupit i komentojnë zgjedhjet dhe i arsyetojnë ato.

**Ndërtimi i njohurive:**

Lexohet në mënyrë të pavarur teksti nga nxënësit dhe udhëzohen që pas leximit të plotësojnë grafikun me përgjigje që lidhen me ngjarjen.




Bashkarisht e gjithë klasa diskutojnë mbi çështjen e hapur në detyrën e tetë të librit bazë.

**Përforcimi:**

**Punë e pavarur**

Pasi të kenë lexuar mirë e të kenë kuptuar tregimin, secili nxënës në mënyrë të pavarur përgjigjet në pyetjet e librit lidhur me tregimin **Keqkuptimi**.

| |
|---|
| Nxënësit shkëmbejnë librat e tyre në çift dhe vlerësojnë me shenja secilën përgjigje.<br><br>Në fund të fletës nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit me informatë kthyese apo figura. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Nxënësit lexojnë artikullinhttps://internetisigurte.org/publikimet/dhe mësojnë më shumë rreth sigurisë në internet. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **LEXOJ, GJEJ ZGJIDHJEN, ARGËTOHEM** | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4.III.8.** | |

| |
|---|
| **V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3.VI.3.** |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: **LEXOJ, GJEJ ZGJIDHJEN, ARGËTOHEM** |
| Fjalët kyçe: lexo, gjej, zgjidhje, argëtohemi |

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| -Gjen zgjidhje tëdetyrave logjike<br>- Analizon të dhënat<br>- Krijon detyra logjike | - Gjej zgjidhjen e secilës detyrë<br>- Analizo përshkrimet e dhëna<br>- Krijo detyrë logjike |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, material i përgatitur |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Artet |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br><br>**Punë në grup**<br><br>Nxënësit e klasës ndahen në tri grupe.<br><br>Njërit grup i ofrohen pesë gjëegjëza;<br>Njërit grup i ofrohen pesë fotografi me dallime; |

Njërit grup (secilit nxënës) i ofrohen nga dy kafshë që duhet t'i pantomimojnë.

**Shembull për gjëegjëza:**

Një patë qafëgjatë,
duke ikur bën shamatë.

**Shembull për fotografi me dallime:**





Mësimdhënësi vëzhgon punën e grupeve.

Grupet prezentojnë punën e bërë para shokëve të klasës duke e përshkruar detyrën dhe rrjedhën e aktivitetit.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Punë në çift**

Secili çift analizon përshkrimet e dhëna në librin bazë dhe gjejnëpërgjigjen/fotografinë e duhur.

Nxënësit shkëmbejnë dhe komentojnë me njëri-tjetrin përgjigjet dhe gjykojnë se a kanë gjetur të saktat apo jo.

| |
|---|
| Zgjidhjet e detyrave logjike në libër janë:<br><br>1. Cili është fustani? ( zgjidhja: **Fustani i verdhë me pika**)<br>2. Gjëegjëza (zgjidhja: **Breshka**)<br>3. Prej nga erdhën nxënësit? (zgjidhja: Sipas renditjes në ilustrimin e dhënë në libër nxënësit janë: **Kenza nga Prizreni; Dioni nga Gjakova; Drini nga Peja: Kaula nga Ferizaji.**<br><br>**Përforcimi:**<br><br>**Punë e pavarur**<br><br>Secili nxënës mundohet të krijojë një aktivitet logjik dhe atë aktivitet e prezenton para shokëve.<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për:<br><br>*Kreativitetin e detyrës logjike;*<br><br>*Qartësinë e kërkesës apo përshkrimeve;*<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin me dy yje dhe një dëshirë. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë<br><br>Dy yje një dëshirë |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| FJALIA, PARAGRAFI DHE TEKSTI | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1, III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**<br><br>**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **FJALIA, PARAGRAFI DHE TEKSTI** | |
| Fjalët kyçe: fjali, paragraf, ndërtim, tekst | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Dallon konceptet e trajtuara<br><br>- Plotëson ushtrimet e dhëna<br><br>- Krijon paragrafe sipas udhëzimeve | Kriteret e suksesit:<br><br>- Plotëso ushtrimet e dhëna<br><br>- Krijo paragraf me pesë fjali |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, PP, fletorja |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br><br>**Punë në grup**<br><br>Mësimdhënësi vendos në Poëerpoint (ose shkruan në tabelë) tri shembuj për konceptet që do të trajtohen:<br><br>Dy fjali<br>Një paragraf<br><br>Një tekst<br><br>Kërkon nga nxënësit që me shpejtësi, brenda grupit, të analizojnë secilën dhe të grumbullojnë sa më shumë informacione për to.<br><br>Ato informacione i lexon njëri anëtar i grupit dhe i komentojnë të gjithë bashkarisht.<br><br>Si mund të duket faqja e punës në poëerpoint: |




Finalizohet diskutimi nga mësimdhënësi duke u pohuar që në rastin e parë kemi të bëjmë me fjalitë, në rastin e dytë me paragrafët dhe në rastin e tretë me tekstin.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Shënim mbi shënim**

Mësimdhënësi fton nxënësit që të hapin librin dhe fillon të plotësojë një skemë të përgatitur për të sqaruar secilin koncept të njësisë mësimore.




Mësimdhënësi bashkarisht me nxënësit plotësojnë të gjitha detyrat e librit bazë.

**Përforcimi:**

**Shkrim i lirë**

Secili nxënës në fletoren e tij krijon një paragraf.

**Kriteret e shkrimit:**

- Paragrafi të ketë jo më pak se 5 fjali
- Paragrafi të shkruhet mbi temën: një ditë në shkollë
- Paragrafi të ketë fjali përmbyllëse

Vlerësim me figura

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR | |
|---|---|
|  | Në bazë të fotos, shkruaj një paragraf sipas rregullave të mësuara. Nxirr fjalinë kryesore në bazë të pamjes së fotos. Plotësoje fjalinë kryesore dhe shto detaje tjera, pa harruar fjalinë përmbyllëse të paragrafit. Lexo paragrafin para klasës. Diskutoni me mësuesen dhe shokët nëse e keni shkruar paragrafin sipas rregullave të mësuara. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** | |
| | |

# Dita e Pavarësisë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

| |
|---|
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: **Dita e Pavarësisë** |
| Fjalët kyçe: pavarësi, festë, ditë e madhe |

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Kthen poezinë në prozë<br><br>- Numëron fakte për Kosovën<br><br>- Përgjigjet në pyetjet e bëra | - Numëro fakte për Kosoven<br><br>-Kthe poezinë Dita e Pavarësisë në prozë<br><br>- Përgjigju në pyetjet e dhëna |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Kllaster**
Mësimdhënësi shkruan në qendër të tabelës emrin: **Kosova**

Kërkon nga nxënësit që të tregojnë se çfarë dijnë apo në çfarë ju shkon mendja kur e dëgjojnë emrin Kosovë.




Mësimdhënësi mund të jap informacione për: sipërfaqen e Kosovës, numrin e banorëve, historinë e re

të Kosovës.

Nxënësit përshkruajnë kllasterin në fletoret e tyre.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Lexim me intonacion**

Secili nxënës lexon me zë poezinë Dita e Pavarësisë.

Pastaj nxënësit bashkarisht me mësimdhënësin analizojnë poezinë duke plotësuar pyetjet 1 – 10 të librit bazë.

**Përforcimi:**

**Punë individuale**

Fillimisht kujtohen dallimet mes prozës dhe poezisë.

Pastaj secili nxënës në fletoren e tij e kthen në prozë poezinë Dita e Pavarësisë.

**Mësimdhënësi vlerëson për:**

- Drejtshkrimin
- Bukurshkrimin
- Shndërrimin në prozë të poezisë
- Respektimin e normave të shkrimit

Informatë kthyese
Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Shkruaj një ftesë për organizimin e Festës së Pavarësisë në shkollën tuaj, duke u bazuar te modeli i dhënë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Drini e Mirusha

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Drini e Mirusha**

Fjalët kyçe: Drin, Mirushë, bukuri, natyrë, vendlindje

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Përgjigjet në pyetjet që i drejtohen<br>- Numëron tri bukuri natyrore të Kosovës<br>- Imagjinon sipas udhëzimeve | - Thuaj tri bukuri natyrore të Kosovës<br>- Mbyll sytë dhe imagjino<br>-Përgjigju në pyetjet për tregimin |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |

**Parashikimi:**

**Shkrim 10 minutësh**

Secilit nxënës i ofrohet nga një letër e vogël dhe në të kërkohet të shkruhet se në cilat vende ju shkon mendja kur dëgjoni fjalinë: ***Kosova ka shumë vende të bukura***.

Secili nxënës lexon vendet që i ka shkruar dhe mësimdhënësi në tabelë krijon një diagram dhe në të shkruan të gjitha vendet e përmendura.




**Ndërtimi i njohurive:**

**Imagjinatë e drejtuar**

| |
|---|
| Mësimdhënësi fton nxënësit që të mbyllin sytë ndërkohë që ai lexon.<br><br>Mësimdhënësi lexon me ndërprerje dhe kohë pas kohe pyet nxënësit:<br>*Si mendoni që do të vazhdoj ngjarja?*<br>*A keni vizituar ju ndonjëherë burimin e Drinit?*<br>*Po ujëvarën e Mirushës apo Shpellën e Gadimes?*<br><br>Hapet diskutimi për këto bukuri natyrore duke i identifikuar të gjitha veçantitë dhe të përbashkëtat.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>**Punë individuale**<br><br>Secili nxënës rilexon tregimin dhe një herë që ta ketë dhe më të qartë ngjarjen dhe përgjigjet në pyetjet e dhëna në aparatin pedagogjik.<br><br>Meqë të gjitha pyetjet lidhen vetëm me përmbajtjen e tregimit, nxënësit përgjigjen në të gjitha.<br><br>Nxënësit shkëmbejnë librat për të vlerësuar punën e njëri tjetrit. |
| |
| Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Përfundohet detyra e librit bazë: Cilat vende do të dëshiroje t'i vizitoje, nëse do të organizonit një ekskursion me mësuesen dhe shokët e shoqet e klasës. Shkruaj vendet, diskuto, arsyeto, pse ke dëshirë t'i vizitosh ato vende. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| LIBRI I REKORDEVE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **LIBRI I REKORDEVE** | |
| Fjalët kyçe: libri, rekord | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Shkruaj sipas udhëzimeve<br>- Shpjegon rëndësinë e librit Ginnis<br>- Numëron disa shqiptarë që janë në librin Ginnis | Kriteret e suksesit:<br>- Shpjego rëndësinë e librit Ginnis<br>- Shkruaj me fjalë kyçe |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br><br>**Shkrim me fjalë kyçe**<br><br>Mësimdhënësi shkruan këto fjalë kyçe në tabelë:<br><br>*Kur të rritem, talentet e mia, rekord, punë, rritje*<br><br>Nxënësit krijojnë një tregim të shkurtër dhe vetëm nxënësit vullnetarë e lexojnë shkrimin.<br><br>Mësimdhënësi jep informacion për librin e Ginnisit dhe për librin e rekordeve.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>**Lexohet për shqiptarët në librin Ginnis**<br><br>Nxënësit lexojnë dhe identifikojnëme shenjë informata të rëndësishme për shqiptarët që kanë thyer rekorde dhe janë pjesë e librit Ginnis.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>**Shkrim i lirë**<br><br>Nxënësit shkruajnë me temën: Kur të rritem dua të bëhem<br><br>Nxënësit shkëmbejnë brenda grupit shkrimet dhe vlerësojnë për:<br><br>*a) drejtshkrim*<br>*b) bukurshkrim*<br>*c) rrjedhshmëri* |
| |
| Vlerësim i ndërsjellë |

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
|---|
| Hulumtojmë për librin Ginnis dhe shqiptarët që janë në të. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Gjuha shqipe

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
|---|---|

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Njësia mësimore: **Gjuha shqipe** | |
| Fjalët kyçe: gjuhë amtare, gjuha e nënës | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Punon sipas udhëzimeve<br>- Rendit copëzat e poezisë<br>- Kthen tekstin e shkruar në dialekt në gjuhën letrare | Kriteret e suksesit:<br>- Rendit copëzat e poezisë<br>- Kthe tekstin e shkruar në dialekt në gjuhë letrare<br>- Puno sipas udhëzimeve |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletët | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**

**Copëzat e përziera**

Mësimdhënësi përzien në fisha të vogla pjesët e poezisë dhe secilit nxënës i jep copëzat e saj.

Në një fletë me ngjyrë fëmijët rendisin copëzat.

*Kujtohet që të kenë kujdes për përshtatjen mes rimave dhe kuptimit të vargjeve.*
Lexohet nga nxënësit renditja e vargjeve dhe ftohen që të hapin librin për të vetvlerësuar punën e tyre.

Mësimdhënësi bashkëbisedon me nxënësit për rëndësinë e gjuhës amtare dhe historinë e saj.

**Ndërtimi i njohurive:**

Secili nxënës lexon nga njëstrofë.

Bashkëbisedohet me mësimdhënësin për poezinë duke u përgjigjur në pyetjet 1-5.

Secili nxënës në mënyrë të pavarur shkruan strofën e tretë në gjuhën letrare.

| | |
|---|---|
| Nji kto gjuhë që jam tue ndie,<br>jan' të bukra me themel<br>por prap' kjo, si diell pa hije,<br>për mue t'tanave iu del. | ___________________________________________<br>___________________________________________<br>___________________________________________<br>___________________________________________ |

**Përforcimi:**

**Punë në grupe**

Mësimdhënësi ndan nxënësit e klasës në 3 grupe.

**Detyrat për grupe janë:**

**Grupi i parë:** Shkruani dy strofa për gjuhën amtare

**Grupi i dytë:**Kujtoni dhe shkruani një këngë për gjuhën shqipe apo për Atdheun

**Grupi i tretë:** Në hamer bëj një punim për gjuhën shqipe apo kombin shqiptar

Grupet me radhë dalin te tabela e klasës dhe prezentojnë punën e tyre.

*Mësimdhënësi vlerëson me notë punën dhe produktin e nxjerrë nga grupet.*

Vetvlerësim
Vlerësim me notë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Mëso përmendësh poezinë dhe recitoje atë me emocion.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Dita e gjuhës amtare

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Dita e gjuhës amtare**

Fjalët kyçe: gjuhë amtare, gjuha shqipe

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Përshkruan informatat e diktuara | - Gjyko pohimet me e saktë dhe gabim |
| - Gjykon pohimet e dhëna | - Shkruaj informacionin e dikuar |

| | |
|---|---|
| - Krijon një pesëvargësh për gjuhën | - Krijo një pesëvargësh për gjuhën |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja, fletë e kuqe dhe e gjelbër

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Histori

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**E saktë / gabim**

Mësimdhënësi shkruan disa fjali për gjuhën shqipe në tabelë dhe kërkon nga nxënësit që në duar të mbajnë fletët me ngjyrë të kuqe dhe të gjelbër.

Kur mësimdhënësi lexon fjalinë, nxënësit e ngrejnë letrën e kuqe nëse pohimi është gabim ndërsa letrën e gjelbër nëse pohimi është i saktë.

Pohimet mund të jenë, si:

*Gjuha shqipe ka 29 bashkëtingëllore e 7 zanore;*

*Gjuha shqipe flitet vetëm në gjuhën letrare;*

*Gjuha shqipe është gjuhë e re;*

*Gjuha shqipe ka një dialekt*

*Autorë të mëdhenj të gjuhës shqipe janë: Vëllezërit Frashëri, Dritëro Agolli, Ndre Mjedja*

etj.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Leksion i avancuar**

Mësimdhënësi dikton informatat për:

Mesharin, Evetarin, Shkollën e parë shqipe.

Nxënësit plotësojnë hapësirat në librin bazë sipas diktimit të mësimdhënësit.

| |
|---|
| **Përforcimi:**<br><br>**Pesëvargësh**<br><br>Secili nxënës në mënyrë të pavarur krijon një pesëvargësh për gjuhën amtare.<br><br>Në pesëvargësh shkruhet:<br><br>*1 emër*<br>*2 mbiemra*<br><br>*3 folje*<br>*Një fjali me 4 fjalë*<br>*1 sinonim*<br><br>Fleta ku shkruhet pesëvargëshi për gjuhën zbukurohet sipas dëshirës nga nxënësit. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkruaj për rëndësinë e shkollës së parë shqipe dhe Mesharit të Gjon Buzukut. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| LIBRI | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br><br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **LIBRI** | |
| Fjalët kyçe: libër, lexim, analizë, komentim | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Plotëson të dhëna për librin e lexuar<br><br>- Parashtron pyetje interesante per të tjerët<br><br>- Dizajnon kopertinën e librit të lexuar | Kriteret e suksesit:<br><br>- Parashtro një pyetje për një shok<br><br>- Dizajno se si do të dukej kopertina e librit sikur ti të ishe dizejnatori |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletë e bardhë | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet | |

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Parashikimi:**<br><br>**Punë individuale**<br><br>Secilit nxënës i ofrohet nga një fletë e bardhë.<br><br>Nxënësit udhëzohen që në këtë fletë të bardhë të dizajnojnë se si do të dukej libri nëse ata do të ishin dizejnatorët.<br><br>Të gjitha punimet varen në shiritin e klasës.<br><br>*Nxënësit në kopertinë udhëzohen që të shkruajnë saktë titullin e librit dhe emrin e autorit.*<br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>**Tryeza e rrumbullakët**<br><br>Mësimdhënësi organizon klasën në atë mënyrë që të gjithë fëmijët të jenë të ulur në rreth.<br><br>Secili nxënës përshkruan me pesë fjali librin e lexuar, ndërsa të tjerët shkruajnë pyetje për diçka që ju intereson për atë libër.<br><br>Në fund, pasi të gjithë nxënësit të kenë komentuar shkurtimisht librin, hapet mundësia për parashtrim të pyetjeve.<br><br>Çdo nxënës i drejtohet vetëm një shoku me pyetje që lidhet me librin.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>Secili nxënës hap librin dhe plotëson tri pyetjet e para dhe vëmendje e posaçme i kushtohet shkrimit të udhëzuar në librin bazë.<br><br>Sipas kërkesës, nxënësit i shkruajnë një letër autorit të librit të lexuar.<br><br>• *Shkruaj për përshtypjet tua për librin e lexuar.*<br>• *Kujdes, përmbaju pjesëve të letrës, hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes!* |
| |
| Vlerësim i ndërsjellë |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Folja

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Folja**

Fjalët kyçe: folje, kohë, veprim, zgjedhim

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Përdor foljet e dhëna<br>- Kujton njohuritë për foljen | - Trego se çfarë di për foljen<br>- Numëro kohët e foljes që i kemi mësuar në klasë të tretë |

| | |
|---|---|
| - Numëron kohët e mësuara të foljes | - Krijo një paragraf me foljet e dhëna |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja, fleta A4

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Mësimdhënësi i bën disa veprime, si: ec nëpër klasë, duartroket, këndon, hap dritaren, etj dhe pas çdo veprimi pyet nxënësit: çfarë po bëj?

Nxënësit përgjigjen dhe mësimdhënësi pyet: si quhet pjesa e gjuhës që tregon veprimet që bëjmë?

A është emri, mbiemri, folja apo ndajfolja?

Nxënësit përgjigjen dhe mësimdhënësi prezenton njësinë e re mësimore.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Leksion i avancuar**
Meqenëse nxënësit kanë mësuar dhe më parë për foljen, mësimdhënësi ndërton informacionet bashkarisht me ta.

Kujtohen të gjitha dijet e mësuara për foljen, kohët e mësuara tësaj. Të gjitha informacionet e grumbulluara shkruhen në tabelë dhe mësimdhënësi shkruan për secilën kohë të foljes nga një fjali shembull.

Nxënësit përshkruajnë informatat nga tabela dhe shkruajnë nga dy shembuj për secilën kohë të foljes.

**Përforcimi:**

**Punë në grupe**

Nxënësve në grup ju jepen 7 folje të ndryshme, në kohë të ndryshme të foljes, të shkruara në fisha të vogla.
Kërkohet nga ta që të shkruajnë një paragraf të shkurtër ku do t'i përdorin të gjitha foljet e shkruara, në

| |
|---|
| atë kohë që janë.<br><br>Një përfaqësues i grupit lexon shkrimin dhe mësimdhënësi vlerëson me yje punën. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me yje |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Gjej disa folje dhe shkruaj foljen e kundërt me to, p.sh: jam – s'jam, gëzohem – mërzitem, ec – ndaloj. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Koha e kryer e thjeshtë | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1, III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**<br><br>**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Koha e kryer e thjeshtë** | |
| Fjalët kyçe: koha e kryer e thjeshtë, folje, veprim | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Tregon funksionin e foljes në fjali<br><br>- Identifikon foljen në kohën e kryer të | Kriteret e suksesit:<br><br>- Trego funksionin e foljes në fjali<br><br>- Identifiko foljen në kohën e kryer të thjeshtë brenda |

| | |
|---|---|
| thjeshtë brenda fjalisë<br><br>- Krijon fjali me foljen në kohën e kryer të thjeshtë | fjalisë<br><br>- Krijo së paku 2 fjali me foljen në kohën e kryer të thjeshtë |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Mësimdhënësi shkruan në mes të tabelës **FOLJA** dhe kërkon nga nxënësit që kush di diçka për foljen, të dal në tabelë dhe të plotësoj njërën nga hapësirat boshe.




Çdo informatë e shkruar vlerësohet me: saktë/pasaktë nga mësimdhënësi.

Mësimdhënësi prezenton temën e re mësimore.

**Ndërtimi i njohurive:**

Meqenëse koha e kryer e thjeshtëështë kohë e re për nxënësit, mësimdhënësi jep sa më shumë sqarime

për këtë kohë dhe shembuj.

Pasi të analizohet në tërësi teksti i dhënë në librin bazë, nxënësit ftohen që në fletoret e tyre të krijojnë një tabelë dypjesëshe dhe në të të krahasojnë kohën e tashme me kohën e kryer të thjeshtë.

**Udhëzohen që:**
Të tregojnë se kur ndodh veprimi me foljen në njërën kohë e kur në tjetrën. Për secilën kohë shkruhen së paku 3 fjali shembuj.

Mësimdhënësi vëzhgon dhe vlerëson punën e nxënësve ndërkohë që ata punojnë.

**Përforcimi:**

Nxënësit ndahen në katër grupe.

Çdo grup ka nga një detyrë të aparatit pedagogjik, pra: grupi 1 – detyrën 1, grupi 2 – detyrën 2...

Nxënësve ju jepen 5 minuta për ta përfunduar detyrën dhe pastaj një përfaqësues i grupit e lexon punën.

Mësimdhënësi dhe nxënësit e tjerë e gjykojnë saktësinë e përgjigjes.

Nxënësit e klasës përshkruajnë përgjigjet e sakta në libër.

Informatë kthyese

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Shkruaj një tekst të shkurtër me foljet në kohën e tashme dhe kthe po atë në tekst me foljet në kohën e kryer të thjeshtë. Identifiko me të kuqe ndryshimet që pësoi folja.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Ushtari i lirisë | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br><br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Ushtari i lirisë** | |
| Fjalët kyçe: liria, ushtar, | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Shkruan shpejt disa cilësi të ushtarit të lirisë<br><br>- Përgjigjet në pyetjet që lidhen me UÇK-në | Kriteret e suksesit:<br><br>- Shkruaj shpejt disa cilësi që ti mendon se i ka një ushtar lirie<br><br>- Përgjigju në pyetjet e parashtruara |

| | |
|---|---|
| - Krijon një medalje për ushtarin e lirisë | - Krijo në një fletë A4 një medalje për ushtarin e lirisë |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletë A4, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**

**Shkrim i lirë**

Mësimdhënësi shkruan në qendër të tabelës: *Ushtari i lirisë* dhe kërkon nga nxënësit që në fletoret e tyre të vizatojnë shpejt se si e imagjinojnënë pamje të jashtme një ushtar të lirisë dhe çfarë cilësish mendojnë që ka ushtari.

Pra, nxënësit shkruajnë vetëm mbiemra rreth e rreth ushtarit.



**Ndërtimi i njohurive:**

**Pyetje-përgjigje**
Mësimdhënësi lexon me intonacionin e duhur poezinë dhe kërkon nga nxënësit që të dëgjojnë me vëmendje.

Pastaj, mësimdhënësi parashtron pyetjet:

*Kush mendon ti qëështë porosia e kësaj poezie?*

*Pse këtë poezi po e mësojmë në muajin mars?*

*A ke dëgjuar ndonjëherë për UÇK-në?*

*Po për Epopenë e UÇK-së ke dëgjuar?*

Nxënësit shkruajnë një falenderim për ushtarët e lirisë ashtu si udhëzon detyra e tretë e librit bazë.

**Përforcimi:**

Mësimdhënësi paraqet para nxënësve një mirënjohje dhe sqaron se çfarë elementesh duhet të përmbajë mirënjohja.

Nxënësve ju jepet nga një fletë e bardhë.

Secili nxënës në atë fletë krijon një mirënjohje për ushtarët e lirisë, për kontributin e tyre gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Mirënjohjet ekspozohen në murin e klasës.

Informatë kthyese
Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Përfundohet detyra e 4 e librit bazë: Vizato një medalje me të cilën do të doje ta shpërbleje Ushtarin e Lirisë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## Shkruajmë ese

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Shkruajmë ese**

Fjalët kyçe: ese, shkrim, norma, drejtshkrim

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Gjen fjalët e shkruara drejtë<br>- Shkruan ese mbi temën e caktuar | - Rrumbullakso vetëm fjalët e shkruara saktë<br>- Ndaj në tabelën di, dua të di, mësova informacionet që i ofron libri |

| | |
|---|---|
| - Klasifikon informatat që i merr | - Shkruaj ese mbi temën Ushtari i lirisë |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libi bazë, fletë punuese, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**E saktë / gabim**

**Nxënësit ndahen në çifte.**

**Secilit çift i ofrohet një fletë punuese e përgatitur me rreth 20 fjalë të shkruara.**

Marrë parasysh që drejtshkrimi është një komponentë shumë e rëndësishme e shkrimeve, mësimdhënësi me këtë aktivitet provon të ndërgjegjësoj nxënësit për rëndësinë dhe kujdesin që duhet ta kemi në lidhje me drejtshkrimin.

Mësimdhënësi në fletë shkruan disa fjalë saktë dhe disa gabim dhe pret nga nxënësit që të qarkojnë vetëm fjalët e shkruara drejtë.

Mësimdhënësi pyet secilin çift për fjalët e sakta dhe vlerëson nxënësit për saktësinë dhe bashkëpunimin.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Di, Dua të di, Mësova**

Fjala ese nuk është e panjohur për nxënësit e klasës së katërt. Por në këtë moshë ata duhet tëthellojnë dijet për të.

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit që të krijojnë në fletoret e tyre një tabelë për di, dua të di dhe mësova dhe në të të organizojnë informacionet e reja që i marrin nga libri bazë.

| |
|---|
| **Përforcimi:**<br><br>**Punë individuale**<br><br>Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të hapin librin. Udhëzohen që të lexojnë me vëmendje kërkesën e parë të librit dhe të fillojnë të shkruajnë ese për temën: ***Ushtari i lirisë.***<br><br>Jepen udhëzimet e qarta dhe mësimdhënësi shkruan në tabelë pyetjet ndihmëse:<br><br>*Pse i duhet vendit ushtari i lirisë?*<br>*Cili është misioni i tij/saj?*<br>*Cila është sakrifica e tij/saj?*<br>*A i dhimbset jeta?*<br>*Cili është respekti që duhet të tregojmë për ushtarët e lirisë?*<br>*Cili është obligimi ynë ndaj vendit tonë?*<br>*Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në librin bazë.* |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkruajnë ese sipas dëshirës |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Ese për mësuesen time

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
| --- | --- |
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Ese për mësuesen time**

Fjalët kyçe: mësuesja, festë, 7 marsi, ese

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
| --- | --- |
| - Gjen përgjigjet e pyetjeve të dhëna<br>- Sqaron se përse festohet 7 Marsi<br>- Krijon pesëvargësh për mësuesin/en | - Trego se për kë festohet më 7 Mars<br>- Përgjigju saktë në pyetjet e aparatit pedagogjik<br>- Krijo një pesëvargësh për mësuesin/en tënde |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br><br>**Kllaster**<br><br>Mësimdhënësi në qendër të tabelës shkruan: **7 Marsi**.<br><br>Kërkon nga nxënësit të shkruajnë mendimet dhe informacionet që kanë për këtë ditë.<br>Mësimdhnësi pyet nxënësit:<br><br>*Përse me 7 mars festohet për mësuesit?*<br><br>*Kur u hap shkolla e parë shqipe?*<br><br>*Ku u hap ajo?*<br><br>*Si quhej?*<br><br>*Kush ishte mësimdhënësi i parë?*<br>*Çfarë mësohej në këtë shkollë?*<br><br>*Kush ishin nxënësit, vajzat dhe djemtë apo?*<br><br>Nëse nxënësit nuk i kanë këto informacione atëherë mësimdhënësi i jep të gjitha dhe nxënësit i shkruajnë ato në fletoret e tyre.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>**DLTA**<br><br>Mësimdhënësi kërkon nga disa nxënës që të lexojnë esenë e Edlirit. Nxënësit vlerësohen për leximin e tyre.<br><br>Pastaj, mësimdhënësi parashtron pyetjet e aparatit pedagogjik, një nxënës përgjigjet në një pyetje e të tjerët plotësojnë librin dhe kështu me radhë. *(Detyra e katërt nuk plotësohet)* |

**Përforcimi:**

**Akrostik**

Secili nxënës në fletoret e tij shkruan shkronjat e emrit MËSUESJA me ngjyra. Për çdo shkronjë shkruan nga një fjali që lidhet me atë shkronjë.

M ______________________________

Ë ______________________________

S ______________________________

U ______________________________

E ______________________________

S ______________________________

J ______________________________

A ______________________________

Nxënësit lexojnë shkrimet e tyre dhe shkëmbejnë me njëri tjetrin për t'i vlerësuar ato.

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Krijojnë një pesëvargësh për mësuesen dhe ky pesëvargësh shkruhet në librin bazë, te detyra e katërt.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## Dhuratë për nënën

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2.I.3.I.5I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3 III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2**. **VI.3VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 6**

**2. 1; 2. 5; 2. 6**

**3. 3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Dhuratë për nënën**

Fjalët kyçe: dhuratë, nëna, 8 Marsi, Dita e Gruas

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Shkruan shkrim me fjalë kyçe | - Shkruaj shpejt një shkrim me fjalët e dhëna |
| - Dramatizon pjesën | - Dramatizo rolin që të është dhënë |
| - Shkruan ese sipas kritereve të përcaktuara | - Shkruaj një ese për nënën |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja, fletë a4

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Shkrim përmes fjalëve kyçe**

Mësimdhënësi shkruan në tabelë fjalët kyçe: nëna, e shtrenjtë, e dashur, besim, edukatë, familje

Nxënësit në fletoret e tyre shkruajnë për nënën mbi këto fjalë kyçe.

Disa nxënës lexojnë me zë të lartë shkrimet dhe shokët vlerësojnë me dy yje/ një dëshirë.

*(Yjet jepen për aspektet më të forta të shkrimit; dëshira për shkrimet e së ardhmes).*

**Ndërtimi i njohurive:**

**Lexim me role**

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup duhet t'i ketë nga pesë anëtarë, aq sa ka dhe drama "Dhuratë për nënën".

Nxënësve ju ndahen rolet dhe ata dramatizojnëpjesën.

Shpërblehet me nga një yll në libër grupi me performancën më të mirë.

**Përforcimi:**

**Punë individuale**

Mësimdhënësi jep secilit nxënës nga një fletë të bardhë.

Nxënësit zgjedhin një formë të shkrimit, preferohet ese.

Nxënësit shkruajnë për temën: **Nënë, ti për mua je.**

Fëmijët udhëzohen që këtë shkrim ta shkruajnë me bukurshkrim; duke respektuar rregullat e

| |
|---|
| drejtshkrimit dhe me fjalët më të sinqerta.<br><br>Fleta duhet të zbukurohet me ilustrime domethënëse.<br><br>**Letra vendoset fshehurazi në dhomën e fjetjes së nënës si befasi për të.**<br><br>Nxënësit ndajnë eksperiencat për këtë përvojë, të nesërmen në klasë. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Meqenëse në aparatin pedagogjik ka pyetje personale, nxënësit udhëzohen që atyre pyetjeve të ju përgjigjen individualisht në shtëpi. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Orteku

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Orteku**

Fjalët kyçe: ortek, dëmtim i pyjeve, arinjtë, kafshët

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Sqaron se ç'është orteku | - Trego se ç'është orteku |
| - Krahason dy fjali të marra nga tregimi | - Përgjigju në pyetjet e aparatit pedagogjik |
| - Analizon përmbajtjen e tregimit | - Ilustro fjalitë sipas udhëzimeve |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja, burime nga interneti

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
Pyetja e ditës

Mësimdhënësi pyet:
**Më numëroni disa dukuri natyrore?**

Nxënësit përmendin ato që i dijnë.
Çfarë moti mbizotëron në Kosovë, gjatë vitit?

A keni dëgjuar ndonjëherë për fjalën ortek?

Mësimdhënësi shpjegon që orteku është grumbull i madh bore, që shkëputet nga malet e larta, rrokulliset teposhtë dhe sa vete e bëhet më i madh, duke shkatërruar ç`gjen përpara.

Prezentohet njësia e re mësimore.

**Ndërtimi i njohurive:**

Tabela e parashikimeve

Nxënësit e krijojnë tabelën e parashikimit në fletore.

Leximi i mësimit bëhet nga mësimdhënësi dhe ashtu sic rekomandon libri, leximi bëhet me pesë ndalesa.

Pas çdo ndalese nxënësit plotësojnë hapësirën një dhe dy dhe në fund të leximit plotësojnë hapësirën tre.

| Ndalesa | Çfarë mendoni se do të ndodhë? | Çfarë provash keni? | Çfarë provash keni? |
|---|---|---|---|
| Pjesa I | | | |
| Pjesa II | | | |
| Pjesa III | | | |
| Pjesa IV | | | |
| Pjesa V | | | |

Nxënësit përgjigjen në pyetjet 1 – 3 të aparatit pedagogjik.

**Përforcimi:**

**Para/pas**

Në tregimin Orteku, sqarohet (në nënrreshta) se si është dukur mali para ardhjes së arinjve dhe pas veprimeve të tyre.

Nxënësit duhet t'i gjejnë këto fjali dhe fjalinë që përshkruan se si është dukur orteku para ardhjes së arinjve e shkruajnë në hapësirën adekuate, dhe fjalinë pas e shkruajnë te vendi i duhur. Nxënësit zhvillojnë imagjinatën dhe ilustrojnë fjalitë.




Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit shkruajnë porosinë e tregimit në hapësirën e pyetjes 4.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Reshjet atmosferike | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: Reshjet atmosferike | |
| Fjalët kyçe: reshje, borë, shi, vesë, borë, brymë | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Përshkruan reshjet atmosferike<br><br>-Dallon reshjet në bazë të përshkrimeve | Kriteret e suksesit:<br><br>- Përshkruaj reshjen e caktuar atmosferike<br><br>- Gjej se për cilën reshje është fjala<br><br>- Krijo një gjëegjëzë për njërën nga reshjet e mësuara |

- Krijon gjëegjëza për reshjet atmosferike

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletë e përgatitur, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Tabela e krahasimeve**

Mësimdhënësi krijon në tabelë një tabelë ku shkruan reshjet që do të mësohen sot.

Kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë dijnë për këto reshje dhe ashtu plotësohet tabela.

Nxënësit përshkruajnë tabelën në fletore.

| Bora | Shiu | Vesa | Bryma |
|---|---|---|---|
| | | | |

**Ndërtimi i njohurive:**

**Punë në çift**

Nxënësit lexojnë shkrimin në libër dhe sipas udhëzimit të librit bazështojnë disa fjali te secili tekst dhe vendosin nga një titull për secilin.

Mësimdhënësi vëzhgon dhe vlerëson punën e nxënësve ndërkohë që ata punojnë.

Disa punime lexohen me zë të lartë para klasës.

| |
|---|
| **Përforcimi:**<br><br>**Krijojmë gjëegjëza**<br><br>Mësimdhënësi i jep secilit nxënës nga ¼ e fletës me ngjyrë A4. Në atë fletë nxënësit do të shkruajnë një gjëegjëzë për një reshje atmosferike apo dukuri natyrore.<br><br>Nxënësit shkëmbejnë fletat e vogla me shokët e çiftit dhe provojnë të gjejnë përgjigjet e sakta.<br><br>Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për qartësinë e gjëegjëzes dhe për saktësinë e përgjigjes.<br><br>Gjëegjëzat ngjiten në një hamer të përbashkët me titullin: **Gjëegjëzat tona**. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Hulumto më shumë për reshjet atmosferike. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Dallëndyshja dhe harabeli

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: Dallëndyshja dhe harabeli

Fjalët kyçe: dallëndyshe, fole

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Numëron sa më shumë emra shpezësh<br>- Veçon cilësitë e personazheve<br>- Analizon përmbajtjen e tregimit | - Gjej sa më shumë emra shpezësh<br>- Shkruaj cilësitë e harabelit dhe dallëndyshes<br>- Përgjigju në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e tregimit |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |

**Parashikimi:**

**Konkurs**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe.

Secili grup i jepet ½ e fletës së bardhë. Në të duhet të shkruajnë sa më shumë emra shpezësh.

Lexohet lista nga njëri përfaqësues i grupit.

Mësimdhënësi grumbullon pikët dhe grupi i nxënësve që fiton, fiton të drejtën për të lexuar me zë të lartë tregimin.

Prezentohet tema që do të trajtohet nga mësimdhënësi.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Punë e kombinuar**

Nxënësit e caktuar lexojnë tregimin.

Dy nxënës komentojnë me libra të mbyllura ngjarjen e tregimit.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të plotësojnë pyetjet 7, 8 dhe 9 të aparatit pedagogjik.

1. *Krahaso harabelin me ndonjë person që të kujton.*
2. *Krahaso dallëndyshen me një person që të kujton.*
3. *Shkruaj një porosi për njerëzit që punojnë shumë e flasin pak.*

**Përforcimi:**

**Analizë e persozheve**

Nxënësit ftohen që në fletoret e tyre të ilustrojnë harabelin dhe dallëndyshen duke bashkëbiseduar.

Anash secilës kafshë shkruajnë cilësitë e tyre në këtë tregim.



Nxënësit lexojnë punimet e tyre dhe marrin komente kthyese nga shokët e klasës.

Informatë kthyese

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Skruaje mendimin tënd për fjalët që thotë dallëndyshja:
“Foleja ndërtohet me punë e mendje, nuk ndërtohet vetëm me të ditur.”
Përgjigjja plotësohet në hapësirën e detyrës së gjashtë në librin bazë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| URANI | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **URANI** | |
| Fjalët kyçe: Urani, Sindromë Doën, miqësi, poezi, lumturi, pranverë | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Tregon se çfarëështë sindroma Down<br><br>- Nxjerr mesazhin e tregimit<br><br>- Krijon sipas kërkesës së mësimdhënësit | Kriteret e suksesit:<br><br>- Sqaro me fjalë tua se ç'është Sindroma Down<br><br>- Krijo sipas udhëzimeve të mësimdhënësit<br><br>- Gjej se kush është porosia e tregimit |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, fletë A4 |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br><br>**Pyetja e ditës?**<br><br>A keni dëgjuar ndonjëherë për Sindromën Down?<br><br>Nëse nxënësit nuk kanë dëgjuar, mësimdhënësi jep sqarime të detajuara për këtë sindromë.<br><br>Nëse nxënësit kanë dëgjuar apo e dijnë se çfarë është, atëherë krijohet një diagram me informata të kombinuara edhe nga mësimdhënësi edhe nga nxënësi.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>Mësimdhënësi lexon tregimin Urani.<br><br>Ai parashtron pyetjet e aparatit pedagogjik për të analizuar së bashku me nxënësit përmbajtjen dhe idenë kryesore të tregimit.<br><br>Pyetja dhjetë plotësohet individualisht nga nxënësit.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>**Punë në grupe**<br><br>Mësimdhënësi ndan nxënësit në tri grupe.<br><br>Grupi 1 ka për detyrë: Shkruani një poezi për pranverëm<br>Grupi 2 ka për detyrë: Shkruani ese të shkurtër për Ditën e Lumturisë<br>Grupi 3 ka për detyrë: Krijoni një kllaster për poezinë<br><br>*Punimet lexohen nga një përfaqësues i grupit.*<br><br>Mësimdhënësi vlerëson grupet për punën e bërë në grup dhe produktin me informatë kthyese dhe |

| |
|---|
| figura. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkruaj porosinë e tregimit që lexove. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

# Më jep një pikë ujë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Më jep një pikë ujë**

Fjalët kyçe: uji, pa ujë nuk ka jetë, dobitë e ujit

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| -Numëron karakteristikat e ujit<br>- Veçon informatat që ka<br>- Krijon një shkrim mbi temën e caktuar | - Trego se në çfarë të shkon mendja kur dëgjon fjalën ujë<br>- Veço informatat personale në tabelën di, dua të di, mësova<br>- Krijo një shkrim mbi temën 'Pa ujë nuk ka jetë' |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja, fleta A4

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
Kllaster

Mësimdhënësi shkruan në qendër të klasës fjalën UJË dhe pyet nxënësit:

*Çfarë fakte dini për ujin?*

*A ka përqindje të lartë të ujit në trupin e njeriut?*

*Sa përqind e tokës është e mbuluar me ujë?*

*Cfarë vetish ka uji?*

*Si është molekula e ujit?*

*Sa ditë mund të jetojë një njeri pa ujë?*

...

Nëse nxënësit nuk e dijnë ndonjërën nga pyetjet, mësimdhënësi jep informacionet.

Kllasteri përshkruhet në fletore, në të njëjtën kohë kur mësimdhënësi shkruan.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Di, dua të di, mësova**

Nxënësit lexojnë dhe analizojnë në mënyrë vetanake tregimin.

Informatat që i ofron tregimi ata i organizojnë në tabelën: di, dua të dhe mësova të cilën e kanë bërë paraprakisht në fletoret e tyre.

Së paku tre nxënës lexojnë punën e bërë.

Nxënësit përgjigjen në pyetjet 1 – 6.

| |
|---|
| **Përforcimi:**<br><br>**Shkrim me temë të caktuar**<br>Nxënësit ndahen në çifte dhe secilit çift i jepet nga një fletë e bardhë.<br><br>Në të nxënësit do të shkruajnë në njërën prej formave të shkrimit (sipas dëshirës) për temën "**Pa ujë nuk ka jetë**".<br><br>Punimet vendosen në murin e klasës pasi të kontrollohen për drejtshkrimin dhe qartësinë nga mësimdhënësi. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Bëni një fushatë vetëdijesuese për rëndësinë e ujit. Krijo një poster për vetëdijesimin e njeriut për ruajtjen e ujit.Posteri duhet të përmbajë:<br>- Foto për ujin.<br>- Një tekst ose thënie të shkurtër.<br>- Shkronjat që bien në sy.<br>- Ngjyra tërheqëse. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Llojet e fjalive sipas kumtimit | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1, III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**<br><br>**4. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**<br>5. | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: Llojet e fjalive sipas kumtimit | |
| Fjalët kyçe: fjali, lloje, dëftore, pyetëse, thirrmore, dëshirore, nxitëse | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Numëron llojet e fjalive sipas kumtitmit<br><br>- Dallon llojin e fjalisë<br><br>- Vendos si duhet shenjat e pikësimit | Kriteret e suksesit:<br><br>- Numëro llojet e fjalive sipas kumtimit<br><br>- Dallo se çfarë fjalish janë<br><br>- Vendos shenjat e duhura të pikësimit në fund të fjalive |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Stuhi mendimesh**

Mësimdhënësi shkruan disa lloje fjalish:

*U bëfsh 100 vjeç Andi!*

*Ec më shpejtë Bora!*
*Forca, ti mundesh Klajdi!*

*Unë solla ushqimin dje.*

*Çfarë bëre me gomën tënde?*

Dhe kërkon nga nxënësit që të mendojnë dhe reflektojnë se çfarë ju thonë këto fjali; çfarë dijesh ju kujtojnë; a janë të njëjta; pse dallojnë njëra me tjetrën?

Prezentohet tema e re mësimore.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Leksion i avancuar**

Mësimdhënësi sqaron se çfarë kumton secili lloj i fjalisë dhe merr shembuj nga libri.

Nxënësit ndahen në katër grupe.

**Grupi i parë kryen detyrën e parë;**

**Grupi i dytë kryen detyrën e dytë;**

**Grupi i tretë kryen detyrën e tretë;**

**Grupi i katërt kryen detyrën e katërt.**

Pasi të përfundojë koha e dhënë, një përfaqësues grupi lexon punën e bërë.

Mësimdhënësi vlerëson përgjigjet.

Nxënësit e tjerë plotësojnë aparatin pedagogjik me përgjigjet e sakta.

Kështu analizohen të gjitha detyrat e aparatit pedagogjik.

**Përforcimi:**

**Tabela e koncepteve**

Secili nxënës në fletore krijon tabelën me pesë ndarje.

Në të shkruajnë nga 2 shembuj për secilin lloj të fjalisë.

Secili nxënës në klasë lexon së paku një shembull që ka shkruar.

| F. dëftore | F. pyetëse | F. nxitëse | F. thirrmore | F. dëshirore |
|---|---|---|---|---|
| 1.<br>2. | 1.<br>2. | 1.<br>2. | 1.<br>2. | 1.<br>2. |

Informatë kthyese
Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Krijo pesë fjali për secilin lloj të fjalisë sipas kumtimit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Asnjë punë nuk vete dëm | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Asnjë punë nuk vete dëm** | |
| Fjalët kyçe: punë, përkushtim, shpërblim | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Parashikon se çfarë do të ndodhë në tregim<br>- Veçon pjesën e pëlqyer<br>- Krijon një strip për tregimin | Kriteret e suksesit:<br>- Lexo ilustrimet dhe provo të gjesh se çfarë do të ndodhë në tregim<br>- Ilustro pjesën e pëlqyer<br>- Krijo një strip për tregimin me katër ndarje |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletë A4, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Lexim i ilustrimit**

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që t'i hapin librat te mësimi **Asnjë punë nuk vete dëm** dhe të analizojnë ilustrimet.

Nxënësit provojnë të gjejnë se çfarë do të trajtojë ky tregim, kush është tema e tij.

Mësimdhënësi prezenton njësinë e re mësimore.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Ditari dypjesësh**

Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur tregimin dhe në fletoret e tyre krijojnë ditarin dypjesësh.

Në njërën anë të ditarit përshkruajnë pjesën e pëlqyer nga tregimi kurse në tjetrën ilustrojnë atë.

| Pjesa e pëlqyer | Ilustrimi |
|---|---|
| | |

Nxënësit ndahen në çift dhe njëri anëtarë i çiftit përgjigjet në pyetjet 1-3 të aparatit kurse tjetri në 4-6.

Nxënësit shkëmbejnë përgjigjet dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Përforcimi:**

**Strip**

Çifteve ju ofrohet nga një fletë e bardhë. Në të nxënësit e ndarë në dyshe krijojnë një strip për tregimin. Zgjedhin vet katër fjali që paraqesin:

*1 hyrjen e tregimit*

*2 zhvillimin e tregimit*

*3 zhvillimin e tregimit*

*4 fundin e tregimit*

Stripët vendosen në muret e klasës dhe nxënësit shëtisin e vlerësojnë me yje punimet e shokëve.

Punimi me më së shumti yje prezentohet para shokëve të klasës.




Vlerësim me yje

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Diskuto me prindërit dhe familjarët pse i shpëtoi gruri fshatarit. Sepse u erdhi keq pikave të shiut apo vërtet asnjë punë nuk shkon dëm? A është e vërtetë që asnjë punë nuk shkon dëm? Jep edhe mendimin tënd.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Prilli

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
**I.1. I.2. I.3. I.8.**
**II.5.**
**III.1. III.3. III.4. III.8.**
**V.5. V.8.**
**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :
**1. 1; 1. 2; 1. 4**
**2. 1; 2. 5; 2. 6.**
**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Prilli**

Fjalët kyçe: stinë, pranverë, gjelbërim

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:- | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| Numëron veçoritë e muajit prill<br>- Ilustron strofën e preferuar<br>- Krijon shkrim të shkurtër me fjalët kyçe<br>- ANalizon përmbajtjen e poezisë | - Numëro disa veçori të muajit prill<br>- Zgjedh e pastaj ilustro strofën e preferuar<br>- Përgjigju saktë në pyetjet që lidhen me përmbajtjen e poezisë<br>- Krijo një shkrim të shkurtër nga fjalët e dhëna |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja, fleta punuese, shkumësat me ngjyra

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Njeriu dhe natyra

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|

**Parashikimi:**

**Pyetja e ditës**

Mësimdhënësi shkruan në qendër të tabelës emrin: PRILLI.
Kërkon nga nxënësit që të numërojnë:
ndryshimet që sjell ky muaj;
cilës stinë i përket;
sa ditë zgjat;
çfarë ngjyra mbizotërojnë në këtë muaj;
a ka ndonjë festë në muajin prill;
kush e ka ditëlindjen në muajin prill, etj.
dhe krijohet një diagram.




**Ndërtimi i njohurive:**

**Tabela tripjesëshe**

Nxënësit lexojnë në heshtje poezinë Prilli dhe pasi të përfundojnë leximin, krijojnë tabelën tripjesëshe në fletore.

Në pjesën e parë e përshkruajnë strofën e pëlqyer.

Në pjesën e dytë e komentojnë se përse e kanë zgjedhur këtë strofë dhe në pjesën e tretë e ilustrojnë përmbajtjen e strofës.

| Strofa e pëlqyer: | Komenti: | Ilustrimi |
| --- | --- | --- |
| | | |

Nxënësit përgjigjen në mënyrë të pavarur në pyetjet 1 - 7 që lidhen me përmbajtjen e poezisë.

Mësimdhënësi parashtron pyetjet në formë të përmbledhjes dhe vlerësimit të punës së nxënësve.

**Përforcimi:**

**Shkrim i lirë**

Sipasdetyrëssëtetë, me fjalëte dhëna (të shkëputura nga vjersha që mësove) dhe fjalë të tjera që do të shtosh, krijo një tekst të shkurtër për stinën e pranverës.
*prilli, bari, fusha, era, zemra, qielli, gonxhe*
Shkrimi shkruhet nëfletën punuesee përgatitur nga mësimdhënësi dhe ekspozohen në murin e klasës.
Fleta punuese mund të duket kështu:

**Prilli**

Fjalët e dhëna: *prilli, bari, fusha, era, zemra, qielli, gonxhe*

________________________________________

________________________________________

________________________________________

________________________________________

________________________________________

________________________________________



Disa shkrime lexohen me zë të lartë.
Mësimdhënësi gjatë tërë kohës përcjell punën e nxënësve duke iu dhënë komente konstruktive lidhur me rrjedhën dhe drejtshkrimin.

| |
|---|
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Mundohen të mësojnë së paku dy strofa  të vjershës përmendësh. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **Obonato** | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1  I.2 I.3 I.6 I.8**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Njësia mësimore: **Obonato** | |
| Fjalët kyçe: mësim, humanizëm, obonato | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Flet për humanizmin e Shën Nënë Terezës<br>-Ilustron saktë pjesën e dhënë<br>- Shpjegon termin humanizëm<br>- Veçon informacionet sipas udhëzimeve | Kriteret e suksesit:<br>- Trego se ç'është humanizmi<br>- Thuaj së paku tri gjëra për Shën Nënë Terezën<br>- Ilustro fjalitë e dhëna me saktësi |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Shoqëria dhe mjedisi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**
**Pyetja e ditës**

Mësimdhënësi ua parashtron nxnësve pyetjen:
*A e keni dëgjuar ndonjëherë fjalën humanizëm?*

Nxënësit japin mendimet e tyre dhe mësimdhënësi shpjegon që humanizmi është ndjenjë e lartë e fisnike dhe dashuri e thellë ndaj njerëzve, kujdesi për mirëqenien e njerëzve, qëndrim njerëzor.

Tashmë nxënësit mund të kenë një tablo më të qartë se çfarë është humanizmi dhe rrjedhimisht pyetja e dytë e drejtuar shtrohet:
*Në sytë tuaj, kush është një njeri shumë human që mund ta njohim të gjithë?*
Mësimdhënësi shkruan në qendër të tabelës:

Shën Nënë Tereza

Dhe pyet nxënësit, a e dini se si lidhet figura e Shën Nënën Terezës me humanizmin?

Mësimdhënësi jep  më shumë infomacione për të.

**Ndërtimi i njohurive:**
**INSERT**

Mësimdhënësi lexon me zë të lartë vetëm një herë tregimin.

Ndalon aty ku udhëzon libri bazë dhe parashtron pyetjet e listuara.

Nxënësit ftohen që në mënyrë individuale të lexojnë tregimin dhe anash çdo fjalie që ju bën përshtypje ta veçojnë atë me: **tick** (nëse e kanë ditur atë informatë më herët), **+** (nëse është informatë e re), **-** (nëse është informatë që e kanë ditur ndryshe) dhe **?** te fjalia që do të donin të dinin më shumë për ty.

Mësimdhënësi kërkon nga disa nxënës që të lexojnë pyetjet e veçuara.

**Përforcimi:**
**Ilustrim i fjalive**
Meqenëse i gjithë mesazhi fantastik i tregimit bie në këto fjali, nxënësit udhëzohen që në fletoret e tyre të ilustrojnë fjalitë:

| |
|---|
| Kur ua bëri me shenjë fëmijëve që të fillonin garën, ata mbyllën duart fort dhe vrapuan së bashku. Pastaj të gjithë u ulën  pranë njëri-tjetri dhe bashkërisht shijuan frutat e shijshme. Antonio i habitur luti përkthyesin të pyeste fëmijët se pse vrapuan të gjithë së bashku, kur secili prej tyre mund të shijonte frutat për vete. Fëmijët iu përgjigjën: "Obonato." "Obonato", që në gjuhën e tyre do të thotë: "Unë ekzistoj, sepse ekzistojmë." |
|  |

Nxënësit vendosin fletoret në mes të grupit.

Secili anëtarë grupi i vëzhgon ilustrimet dhe vendos se cilit anëtarë të grupit do t'ia jap 5 yje për punën,

| |
|---|
| cilit 3 yje dhe cilit 1.<br><br>Nxënësit caktojnë kriteret e vlerësimit. |
| |
| Vlerësim me yje<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Hulumto për Shën Nënë Terezën e pastaj bëj një diagram Veni për Shën Nënë Terezën dhe Antonion.<br><br>Krijo në fletore tabelën e Insertit dhe informacionet e veçuara me tick, +, -, ? shkruaj në fletore. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Zbulo gjëegjëzën | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br><br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Zbulo gjëegjëzën** | |
| Fjalët kyçe: gjëegjëzë, zhvillim, imagjinatë, logjikë | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Gjen përgjigjet e gjëegjëzave<br><br>- Krahason pantomimën nga gjëegjëza<br><br>- Krijon gjëegjëza sipas detyrës | Kriteret e suksesit:<br><br>- Gjej se kë po përshkruan gjëegjëza<br><br>- Krahaso me dy elemente pantomimën dhe gjëegjëzën<br><br>- Krijo gjëegjëza për shtëpinë, qenin dhe lapsin |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libi bazë, fletorja | |

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi,

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Hamendësojmë**
Ftohen nxënësit me radhë te tabela.

Njërit i jepet një fjali për ta përshkruar pa fjalë e tjetrit i jepet një gjëegjëzë.

P.sh.

*Nxënësi 1:* Unë mezi u zgjova nga gjumi. (nxënësi e demostron këtë vetëm me lëvizje, pa fjalë) të tjerët hamendësojnë.
*Nxënësi 2:*Prapa derës qëndron, gjithë shtëpinë e pastron. (Nxënësi e thotë ndërsa të tjerët provojnë ta gjejnë).Përgjigja: **fshesa.**
*Nxënësi 3*: Unë i dua shumë picat. (nxënësi e demostron këtë vetëm me lëvizje, pa fjalë) të tjerët hamendësojnë

*Nxënësi 4:* Tretem shpejtë, bëhem shkumë, për higjienën kujdesem unë. (E thotë ndërsa të tjerët provojnë ta gjejnë). Përgjigja: **sapuni.**

...

**Ndërtimi i njohurive:**
**Informatë e drejtuar**
Mësimdhënësi krijon tabelën T dhe në të dallon: pantomimën nga gjëegjëza.

Kërkon nga nxënësit që të numërojnë disa veçori të njërës e disa veçori të tjetrës, nga ato që panë në fazën e parë të orës.
Mësimdhënësi e avancon informatën për gjëegjëza duke shtuar informacione të tjera për të.
Nxënësit ftohen të ndahen në çifte dhe të punojnë detyrën 1 dhe 2. Ata lexojnë secilën gjëegjëzë të dhënë në libër.

Pasi t'i analizojnë mirë, ata gjejnë përgjigje për gjëegjëzat dhe i komentojnë përgjigjet me anëtarët e grupit.

**Përforcimi:**
**Krijim i gjëegjëzave**
Nxënësit i ndërrojnë vendet dhe partnerët e çiftit.

| |
|---|
| Tash ata duhet të krijojnë gjëegjëza për: lapsin, shtëpinë dhe qenin, ashtu si udhëzon detyra tre e librit.<br>Pastaj detyra e katërt plotësohet individualisht.<br>Mësimdhënësi gjatë tërë kohës bën lëvizje në klasë për të vëzhguar dhe vlerësuar punën e nxënësve. |
| |
| Informatë kthyese<br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Hulumton dhe gjen edhe tri gjëegjëza interesante për fëmijë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Nuk je shumë i vogël për të bërë gjëra të mëdha! | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Nuk je shumë i vogël për të bërë gjëra të mëdha!** | |
| Fjalët kyçe: vizion, ngrohje globale, iniciativë, protestë | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Sqarojnë nocionin ngrohje globale<br>- Identifikon ndotësit e tokës<br>- Krijon një strip për Gretën<br>- Argumenton përgjigjet e tyre | Kriteret e suksesit:<br>- Trego se ç'është ngrohja globale?<br>- Numëro së paku tre ndotës të tokës<br>- Krijo një strip sipas udhëzimeve<br>- Argumento mendimin tënd |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, fletë A4 |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Njeriu dhe natyra |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |

**Parashikimi:**

**Kllaster**

Në qendër të tabelës shkruhet fjalia: **NGROHJE GLOBALE**.

Nxënësit ftohen që të përgjigjen në pyetjen: çfarë ju shkon në mendje kur dëgjoni këtë fjali.

Krijohet degëzimi me idetë e nxënësve.

Informacioni mund të grumbullohet dhe me pyetjet:

*Çfarë e shkakton ngrohjen globale?*

*A keni dëgjuar për pasojat e ngrohjes globale?*

*Kush shkakton më shumë ngrohje?*

*Po për Greta Thunberg keni dëgjuar?*




**Ndërtimi i njohurive:**

Mësimdhënësi lexon me zë tregimin dhe kërkon nga nxënësit që ta përcjellin.

Pas leximit të tregimit, mësimdhënësi jep informata më të hollësishme për kontributin e Gretës në çështjen e ngrohjes globale.
Për të kuptuar më qartë përmbajtjen, nxënësit përgjigjen në pyetjet e aparatit pedagogjik dhe plotësojnë atë bashkërisht me mësimdhënësin.

Nxënësit në fletë të bardhë A4 bëjnë një strip për Gretën.

Duke e ndarë fletën në katër pjesë,

*Në pjesën e parë*: Si mund të jetë zgjuar atë ditë Greta.

*Në pjesën e dytë:* Greta i mblodhi flokët e gjatë në dy gërsheta, veshi një triko blu, një këmishë të bukur dhe doli nga shtëpia ku banonte me prindërit.

*Në pjesën e tretë*: Greta mbante nën sqetull një  tabelë dërrase.

*Në pjesën e katërt*: Greta mban në dorë tabelën ku shkruan: **Grevë e shkollës për klimën.**




Nxënësit vendosin në murin e klasës punimin dhe në punimin që atyre u pëlqen më shumë vendosin një yll.

Zgjedhet punimi me më së shumti yje.

**Përforcimi:**
Rrjeti i diskutimit

Mësimdhënësi hap rrjetin e diskutimit me këtë pyetje:

**Po** | **A do ta përkrahje ti Gretën po ta kishe shoqe klase?** | **Jo**

Nxënësit që janë për po rreshton në anën e përgjigjes po dhe nxënësit që janë për jo rreshtohen në anën e përgjigjes jo.

Mësimdhënësi pyet veçmas secilin nxënës për argumetin që ata kanë për përgjigjen.

Informatë kthyese

Vlerësim me yje

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Bëj një fletushkë të shoqëruar me një vizatim dhe një mesazh për ngrohjen globale.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Fjalitë pohore dhe mohore

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
|---|---|

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1, III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**

**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**

**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Fjalitë pohore dhe mohore**

Fjalët kyçe: fjali, dëftore, pohore, mohore

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Dallon fjalitë pohore dhe mohore<br>- Numëron pjesëzat mohuese<br>- Shndërron fjalitë pohore në mohore dhe anasjelltas | - Gjej se cila është fjali pohore e cila mohore<br>- Trego se cilat pjesëza përdorim për të mohuar<br>- Kthe fjalitë pohore në mohore |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja, pe

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Diskutim për njohuritë paraprake**

Mësimdhënësi pyet nxënësit:

Cilat janë llojet e fjalive?

Po fjalitë dëftore si ndahen?

Shkruan në tabelë:
*Sot erdha me shumë qejf në shkollë.*
*Dje s'erdha me qejf në shkollë ngase po binte shi.*

Kërkon nga nxënësit të identifikojnë dallimin mes këtyre dy fjalive.

Prezentohet njësia e re mësimore.

Mësimdhënësi zgjeron fondin e njohurive duke i prezentuar edhe informatat shtesë për fjalitë.

**Ndërtimi i njohurive:**

**INSERT**

Nxënësit  në fletoren e tyre krijojnë tabelën insert.

| ✓ | + | - | ? |
|---|---|---|---|
| | | | |

Hapin librat dhe identifikojnë informatat që kanë ditur më parë, informatat e reja, informatat e ndryshme nga ato që dinin dhe pyetje për mësimdhënësin.

Plotësohet tabela në fletore.

Meqë nuk ka shumë informacion dhe rrjedhimisht mbetet kohë, nxënësit ndahen në grupe dhe grupi i parë ka për detyrë të mbarojë detyrën e parë, grupi i dytë detyrën e dytë, grupi i tretë detyrën e tretë dhe grupi i katër detyrën e katërt të aparatit pedagogjik.

Anëtarët e grupeve lexojnë përgjigjet kurse grupet tjera plotësojnë pasi mësimdhënësi vlerëson që përgjigja është e saktë.

**Përforcimi:**

**Rrjeti i merimangës**

Nxënësit bëhen rreth dhe mësimdhënësi e mban në dorë një tub peri.

Ai ia hedh tubën njërit nxënës kurse në njërin gisht e mban tëmbështjellur perin.

Mësimdhënësi i parashtron pyetjen nxënësit që ia hedh perin:

*Më thuaj një fjali mohore për vetën.*

Nxënësi përgjigjet, lidh gishtin për peri dhe tubën e perit ia hedh shokut tjetër të cilit ia bën një pyetje për fjalitë pohore dhe mohore.

Loja vazhdon kështu deri sa të gjithë fëmijët të kenë marrë fjalën dhe deri sa të gjithë të kemi krijuar rrjetën e merimangës.

Informatë kthyese

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Shkruaj pesë fjali pohore,të cilat pastaj shndërroji në fjali mohore.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Na lusin malet | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br><br>**3. 3; 3. 4;  3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: Na lusin malet | |
| Fjalët kyçe: lutje, kujdes, tokë, natyrë | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Plotëson fjalitë sipas udhëzimeve<br><br>- Organizon një aktivitet për Ditën e Tokës<br><br>- Klasifikon veprimet në të dëmshme dhe të dobishme | Kriteret e suksesit:<br><br>- Plotëso fjalinë e nisur nga shoku<br><br>- Klasiko veprimet që i bën ti në të mirë dhe dëm të tokës<br><br>- Kontribuo në aktivitetin për Ditën e Tokës |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Diskutim i ideve**
**Loja e autorit Agim Deva**
Njëri prej nxënësve do të thotë i pari një fjalë me qëllim që ta sajojmë një fjali apo periudhë mjedisore. P.sh. Le të jetë fjala e parë: qyteti... ose parku, si të doni.
Secili prej jush, fjalës së parë duhet t'ia shtojë nga një fjalë tjetër derisa fjalia të marrë një kuptim të rrumbullakuar. Këtë fjali shënoni në tabelë dhe diskutoni porosinë e saj.
Nëse ju pëlqen kjo fjali, mund ta shkruani nga tabela në librin tuaj.

**Ndërtimi i njohurive:**

Nxënësit lexojnë me vëmendje poezinë dhe udhëzohen të krijojnë një lidhje mendore mes këtij mësimi dhe mësimit Greta.
Pastaj, në fletoret e tyre krijojnë shpejt një tabelë dhe në të klasifikojnë nga 3 veprime që ata bëjnë në dobi të ruajtjes së tokës dhe tri veprime që bëjnë por e dëmtojnë tokën.



**Përforcimi:**

Nxënësit përgjigjen në pyetjet lidhur me poezinë 1 – 6.

Mësimdhënësi pyet nxënësit për përgjigjet.

| |
|---|
| Pasi të konfirmohet se poezia është kuptuar, mësimdhënësi kërkon vëmendjen e të gjithë nxënësve.<br><br>Nxënësit japin idetë e tyre mbi organizimin e aktivitetit që rekomandon libri bazë.<br><br>*Organizo me klasën një aktivitet pastrimi të ambientit të shkollës. Bëni edhe ndonjë projekt në grupe për Ditën e Tokës ose mbillni fidanë.*<br>Caktohet dita, ora, përgjegjësitë e fëmijëve, detyrat dhe mjetet që duhet t'i marrin nga shtëpia. |
| |
| Informatë kthyese<br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkruhen në fletore strofat e poezisë dhe ilustrohen. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

# MOS MË LINI VETËM

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
|---|---|

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **MOS MË LINI VETËM**

Fjalët kyçe: libri, dituria, mendja

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Përshkrun librin<br>- Krijon poezi për librin<br>- Analizon përmbajtjen e poezisë | - Gjej sa më shumë fjalë përshkruese për librin<br>-Analizo poezinë Mos më lini vetëm<br>- Shkruaj një poezi për librin |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

| |
|---|
| Libri bazë, fleta të vogla, fletorja, fletë e përgatitur |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |

**Parashikimi:**
**Konkurs**

Nxënësit e ndarë në grupe udhëzohen që në fleta të vogla të shkruajnë sa më shumë fjalë apo fjali me kuptim për librin. *(Mund të shkruhen dhe thënie apo gjëegjëza)*

Puna e nxënësve pasqyrohet në tabelë dhe nxënësit e përshkruajnë në fletoret e tyre.

Grupi me më së shumti fjalë, fjali, thënie apo gjëegjëza fiton pikët dhe anëtarët e atij grupi lexojnë me zë të lartë poezinë.

**Ndërtimi i njohurive:**
**punë e drejtuar**

Pasi të lexohet poezia, mësimdhënësi parashtron pyetjet me radhë të aparatit pedagogjik.

Nxënësit përgjigjen dhe nxënësit e tjerë i shkruajnë përgjigjet e sakta në libër.

Pasi të analizohet mirë poezia, mësimdhënësi jep më shumë informacionë për Ditën Botërore të Librit dhe bashkarisht me nxënësit organizojnë aktivitetin "**Të dhurosh një libër, ke dhuruar dije**." duke i ndarë aktivitetet, përgjegjësitë dhe detyrat për secilin anëtarë të klasës.

**Përforcimi:**
**Libri i klasës**
Mësimdhënësi udhëzon nxënësit që të dëgjojnë me vëmendje udhëzimet.
Do kthehet fleta A4 horizontalisht dhe në njërën anë të shkruhet vjersha dhe në tjetrën një ilustrim me titullin ***unë duke lexuar.***
*Kthehet fleta horizontalisht që kur të palosen dhe të kapen të dalë një libër i kompletuar.*

- Shkruani një vjershë për librin me bukurshkrim
- Redaktoni vjershat dhe kontrolloni gabimet drejtshkrimore.
- Ilustro vetën: Unë duke lexuar.
- Grumbulloni vjershat, lidhni ato në formë libri.
- Krijoni kopërtinen dhe titulloni librin tuaj të klasës.

Fleta mund të duket kështu:




Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Mësojnë më shumë për librin e parë në gjuhën shqipe.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| NËNA DHE VOGËLUSHJA | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **NËNA DHE VOGËLUSHJA** | |
| Fjalët kyçe: nëna, vogëlushja, ide, kreativitet, zgjidhje | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Përshkruan qytetin e tij me pak fjalë<br>- Diskuton me fjalët e zgjedhura për temën<br>- Krijon dialog në mes të personazheve | Kriteret e suksesit:<br>- Shkruaj shkrim të shpejtë për qytetin tënd<br>- Hamendëso se si mund të vazhdojë dialogu mes Anës dhe djalit në tren<br>- Diskuto mbi temën e hapur |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Shkrim i lirë 10 minutësh**
Mësimdhënësi ndan gjysmën e fletës A4 për secilin nxënës.

Secili nxënës shkruan shpejtë: Si duket qyteti im.

Lexohen disa shkrime.

Kujtohet që shkrimet përshkruese duhet të përmbajnë sa më shumë mbiemra që ta përçojnë më saktë atë që mendohet.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Lexo, Dëgjo, Analizo**

Pesë nxënës të zgjedhur nga mësimdhënësi lexojnë tregimin e ndarë në dy pjesë.

Diskutohen dhe plotësohen pyetjet 1 – 5 dhe nxënësit vazhdojnë punën në fletore.

Secili nxënës në fletoret e tij krijon në dialog me temën: Si vijoi biseda e Anës dhe djalit në tren?

*Ana:*

*Djali:*
*Ana:*

*Djali:*

**Përforcimi:**

**Rrjeti i diskutimit**

Mësimdhënësi hap për diskutim temën:

**A të ka ndodhur ndonjëherë edhe ty të gjesh zgjidhje për ndonjë problem në familje apo në shoqëri?**

| |
|---|
| Fëmijët diskutojnë përvojat e tyre gjithmonë duke pasur kujdes te gjuha standarde dhe rrjedhshmëria e informacionit.<br>Poashtu, nxënësit rekomandohen që:<br>T'i evitojnë fjalitë e panevojshme në përshkrim.<br>Të përdorin gjuhë të pastër dhe me sa më shumë përshkrime.<br>Të thonë vetëm të vërtetën dhe të mos tregojnë situata nëse nuk kanë dëshirë. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkrim imagjinar: Unë dhe nëna ime kemi një dyqan lulesh |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| SHENJAT E PIKËSIMIT | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br>**II.5.**<br>**III.1, III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 8.**<br>**2. 1; 2. 5; 2. 6; 2. 7**<br>**3. 2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.7; 3.8** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **SHENJAT E PIKËSIMIT** | |
| Fjalët kyçe: drejtshkrim, shenja të pikësimit, saktësi | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Plotëson me saktësi detyrat<br>- Kujton informatat për shenjat e pikësimit<br>- Klasifikon njohuritë | Kriteret e suksesit:<br>- Shkruaj çfarë di për shenjën e caktuar të pikësimit<br>- Ndaj njohuritë në ato që ke ditur, do të dish dhe që mësove nga ky mësim<br>- Plotëso detyrat e aparatit pedagogjik |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Punë në grup**
Mësimdhënësi jep nga një fletë tëbardhë për secilin grup.
**Grupit të parë ia shkruan? në mes të fletës.**

**Grupit të dytë ia shkruan. në mes të fletës.**

**Grupit të tretë ia shkruan ! në mes të fletës.**
**Grupit të katërt ia shkruan , në mes të fletës.**

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit që të shkruajnë për funksionin e këtyre shenjave në fjali dhe të japin sa më shumë shembuj për përdorimin e tyre brenda fjalisë.




Njëri nxënës prezenton punën e grupeve para klasës.

Mësimdhënësi me nxënësit tjerë gjykojnë se a janë të sakta apo të gabuara pohimet.
Mësimdhënësi prezenton temën dhe jep sqarime për shenjat e pikësimit dhe tregon se si lidhen ato me drejtshkrimin.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Di, Dua të di, Mësova**

Meqë në mësim trajtohen shumë shenja të pikësimit, nxënësit në fletoret e tyre krijojnë tabelën di, dua të di dhe mësova.
Mësimdhënësi udhëzon nxënësit që të punojnë vetëm me informacionin dhe të mos përgjigjen në detyrat e aparatit pedagogjik.
Informatat e veçuara shkruhen në fletore.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| | | |

**Përforcimi:**

**Të nxënit në bashkëpunim**

Nxënësit ndahen në çifte dhe plotësojnë detyrat e aparatit pedagogjik.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për kontributin e dhënë gjatë bashkëpunimit.

Informatë kthyese

Vlerësim i ndërsjellë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Shkruaj një tekst duke përdorur sa më shumë shenja të pikësimit

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Dy kopshtarë | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Dy kopshtarë** | |
| Fjalët kyçe: kopshtarë, shokë, xhelozi | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Flet për 1 Majin – Ditën e Punëtoreve<br><br>- Tregon për rëndësinë e punës në jetën e njerëzve<br><br>- Analizon detajisht personazhin e tregimit | Kriteret e suksesit:<br><br>- Fol për rëndësinë e punës në jetën e njerëzve<br><br>- Trego se përse shënjohet 1 Maji – Dita e Punëtorëve<br><br>- Analizo njërin personazh të tregimit |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br><br>**Pyetja e ditës?**<br><br>Mësimdhënësi pyet nxënësit:<br>*Në sytë tuaj, cila punë, prej atyre që bëjnë të rriturit, është më e vështirë dhe përse?*<br><br>*Vazhdohet diskutimi me pyetjet:*<br><br>*Pse punojnë njerëzit?*<br><br>*Çfarë vlerash duhet të ketë një njeri që punon?*<br><br>*Çfarë kushtesh në punë duhet t'i kenë punëtoret me patjetër?*<br><br>Mësimdhënësi sqaron se arsyeja pse i parashtroi këto pyetje është pikërisht festa e 1 Majit.<br><br>Mësimdhënësi tregon historikun e ngjarjës së madhe të 1 Majit.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>**Tryezë e rrumbullakët**<br>Tregimi ndahet në dy pjesë. Secili nxënës lexon me zë të lartë tregimin.<br><br>Mësimdhënësi pyet nxënësit: si u ndjetë për ndodhinë që i ndodhi Benit?<br><br>Nxënësit plotësojnë pyetjen e shtatë të librit.<br><br>Poashtu, kërkon mendime dhe për pyetjen e tetë të aparatit pedagogjik: Kush është porosia e tregimit?<br><br>Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë përgjigjet e tjera në aparatin pedagogjik.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>**Analizë e personazhit**<br><br>Secili nxënës në fletoren e tij vizaton njërin nga personazhet, qoftë Gencin qoftë Benin (sipas dëshirës). |

E ilustron si e paramendon të duket ai dhe përreth tij shkruan cilësi të tij, të identifikuara në tregim.



Nxënësit vullneratë lexojnë analizën e bërë.

Nxënësit shkruajnë për secilin personazh të zgjedhur nga një këshillë, qoftë për Gencin, qoftë për Benin.

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Mbledhin informacion nga gjyshërit për kultivimin e një kulture bujqësore.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# Gjërat më të forta në botë

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
| --- | --- |
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësiamësimore: **Gjërat më të forta në botë**

Fjalët kyçe: plaku, fjalë të mençura, dashuri, njeri

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
| --- | --- |
| - Përshkruan cilësitë e një plakut të mençur | - Përshkruaj cilësitë e një plaku të mençur |
| - Numëron gjëra që ata i konsiderojnë të forta | - Numëro tri gjëra që ti mendon se janë të forta |
| - Argumenton mendimet personale | - Argumento se pse mendon që gjërat e përmendura nga ti janë të forta |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Secilit nxënës i ofrohet ½ e fletës A4.

Në të nxënësit do të shkruajnë: Kush janë gjërat më të forta në tokë për të dhe përse? *(Nxënësit udhëzohen të shkruajnë jo vetëm për njerëz apo kafshë por edhe për dukuri natyrore, gjallesa, objekte, etj.)*

Secili nxënës shkruan tri gjërat më të forta dhe i rendit ato nga më e forta te më pak e forta.

Mësimdhënësi  pyet secilin nxënës për atë që ka shkruar në fletë.

Diskutohen të gjitha përgjigjet.

**Ndërtimi i njohurive:**

Teksti lexohet nga disa nxënës.

Në fund të leximeve mësimdhënësi rilexon pjesën ku plaku numëron gjërat e forta dhe parashtron pyetjen: A ju bëri të ndërroni mendjen plaku me listën e tij?

Nxënësit krahasojnë zgjedhjet e tyre me të plakut.

Secili nxënës në mënyrë të pavarur plotëson pyetet 1 – 6 të aparatit pedagogjik.

Mësimdhënësi vlerëson në vazhdimësi punën e nxënësve ndërkohë që ata punojnë.

Diskutohen përgjigjet e pyetjeve 1 – 6.

**Përforcimi:**

Meqë plaku si personazh kryesor cilësohet si plaku i mençur i fshatit, kërkohet nga nxënësit të shkruajnë se:
*Çfarë cilësish duhet të ketë një plak për t’u konsideruar si plak i mençur?*

| |
|---|
| *Çfarë e ka bërë atë të mençur?*<br>*Si mendoni që komunikojnë pleqtë e tillë?*<br><br>*Çfarë toni të zërit kanë?*<br><br>*Si duket fizikisht?*<br><br>Këto janë disa prej pyetjeve që i ndihmojnë nxënësit të krijojnë shkrimin e tyre.<br><br>Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që këto shkrime t'i lexojnë para prindërve të tyre dhe ata të vlerësojnë për saktësinë e shkrimit të nxënësve. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Plotësohet në mënyrë të pavarur detyra 7 dhe 8 e aparatit pedagogjik. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Enard

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**
**II.5.**
**III.1. III.3. III.4.III.8.**
**V.5. V.8.**
**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**
**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**
**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Enard**

Fjalët kyçe: mësues, nxënës, i zellshëm, punëtor

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Flet për profesionin e ëndrrave<br>- Bashkëpunon me grupin për të gjetur përgjigjet e sakta<br>- Përmbledh gjithë ngjarjen me disa fjali të renditura drejt | - Trego se çfarë dëshiron të bëhesh kur të rritesh<br>- Listo disa fjali që e përmbledhin ngjarjen e tregimit Enardi<br>- Bashkëpuno me grupin për të kryer detyrën e dhënë |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Shkrimi i lirë**

Secili nxënës në fletoren e tij shkruan një shkrim të shpejtë me titullin: **Kur të rritem dua të bëhem.**

Para klasës e tregon vetëm profesionin që dëshiron të bëhet dhe dy arsyet pse e pëlqen atë profesion.

Mësimdhënësi mbledh fletoret dhe i kontrollon dhe vlerëson shkrimet për: drejtshkrimin, bukurshkrimin, pedantërinë dhe qartësinë e shkrimit.

**Ndërtimi i njohurive:**
**DRTA**
Secili nxënës lexon në heshtje tregimin dhe mësimdhënësi udhëzon që, pas leximit të tregimit, secili nxënëns duhet të përmbledh gjithë rrugëtimin e Enardit me nga një fjali.
*(Pra, si filloi, si vazhdoi dhe si përfundoi rrugëtimi i tij drejt arritjes së ëndrrës).*

Për t'u paraqitur më saktë, nxënësve ju ofrohet një fletë punuese e ngjajshme ose mund të krijojnë këtë model në fletoret e tyre.
P.sh.

*1. Enardi ishte një djalë shembullor kudo: në shkollë e jashtë saj.*
*2. Enardi dëgjonte me kujdes dhe i vlerësonte lart këshillat dhe mësimet që merrte nga mësuesit e tij.*



| |
|---|
| **Përforcimi:**<br>**Punë në grupe**<br><br>Nxënësit ndahen në 3 grupe.<br><br>Grupi i parë i analizon dhe përgjigjen në tri pyetjet e para të aparatit pedagogjik.<br><br>Grupi i dytë i analizon dhe përgjigjen në pyetjet 4 – 6 të aparatit pedagogjik.<br><br>Grupi i tretë i analizon dhe përgjigjen në pyetjet 7 – 10 të aparatit pedagogjik.<br><br>Secili nxënës i grupit lexon nga një përgjigje dhe anëtarët e tjerë të klasës e plotësojnë aparatin pasi mësimdhënësi të konfirmoj që përgjigja është e saktë. |
| |
| Informatë kthyese |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Duke u bazuar në porosinë e tregimit në fund të tij, shkruaj një ese të shkurtër me bukurshkrim. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| ORKIDEA | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezulltati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **ORKIDEA** | |
| Fjalët kyçe: Vlerë, vlerë, lule, orkidea | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Ilustron një pjesë të tregimit<br>- Përgjigjen në pyetjet e tregimit<br>- Përshkruajnë lulet<br>- Numëron disa lule | Kriteret e suksesit:<br>-Trego se në çfarë të shkon mendja kur dëgjon emrin lule<br>- Përgjigju saktë në pyetjet e tregimit<br>- Ilustro në fletore njërën pjesë të ngjarjes |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, kubi, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Artet

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Mësimdhënësi shkruan në qendër të tabelës fjalën: Lule.

Kërkon nga nxënësit të japin mendimet e tyre lidhur me lulet.

Nxënësit udhëzohen të japin dhe informacione lidhur me kujdesin që duhet të kemi për lulet, rëndësinë e tyre në natyrë dhe në jetën e njerëzve si dhe të numërojnë sa më shumë emra lulesh.

Të gjitha informatat shkruhen në tabelë dhe të njëjtën e bëjnë nxënësit në fletoret e tyre.

Mësimdhënësi shkruan me bukurshkrim dhe ilustron sa më shumë lloje lulesh me shkumësat me ngjyra.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Kubimi**

Tregimin Orkidea e lexojnë disa nxënës me zë të lartë.

Për të analizuar detajisht përmbajtjen e tregimit, secilit grup i ofrohet një kub që përmban gjashtë pyetje.

Secili nxënës hedh kubin dhe përgjigjet në pyetjen e rënë.

Nxënësit shënojnë 3 nga gjashtë pyetjet dhe përgjigjet në fletoret e tyre.




**Përforcimi:**
**Ilustrim i ngjarjes së lexuar**

Nxënësit ilustrojnë njërën nga ndodhitë e ngjarjes së tregimit Orkideja në fletoret e tyre dhe lart shkruajnë titullin.

Poshtë titullit shkruhet pjesa e përzgjedhur për ilustrim.

Pasi të mbarojnë ilustrimet, nxënësit në çift përgjigjen në pyetjen 3 dhe 4 në librin bazë.

Informatë kthyese

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Krijohen fjalitë në librin bazë, sipas shembullit të autorit.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| **Fluturimi i parë** | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1  I.2 I.3 I.6 I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore:  **Fluturimi i parë** | |
| Fjalët kyçe: fluturim, shqiponja, kujdes, prindërit | |
| Rezultati/et e  të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Numëron së paku tri cilësi të shqiponjës<br><br>- Thellohet në analizë të tregimit<br><br>- Krahason prindërit e vet me prindërit e<br><br>shqiponjës së vogël | Kriteret e suksesit:<br><br>- Përmend së paku tri cilësi të shqiponjës<br><br>- Parashiko se çfarë do të ndodh me ngjarjen e<br><br>tregimit<br><br>- Gjej përgjigjet e sakta për tregimin<br><br>- Plotëso diagramin e Venit me përkushtim |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja | |

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Pemë e mendimeve**

Mësimdhënësi shkruan në mes të grafikut emrin: Shqiponja.

Meqenëse është dhe simbol kombëtar, atëherë i kushtohet një vëmendje e veçantë cilësive të shqiponjës.

Mësimdhënësi siguron sa më shumë informacion për shqiponjën, si:
*Shqiponjat janë zogj grabitqarë të mëdhenj, të fuqishëm.*

*Shqiponjat kanë sqep të madh dhe si grep..*

*Shqiponjat kanë shikim të shkëlqyeshëm.*

*Shqiponjat kanë talonë të fuqishëm të cilët i ndihmojnë ata të kapin prenë.*

*Shqiponjat i ndërtojnë foletë e tyre në shkëmbinjtë e lartë ose në pemët e larta.*

*Ka mbi 60 lloje të ndryshme të shqiponjës.*

**Ndërtimi i njohurive:**

**Tabela e parashikimeve**

Nxënësit udhëzohen që në fletoret e tyre të krijojnë tabelën e parashikimit.

Mësimdhënësi ndan pjesën e leximit në 3 pjesë, momentet kur tregimi merr kthesë në ngjarje.

Pas çdo ndalese, nxënësit plotësojnë tabelën në pjesën e parë dhe të dytë, pjesa e tretë plotësohet në fund të leximit të komplet mësimit.

| Ndalesa | Çfarë mendoni se do të ndodhë? | Çfarë provash keni? | Çfarë ndodhi? |
|---|---|---|---|
| Pjesa I | | | |
| Pjesa II | | | |
| Pjesa III | | | |

Bashkarisht me mësimdhënësin gjenden përgjigjet për pyetjet 1 – 7 të librit bazë.

**Përforcimi:**

**Diagram i Venit**

Plotësohet me kujdes detyra e tetë e librit bazë e cila kërkon që nxënësit të krahasojnë prindërit e shqiponjës së vogël me prindërit e tyre.

Natyrisht që nxënënsit udhëzohen të shkruajnë sa më shumë cilësi të prindërve të tyre.

Disa nga diagramet lexohen në klasë kurse vlerësimin e tyre e bëjnë prindërit në shtëpi.

Nxënësit duhet ta lexojnë para prindërve krahasimine bërë.

Prindërit lënë një koment dhe vlerësim për punën e fëmijëve të tyre.




| |
|---|
| Informatë kthyese |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkruajnë ese: Nëse do të ishe në një qilim fluturues të përrallave, çfarë do të doje të shikoje nga lart? |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Intervista | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Intervista** | |
| Fjalët kyçe: intervistë, pyetje, përgjigje, bashkëbisedim | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Dallon intervistën nga format e tjera të komunikimit<br><br>- Numëron elementet e intervistës<br><br>- Krijon pyetje për një intervistë | Kriteret e suksesit:<br><br>- Numëro tri elemente të veçanta të intervistës<br><br>- Krijo pyetje për palën që do të intervistosh |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Mësimdhënësi parapërgatit disa pyetje lidhur me një çështje të caktuar për nxënësin.

Fton njërin nxënës që të vie dhe të ulet përballë tij.

Mësimdhënësi parapërgatit një mikrofon me materiale ricikluese dhe ia drejton nxënësit.

Pyetjet mund të jenë:

*1. Kush është hobi yt?*

*2. Sa herë në javë e praktikon këtë hobi?*

*3. Çfarë të pëlqen më shumë për të?*

*4. Që sa kohë e praktikon?*
*5. A do e rekomandoje për bashkëmoshatarët këtë hobi?*
*6. Çfarë do të doje që prindërit e tu të kontribuonin lidhur me këtë çështje?*

Pasi të mbarojë intervista, mësimdhënësi parashtron pyetjet:

*A keni parë ndonjëherë kësi forme komunikimi; si quhet?*

Çfarë ju pëlqen më shumë tek intervista?

Kë do të donit ta intervistonit në këto momente?

Për cilën temë do t'i parashtronit pyetje?

**Ndërtimi i njohurive:**

**INSERT**

Secili nxënës punon individualisht në fletoren e tij.

Nxënësit krijojnë tabelën e insertit në fletore dhe duke lexuar informacionet në librin bazë e plotësojnë tabelën, duke shënuar informacionet që i kanë ditur më parë; duke i shkruar informacionet e reja të mësuara në këtë orë; informacionet që i dinin ndryshe nga ato të librit dhe pyetjet që mund të kenë lidhur me intervistat.

|  | + | - | ? |
|---|---|---|---|
| | | | |

**Përforcimi:**

**Punë në grupe**

Duke u bazuar në informacionet e marra në fazën e dytë të orës dhe nga intervista e lexuar, provoni të bëni një intervistë në klasë.
Intervista të bëhet në grupe, duke ndarë rolet brenda grupit.
Intervista bëhet duke intervistuar apo duke u vënë në pozitat e njerëzve të njohur të sferave të ndryshme, si: udhëheqës institucionesh, shkrimtarë, sportistë, këngëtarë, artistë etj.

Grupet dalin te tabela për të zhvilluar intervistën.

Mësimdhënësi vlerëson për:

a) Zgjedhjen e temës
b) Lidhshmërinë e pyetjeve me temën

c) Qëndrimin para bashkëbiseduesve

d) Artikulimin e përgjigjeve
e) Gjuhën e përdorur

| |
|---|
| Vlerësim me notë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Krijon një mikrofon me materiale që i ka në shtëpi dhe shkruan dhjetë pyetje për një person të njohur (apo jo) që do të doje ta intervistoje. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| FILMI | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **FILMI** | |
| Fjalët kyçe: Filmi, skenar, regji, montazh, muzikë, rol | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Përshkruan filmin e preferuar<br><br>- Numëron elementet e rëndësishme për krijimin e një filmi<br><br>- Zhvillon një intervistë | Kriteret e suksesit:<br><br>- Përshkruaj me pak fjalë filmin e preferuar<br><br>- Trego për konceptet që lidhin me filmin<br><br>-Parashtro pyetjet për një intervistë<br><br>- Përgjigju në pyetjet që të parashtrohen |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, burime interneti, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Diskutim**

Mësimdhënësi parashtron pyetjen: **Cili është filmi juaj i preferuar?**

*Pyetjet ndihmëse për diskutim mund të jenë:*

Çfarë ju pëlqen te ai film?

Në cilën pjesë të ditës keni dëshirë të shikoni filma?

A ju pëlqen të shikoni filma në televizor apo në pajisjet tjera teknologjike?

A keni qenë ndonjëherë në kinema?

Nxënësve ju lëshohet një video në youtube lidhur me historikun e filmit:

https://www.youtube.com/watch?v=UQOOhSs_0ag

Mësimdhënësi paraqet njësinë e re mësimore.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Harta e koncepteve**

Mësimdhënësi ndërton një hartë konceptesh në tabelë dhe plotëson ato me informatat e nevojshme që lidhen me filmin.




Nxënësit e përshkruajnë hartën e koncepteve në fletoret e tyre.

Mësimdhënësi ndalet te filmi “Shok” sqaron në pika të shkurtra temën e ndjeshme të filmit dhe bujën e madhe që bëri.

Komentohen detajisht elementet e paraqitura në libër.

**Përforcimi:**

**Punë në çift**

Nxënësit ndahen në dyshe.

Sot me vete duhet të kenë mikrofonët e përgatitur në shtëpi me materiale ricikluese (detyra e shtëpisë e dhënë te njësia: *Intervista*)

Nxënësit ndajnë rolen. Njëri bëhet gazetar, tjetri e përcakton se cili personalitet i rëndësishëm-sportist, aktor, këngëtar, shkrimtar etj. dëshiron të bëhet.

Nxënësit caktojnë temën dhe ndërtojnë bashkërisht pyetjet mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

Nxënësit dalin me rend te tabela për të zhvilluar intervisten.

Mësimdhënësi vlerëson nxënësit për:

*Pyetjet dhe përgjigjet*
*Qëndrimin/Gjuhën e trupit*

Informatë kthyese

Vlerësim me notë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

*Pyet prindërit dhe njerëzit e tjerë të familjes për ngjarjen e filmit “Shok” dhe diskuto me ta për zhandrin e filmave të preferuar.*

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# PROJEKT I NXËNËSVE PËR DIELLIN, YJET DHE HËNËN

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **PROJEKT I NXËNËSVE PËR DIELLIN, YJET DHE HËNËN**

Fjalët kyçe: projekt, galaktikë, trupa qiellorë

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| - Dallon informacionin e saktë nga i pasakti<br>- Grumbullon informata për trupat e mësuar<br>- Krahason yllin në poezi dhe yllin në këtë njësi mësimore | - Ngrit fletën e kuqe për informacionin e gabuar dhe të gjelbrën për informacionin e saktë<br>- Plotëso tabelën tripjesëshe me informatat për trupat e mësuar<br>- Krahaso yllin e poezisë së Kristofordhit dhe me yllin e njësisë së sotme |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri bazë, fletorja, letra të vogla të kuqe dhe të gjelbra

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**E saktë/gabim**
Mësimdhënësi shkruan disa pohime në tabelë. Pas çdo pohimi që ai lexon, nxënësit ngrejnë lartë kartën e kuqe, nëse mendojnë që pohimi është i gabuar ose kartën e gjelbër nëse mendojnë që pohimi është i saktë.

*Hëna është yll.*

*Burim i pashtershëm i energjisë për tokën është Dielli.*

*Hëna është trup me dritë.*

*Në qiell ka miliona yje.*

*Hëna është i vetmi satelit natyror i Tokës.*

*Në sistemin diellor ka dhe hëna të tjera.*

*Dielli është yll.*

*Njeriu i parë ne Hënë ishte Neil Amstrong.*

Pas çdo vlerësimi nga nxënësit, mësimdhnënësi tregon përgjigjen e saktë dhe jep më shumë informacion për trupat qiellorë.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Tabela tri pjesëshe**

Nxënësit në fletoret e tyre krijojnë tabelën tripjesëshe dhe në të shkruajnë për tri konceptet që do të trajtohen sot, Dielli, Hëna dhe yjet.

Fillimisht shkruajnë se çfarë mësuan nga pjesa e parë e orës e pastaj hapin librat dhe plotësojnë me informata të tjera.

|  |  |  |
|---|---|---|
| | | |

Plotësohen hapësirat poshtë secilit shkrim në librin bazë në bashkëpunim me mësimdhënësin.

**Përforcimi:**

**Diagram i Venit**

Ashtu si udhëzon libri bazë, nxënësit krahasojnëtekstin Ylli me vjershën e K.Kristoforidhit “Ylli i vogël lart në qiell”.

Krahasimin e paraqesin në Diagramin e Venit në librin bazë.




Mësimdhënësi dëgjon duke prezentuar punën së paku 3 nxënës dhe vlerëson ata për elementet e gjetura.

Informatë kthyese

| |
|---|
| Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkruaj një ese me temën: "Një ditë në gjithësi<br>Tabela tripjesëshe e krijuar nga nxënësit në klasë, pasurohet me informata shtesë të hulumtuara në internet. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Krahët e këngës

| | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Njësia mësimore: **Krahët e këngës** | |
| Fjalët kyçe: këngë, melodi, harmoni | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Ilustron saktësisht vargjet<br>- Këndon këngën e mësuar<br>- Titullon këngët me temë të caktuar | Kriteret e suksesit:<br>- Këndo këngën e caktuar<br>- Ilustro vargjet e poezisë<br>- Cakto një titull për temat e caktuara të këngëve |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi, Artet | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

**Këndojmë këngën e mësuar**

Secilit grup i ndahet nga një këngë, nga këngët e mësuara në lëndën e Edukatës muzikore dhe ata këndojnë me radhë.

Në fund, mësimdhënësi kujton se kënga e fundit e mësuar në lëndën e Edukatës Muzikore është ____________________ dhe fton nxënësit që ta këndojnë të gjithë së bashku.

Mesimdhënësi hap diskutimin për muzikën.

**Ndërtimi i njohurive:**

**Ilustrim i vargjeve**

Nxënësit lexojnë në heshtje poezinë dhe kërkohet nga ta që të shkruajnë poezinë në fletore.

Secili nxënës anash strofës vizaton se si i paramendon ato vargje.

*Ja, p.sh.*

Viziton edhe punëtorin
Që punës ia di vlerën



Nxënësit ndahen në dyshe dhe përgjigjen në pyetjet e aparatit duke i ndarë pyetjet e pastaj duke i shkëmbyer përgjigjet.

Mësimdhënësi përcjell dhe vlerëson punë e nxënësve gjatë tërë kohës.

**Përforcimi:**

Nxënësit në mënyrë të pavarur plotësojnë detyrën e tretë dhe të katërt të librit bazë.
Zgjidh titujt e këngëve për:

| Atdheun | Prindërit | Miqësinë | Dashurinë | Planetin -Tokë |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

**Poashtu nxënësit mund të shtojnë dhe:**

Cili këngëtar/e do të doje që ta këndonte secilën këngë?
Shkruaj emrin e këngëtarit poshtë titullit të këngës.

Secili nxëëns lexon së paku dy prej titujve dhe emrave të këngëtarit.

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

| |
|---|
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Hulumto për: Nexhmije Pagarushën, Vaçe Zelën, Ramë Lahaj |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| | |
|---|---|
| **LIBRI** | |
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **LIBRI** | |
| Fjalët kyçe: Lektyrë, lexim, analizë, komentim | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>- Ritregon ngjarjen duke u përgjigjur në pyetjet<br>- Shkruan artikull për librin<br>- Vlerëson librin e lexuar | Kriteret e suksesit:<br>- Ritrego ngjarjen kryesore të tregimit duke u përgjigjur në pyetje<br>- Mendo sikur je gazetarë dhe shkruaj artikull për librin |

| | |
|---|---|
| | e lexuar<br><br>- Vlerëso me yje librin e lexuar |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Libri bazë, fleta punuese, libri i lexuar | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |
| **Parashikimi:**<br><br>**Pyetja e ditës:**<br><br>Mësimdhënësi parashtron pyetjen:<br><br>Cilin libër keni lexuar në këtë muaj dhe nga 1 në 5 me sa yje e vlerësoni atë?<br>Secili nxënës jep përgjigje në pyetjet e parashtruara.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>Mësimdhënësi fton nxënësit që të analizojnë librin duke u përgjigjur shkurtë e qartë në pyetjet e dhëna.<br><br>Secilit nxënës i ofrohet nga një fletë punuese e gatshme.<br><br>Në të nxënësit përmbedhin gjithë ngjarjen kryesore të librit duke u përgjigjur në pyetjet e dhëna.<br><br>Punimet vendosen në murin e klasës pasi të lexohen disa prej tyre.<br><br>Në rast se ndonjë nxënës ka lexuar ndonjë enciklopedi apo ngjajshëm, mund t'i parashtroj pyetjet vet dhe të përgjigjet në to.<br><br>Në fletën punuese mund të lihen të zbrazëta hapësirat e pyetjeve dhe pyetjet të shkuhen në tabelë e nxënësit t'i modifikojnë sipas nevojës. | |




**Përforcimi:**

**Punë e pavarur**

**Mësimdhënësi jep sqarimet:**

Mendo se je gazetar.
Shkruaj një artikull të shkurtër për ngjarjen më interesante të librit.
Që shkrimi yt të jetë më interesant, bazohu në pyetjet e mëposhtme:

- Kush?
- Çka?
- Kur?
- Ku?
- Pse?

Titulloje artikullin.
Artikulli shkruhet në librin bazë.
Mësimdhënësi vlerëson nxënësit me informatë kthyese duke dhënë komente konstruktive.

| |
|---|
| |
| Informatë kthyese |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Shkruaj dhjetë fjali që përmbledhin ngjarjen e librit të lexuar. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Një qershori

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Njësia mësimore: **Një qershori** | |
| Fjalët kyçe: 1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Fëmijëve, të drejta, lumturi, botës. | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Lexon rrjedhshëm poezinë<br><br>- Komenton vargjet e poezisë<br><br>- Veçon vargjet më të pëlqyera<br><br>- Krijon dy strofa kushtuar ditës së fëmijëve / ose 1 Qershorit | Kriteret e suksesit:<br><br>-Lexo poezinë<br><br>- Veço vargjet e preferuara<br><br>- Krijo dy strofa për Ditën e Fëmijëve |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, fletë e bardhë A/4 | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Artet | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Mësuesi/ja paraqet para nxënësve disa foto tëndryshme, ku pjesë e tyre janë grupe të ndryshme të fëmijëve të buzëqeshur, të gëzuar, si dhe të ngjyrosur në fytyrë duke simbolizuar festën e fëmijëve

1 Qershori. Nxënësit në mënyrë individuale komentojnë fotografitë e paraqitura para tyre.

**Ndërtimi i njohurive:**

Nxënësve u shpërndahet nga një fletë e bardhë A/4, ku në fletën e dhënë janë shkruar disa fjalë kyçe që janë të ndërlidhura me poezinë. Me fjalët e dhëna, nxënësit do të krijojnë vargje të ndryshme sipas imagjinatës së tyre.

*1 Qershori, fëmijët, buzëqeshje, festojnë, qetësi, përkëdhelje, ngrohtësi, botë, prindërit.*

Vargjet e krijuara nga nxënësit lexohen para grupit të klasës.

| |
|---|
| Nxënësit hapin librin dhe lexojnë poezinë “Një qershori”. Diskutohet fjalori i xhepit, duke kuptuar fjalët e reja. Pas leximit të poezisë nga 2 deri në 4 nxënës, mësuesi/ja u drejtohet me këto pyetje:<br>- *Cilës ditë i kushtohet kjo vjershë?*<br>- *Çfarë ndien fëmijët në këtë ditë?*<br>- *Si duket qyteti më 1 Qershor, kur të gjithë fëmijët dalin të festojnë?*<br>- *Cila është dëshira e fëmijëve?*<br>Pas diskutimit të pyetjeve, në fletore nxënësit duhet të shkruajnë strofën më të pëlqyer dhe ta komentojnë atë.<br>**Përforcimi:**<br>Secili nxënës krijon një poezi / vjershë të shkurtër deri në dy strofa për festën e fëmijëve “ 1 Qershorin”.<br>Krijimet e nxënësve vendosën në murin e klasës. |
| |
| Informatë kthyese<br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Plotësohet aparati pedagogjik në librin bazë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Kush jemi ne?! | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1. I.2.I.3.I.5I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3 III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 6**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6**<br><br>**3. 3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Kush jemi ne?!** | |
| Fjalët kyçe: Dita Ndërkombëtare e fëmijëve, të drejta, përgjegjësi, dëshira | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>- Lexon fjalitë duke respektuar rolin e secilit personazh<br><br>- Shkruan dy të drejta, përgjegjësi, dëshira | Kriteret e suksesit:<br><br>- Shpeh mendimin tënd për fjalitë e paraqitura nga mësimdhënësi<br>- Lexo rolin tënd në tekstin e dhënë<br>- Shkruaj dy të drejta, përgjegjësi, dëshira |

| | |
|---|---|
| -Analizon fjalitë e paraqitura nga<br><br>mësimdhënësi | |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja, shkopinj druri, fleta të bardha, ngjitës letre

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, Artet

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Kubimi**

Fillimisht mësimdhënësi paraqet para nxënësve një kub ku janë të shkruara dy fjali që paraqesin të drejtat e fëmijëve, dy fjali që paraqesin përgjegjësi të fëmijëve dhe dy fjali që paraqesin dy dëshira të fëmijëve. Shiko shembujt më poshtë:

- Unë kam të drejtën e lirisë së shprehjes;
- Unë kam të drejtë të marrë kujdes shëndetësor kur nuk ndihem mirë;
- Unë kam përgjegjësi të mësoj;
- Unë kam përgjegjësi të mbaj higjienën personale;
- Unë kam dëshirë të kem një biçikletë;
- Unë kam dëshirë të vizitoj Anglinë;

Një nxënës hedh kubin, nxënësi tjetër lexon fjalinë dhe të dy së bashku shpjegojnë para klasës se si i kuptojnë këto fjali. Loja vazhdon derisa të lexohen të gjitha fjalitë dhe të bëhet analiza e tyre.

Më pas, mësimdhënësi i pyet nxënësit për dallimin në mes te drejtave, përgjegjësive dhe dëshirave të fëmijëve.

Njëherit diskutojnë dhe për Konventën e të Drejtave të fëmijës dhe Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve.

Në fund, secilit nxënës i jep nga një shkop druri dhe fletë të bardhë. Nxënësit duhet të vizatojnë vetën e tyre dhe të ngjesin në shkopin e drurit.

Mësimdhënësi u bënë me dije që ashtu si punimet e tyre që duken ndryshe nga njëri – tjetri edhe të drejtat e përgjegjësitë duhet të respektohen për secilin fëmijë edhe pse janë të ndryshëm.

**Ndërtimi i njohurive:**
**Lexim me role**

Mësimdhënësi ndan rolet për secilin nxënës dhe varësisht nga numri i nxënësve në klasë cakton edhe

grupet.

Secili nxënës duke lexuar pjesën e caktuar nga mësimdhënësi paraqet edhe shkopin të cilin e ka vizatuar paraprakisht.

Gjatë leximit të roleve nxënësve fillimisht u jepen këshilla nga mësimdhënësi që fjalitë të lexohen me intonacionin e duhur varesisht nga përmbajtja e fjalisë.

**Përforcimi:**

Pas diskutimit të pjesës së lexuar me role, nxënësit në fletorë paraqesin një tabelë të ndarë në tri pjesë ku duhet të shkruajnë 2 të drejta, 2 përgjegjësi dhe 2 dëshira.

| Të drejtat e mia | Përgjegjësitë e mia | Dëshirat e mia |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

Dy yje një dëshirë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Sipas mundësive nxënësit të hulumtojnë në internet për Konventën e të Drejtave të fëmijëve ose të bisedojnë me një anëtar të familjës për të drejta e fëmijëve.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| Ty të dua si shok | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br><br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Ty të dua si shok** | |
| Fjalët kyçe: shok, det, valë, gjymtyrët, kaltërsi, qetësi | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Lexon poezinë për të kuptuar vargjet<br><br>-Tregon përvoja të ngjashme nga jeta e përditshme<br><br>-Dallon strofat, vargjet dhe fjalët rimuese në poezi | Kriteret e suksesit:<br><br>-Lexo poezinë për të kuptuar vargjet<br><br>-Trego përvoja të ngjashme nga jeta e përditshme<br><br>-Dallon strofat, vargjet dhe fjalët rimuese në poezi<br><br>-Analizo vargjet e poezisë |

| | |
|---|---|
| -Analizon vargjet e poezisë | |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletorja

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës, artet

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
Parashikimi nëpërmjet ilustrimeve
Mësuesi/ja i fton nxënësit që të shohin ilustrimet në tekst.

- *Çfarë shihni në figurat e dhëna.*
- *Cilës stinë i takojnë këto ilustrime?*
- *Cilat vende janë paraqitur në poezi?*
-

**Ndërtimi i njohurive:**
Dora e fshehtë (Punë në grupe)

Nxënësit ndahen në tri grupe. Secilit grup i ndahet nga një strofë e poezisë me vargje të përziera dhe kërkohet nga nxënësit që t'i sistemojnë vargjet në mënyrë të saktë. Nxënësit duhet të jenë të vëmëndshëm që të përzgjedhin në fillim fjalët që rimojnë më së shumti me njëra - tjetrën. Nxënësit pas përfundimit të detyrës, lexohen nga çdo nxënës vargjet e kombinuara dhe bëhet krahasimi me poezinë në tekst.

Lexohet poezia dhe diskutohet fjalori i xhepit.

**Përforcimi:**

Nxënësit duhet të dallojnë numrin e strofave dhe vargjet e poezisë.

Nxënësit në fletoret e tyre e shkruajnë dhe ilustrojnë strofën e pëlqyer.

Informatë kthyese

Vlerësim me figura

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
|---|
| Ushtrime leximi dhe nxerrje e mesazhit të poezisë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **Kokrra e grurit ecte** |
|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV |
| **Tema**: \| **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3.VI.3.** |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Njësia mësimore: **Kokrra e grurit ecte** |

| Fjalët kyçe: fabula, kafshët, gjinkalla, milingona | |
|---|---|
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Përshkruan personazhet e fabulave\<br><br>-Analizon veprimet e personazheve kryesor<br><br>-Analizon veçoritë gramatikore të një emri të zgjedhur nga teksti në librin bazë<br><br>-Krijon një fabul sipas dëshirës | Kriteret e suksesit:<br><br>-Përshkruaj veprimet e personazheve të fabulave<br><br>-Trego veprimet e personazheve kryesor<br><br>-Krijo një fabul sipas dëshirës<br><br>-Analizo veçoritë gramatikore të një emritë zgjedhur nga teksti në librin bazë |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja, fletë A4 me ilustrimin e gjinkallës dhe milingonës | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhë dhe komunikim, Artet | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**

Mësimdhënësi paraqet para klasës një ilustrim në një fletë A4 ose hamer me milingonën dhe gjinkallën.



Nxënësve u kërkohet të japin mendime se çfarë dinë për milingonën dhe gjinkallën.

**Ndërtimi i njohurive:**
**DLTA**

Secili nxënës veç e veç lexon me zë të lartë tekstin dhe bëhet komentimi i tekstit duke e plotësuar mendimin e shokut apo shoqës. Respektohet mendimi i secilit nxënës.

| |
|---|
| Bashkërisht identifikohet që teksti i lexuar është fabul. Nxënësit tregojnë edhe shembuj të tjerë të personazheve të fabulave.<br><br>Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë përgjigjet 1 – 5 të librit bazë.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>Në fund, nxënësit në grupe imagjinojnë një ngjarje tjetër ku personazhë kryesorë janë gjinkalla dhe milingona. Tregimin e paraqesin me anë të Stripit.<br><br>Stripët e punuar, vendosen në klasë.<br><br>Nxënësit shëtisin dhe i japin nga 1, 2 ose 3 yje punimit të preferuar. |
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim i ndërsjellë |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Në tekstin e dhënë në fillim të librit bazë, gjej një emër dhe identifiko: numrin, rasën, gjininë dhe trajtën e numrave. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Dita e Paqes | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1. I.2. I.3. I.8.**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4. III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3. VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br><br>**1. 1; 1. 2; 1. 4**<br><br>**2. 1; 2. 5; 2. 6.**<br><br>**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Dita e Paqes** | |
| Fjalët kyçe: Dita e paqes, liri, pëllumbi i bardhë, gëzim, lumturi, dashuri | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Lexon poezinë me intonacionin e duhur<br><br>-Demonstron përmbajtjen/kuptuarit e poezisë duke u përgjigjur në pyetjet e dhëna | Kriteret e suksesit:<br><br>- Lexo poezinë me intonacionin e duhur<br><br>-Demonstro përmbajtjen/kuptuarit e poezisë duke u përgjigjur në pyetjet e dhëna |

| | |
|---|---|
| -Analizon porosinë e poezisë | -Analizo porosinë e poezisë |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës, Artet | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | |

**Parashikimi:**
**Stuhi mendimesh**
Mësuesi/ja fillon diskutimin me nxënës me pytjen:

- Çfarë kuptoni me fjalën "paqe"?




**Ndërtimi i njohurive:**

Lexohet poezia nga nxënësit dhe bëhet komentimi i strofave duke u bazuar në pyetjet si:

**Strofa e parë**

- Çfarë do njerëzimi?
- Kur janë të qeshur dhe të gëzuar njerëzit?

**Strofa e dytë**

- Çfarë do njeriu?
- Në çfarë duhet ta kthejmë urrejtjen?

**Strofa e tretë**

- Cila është fjala më e madhe për njerëzimin?
- Çfarë nuk do njeriu?

**Strofa e katërt**

- Cilat janë dy fjalë – emra që janë në një vend?
- Çfarë do globi?

**Strofa e pestë**

- Kush do paqe?

**Strofa e gjashtë**

- Kush kërkon paqe?
- Kush është i pafajshëm?

**Strofa e shtatë**

- Une dua te jem ...
- Dua të fluturoj në ...

Nxënësit u përgjigjen në pyetjet e drejtuara nga mësuesi/ja dhe përgigjen në pyetjet 1 – 5 të aparatit pedagogjik..

**Përforcimi:**

Nxënësit në fletore i përzgjedhin katër vargje që u pëlqejnë më së shumti dhe shkruajnë komentimin e tyre.

| Pjesa e pëlqyer | Komenti |
|---|---|
| | |

| |
|---|
| |
| Informatë kthyese<br><br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Pyet prindërit dhe thello dijet për Ditën e Paqes. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## Pikëpyetja

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**: |
|---|---|
| | - |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4.III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3.VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**

**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**

**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Pikëpyetja**

Fjalët kyçe: Rubini, pikëpyetja, kureshtar, alien

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| -Përshkruan alienët | -Shpjego për alienët |
| -Nxjerr porosinë e tregimit | -Trego veprimet e personazhit kryesor |
| -Analizon veprimet e personazhit kryesor | -Nxjerr porosinë e tregimit |

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri bazë, fletë A4

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Artet, Shkencat e natyrës

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**
**Kllaster**
Mësimdhënësit ndanë nxënësit në 4 ose 5 grupe varësisht nga numri i nxënësve në klasë. Më pas shkruan në tabelë fjalën Alien dhe kërkon nga nxënësit që të japin mendime se çfarë dinë lidhur me këtë fjalë.




Të gjitha mendimet e nxënësve i shkruan në tabelë dhe i diskuton së bashku me nxënës.

**Ndërtimi i njohurive:**
**Tabela e parashikimeve**

Mësimdhënësi fillon të lexojmë mësimin me ndalesa.

Pas çdo ndalese mësimdhënësi iu jep kohë nxënësve që të plotësojnë pjesën 1, 2 të tabelës për 3 minuta.

| Ndalesat: | Çfarë mendoni se do të ndodhë? | Çfarë provash keni? | Çfarë ndodhi? |
|---|---|---|---|
| Pjesa 1 | | | |
| Pjesa 2 | | | |
| Pjesa 3 | | | |

Nxënësit analizojnë përmbajtjen e tregimit duke u përgjigjur në pyetjet 1 – 5 të librit bazë.

**Përforcimi:**

Në mënyrë individuale secili nxënës do të përgjigjet në pyetjen:

Po të takohesha me Rubinin si do të sillesha me të?

Imagjinoni Rubinin dhe vizatoje në fletën A4.

Informatë kthyese me shkrim

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Hulumtoni në internet për alienët.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## Qentë mendojnë se ne jemi lule

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II

Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV

| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
|---|---|

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I.1. I.2. I.3. I.8.**

**II.5.**

**III.1. III.3. III.4. III.8.**

**V.5. V.8.**

**VI.2. VI.3. VI.3.**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

**1. 1; 1. 2; 1. 4**

**2. 1; 2. 5; 2. 6.**

**3. 3; 3. 4; 3. 5; 3. 7**

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Qentë mendojnë se ne jemi lule**

Fjalët kyçe: qeni, kashfë, i zoti i shtëpisë, aromë

| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: | Kriteret e suksesit: |
|---|---|
| -Pëshkruan qenin | -Përshkruaj më fjalët e tuaja si duket qeni |
| -Gjen titullin e poezisë | -Shpjego kuptimin e poezisë |
| -Analizon poezinë e lexuar nga mësimdhënësi | -Gjej titullin e poezisë |

| |
|---|
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Libri bazë, fletorja dhe ¼ fletë A4 |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhë dhe komunikim, Art,  Shkencat e natyrës |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Parashikimi:**<br>**Parashikim me terma paraprak**<br><br>Fillimish mësimdhënësi shkruan në tabelë fjalët: kafshë, nuhatje, besnik, rojëtar, i dashur.<br><br>Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të tregojnë se me çfarë gjëje asocojnë fjalët e paraqitura në tabelë.<br><br>Arrihet edhe te personazhi kryesor për të cilin do të flitet në orën mësimore.<br><br>**Ndërtimi i njohurive:**<br><br>Mësimdhënësi lexon poezinë duke përshtatur intonacionin me ngjarjen e poezisë dhe më pas diskuton me nxënësit kuptimin e poezisë.<br><br>Më pas në një fletë ¼ e fletës A4 të vizatojnë qenin dhe pas saj të shkruajnë  nga tre emra, tre mbiemra dhe  tre folje nga poezia.<br><br>Nxënësit e ndarë në përgjigjen në pyetjet e çift përgjigjen në pyetjet 1 – 4 të aparatit pedagogjik.<br><br>**Përforcimi:**<br><br>**Gjeje titullin**<br><br>Në fund nxënënsit ndahen në grupe dhe gjejnë nga dy tituj për poezinë e lexuar. Nxënësve u kërkohet që nësë ata do të ishin autorë si do e titullonin më ndryshe këtë poezi.<br><br>Më pas nga një përfaqësues lexon titujt dhe arsyeton pse kanë shkruar ata tituj.<br><br>Në fund mësimdhënësi lexon edhe titullin e autorit:  Qentë mendojnë se ne jemi lule. |
| |
| Informatë kthyese me gojë<br><br>Notimi i ndërsjelltë |

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| --- |
| Nxënësit hulumtojnë në internet ose bisedojnë me ndonjë të rritur për pyetjen e mëposhtme:<br><br>Pse policët/ushtarët shpeshherë kanë qenin me vete? |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **Shoqet e ngushta** | |
| --- | --- |
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br><br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br><br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br><br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br><br>**II.5.**<br><br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br><br>**V.5. V.8.**<br><br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br><br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br><br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br><br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |

| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Njësia mësimore: **Shoqet e ngushta** | |
| Fjalët kyçe: shoqe, miqësi, të pandara, komunikim, mirëkuptim, respekt | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br><br>-Lexon rrjedhshëm dhe saktë tekstin<br><br>-Dallon personazhet e tregimit<br><br>-Analizon mesazhin e tregimit | Kriteret e suksesit:<br><br>-Lexo rrjedhshëm dhe saktë tekstin<br><br>-Dallo personazhet e tregimit<br><br>-Analizo mesazhin e tregimit |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>Burime nga interneti, Libri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br><br>Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Artet | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

Mësuesi/ja fillon diskutimin me nxënës me pyetjen:

- Çfarë kuptoni me fjalën "miqësi"?



**Ndërtimi i njohurive:**
**DLTA**
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë me ndalesa tekstin në libër bazë. Pas çdo ndalese mësuesi/ja drejton pyetje të ndryshme lidhur me paragrafin e lexuar. Leximi bëhët nga të gjithë nxënësit e klasës.

*Ndalesa e parë:*

- Si quhen personazhet e tregimit?
- Sa vjeçare janë?
- Cili ishte raporti i tyre ndërmjet njëra-tjetrës?

*Ndalesa e dytë:*

- Çfarë bëjnë ato së bashku?
- Ku takohen ato?
- Cilin mjet të komunikimit përdorin vajzat?

*Ndalesa e tretë:*

- Çfarë bëjnë vajzat në fundjavë?
- Çfarë shikojnë ato në televizor?

*Ndalesa e katërt:*

- Çfarë u pëlqen që të veshin më së shumti vajzave?
- Cila nga vajzat ka stil më të veçantë në veshje?

*Ndalesa e pestë:*

- Si quhet vëllai i Nitës?
- Çfarë u thonë prindërit vajzave, për raportin e tyre?

Nxënësit nëmënyrë të pavarur përgjigjen në pyetjet 1 – 5 dhe bashkarisht me mësimdhënësin i komentojnë përgjigjet.
**Përforcimi:**
Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen:

| PO | JO |
|---|---|

Miku i mirë është ai që sjell më të mirën tek unë. Pse?

| |
|---|
| Nxënësit shkruajnë në fletore pyetjen dhe argumentojnë përgjigjen e tyre Po ose Jo. |
| |
| Informatë kthyese<br>Vlerësim me figura |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Të plotësohen pyetjet 6 – 8 të aparatit pedagogjik.<br>Hulumto dhe grumbullo informata për miqësinë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| Fundi i vitit shkollor | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikim Shkalla e kurrikulës: II<br>Lënda: Gjuha amtare Klasa: IV | |
| **Tema**: | **Rezultati i të nxënit të temës**:<br>- |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>**I.1 I.2 I.3 I.6 I.8**<br>**II.5.**<br>**III.1. III.3. III.4.III.8.**<br>**V.5. V.8.**<br>**VI.2. VI.3.VI.3.** | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>**1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.7; 1.10**<br>**2.1; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6**<br>**3.2; 3.3; 3. 4; 3.5; 3.7** | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | |
| Njësia mësimore: **Fundi i vitit shkollor** | |
| Fjalët kyçe: shkollë, gëzim, përqafime, urim, fëmijët, oborr, pushime | |
| Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:<br>-Flet për emocionet e kaluara ne shkollë<br>-Lexon rrjedhshem tregimin<br>-Nxjerr mesazhin e tregimit | Kriteret e suksesit:<br>-Lexo rrjedhshem tregimin<br>-Nxjerr mesazhin e tregimit<br>-Fol për emocionet e kaluara ne shkollë |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Liri bazë, fletorja | |
| Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhët dhe komunikimi | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Parashikimi:**

*Lapsat në mes*

Mësuesi/ ja fillon orën me një aktivitet, ku nxënësit diskutojnë me radhë brenda grupit dhe vendosin lapsin në mes të tavolinës. Nxënësit kanë kohë deri në 10 minuta që të mendojnë për përgjigje. Pas përfundimit të kohës së caktuar, mësuesi/ja shkon te çdo grup i nxënësve për të marrë përgjigjen duke e zgjedhur njërin nga lapsat. Lapsi i tërhequr nga mësuesi/ja i përket njërit nga nxënësit e atij grupi, po ai nxënës duhet të dhënë përgjigje lidhur me detyrën e dhënë nga mësuesi/ja.

- *Tregoni një nga momentet më të veçanta gjatë këtij viti shkollor*

**Ndërtimi i njohurive:**

**Tabela tri pjesëshe**

Nxënësit në fletore shkruajnë përshtypjet nga dita e parë e shkollës e deri më sot, si dhe ilustrojnë momentet më të bukura që i kanë kaluar gjatë këtij viti shkollor.

| ***Përshtypjet e mia nga dita e parë e shkollës*** | ***Përshtypjet e mia nga dita e fundit e vitit shkollor*** | ***Ilustrimi*** |
|---|---|---|
| | | |

Plotësohet aparati pedagogjik në librin bazë. **Përforcimi:**

*Pesëvargësh*

Nxënësit në fletore krijojnë një pesëvargsh për Shkollën.

***Shkolla***

_____________________ ___________________ (2 mbiemra)

_________________ ___________________ _________________ (3 folje)

___________________________________________________________________ (1 fjali)

______________________ (1 sinonim për fjalën shkollë)

Informatë kthyese
Vlerësim me figura

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Shkruajnë: Një gjë që do ta ndryshoja në klasën time është...

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**